FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 178

Tiranë – E martë, 11 gusht 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 476, datë 4.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18001
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 178, datë 30.7.2026	Për miratimin e rregullores "Mbi detyrimet e raportimit, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor"	18001
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 179, datë 30.7.2026	Për miratimin e rregullores "Për kushtet teknike për ndërveprimin në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë' të sistemit hekurudhor"	18013
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 162, datë 10.8.2026	Për shfuqizim të urdhrit nr. 42, datë 15.2.2024, të ministrit të Punëve të Brendshme, "Për delegim të kompetencave"	18064
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 1593/1, datë 31.7.2026	Për delegim kompetence	18064
Urdhër i drejtorit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 134, datë 6.8.2026	Për delegim kompetence	18065
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 9.7.2026	Alma Liçaj kundër Shqipërisë (*kërkesa nr. 16399/20)*	18065
Urdhër i kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 469, datë 9.8.2026	Për delegim kompetencash	18070
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 130, datë 30.7.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 380, datë 30.11.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm'", të Këshillit	18070
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 131, datë 30.7.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 95, datë 9.5.2022 "Për miratimin e rregullores 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve', i ndryshuar", të Këshillit	18147

DEKRET
Nr. 476, datë 4.8.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kristo Reis Malaj
2. Amarildo Idriz Tusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 178, datë 30.7.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI DETYRIMET E RAPORTIMIT, NË KUADËR TË MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR"[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 3, të ligjit nr. 8/2018, "Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit"; të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare'",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi detyrimet e raportimit, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Autoriteti Rregullator Hekurudhor, administratorët e infrastrukturës hekurudhore, sipërmarrësit hekurudhorë dhe operatorët e impianteve të shërbimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ky urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE
"MBI DETYRIMET E RAPORTIMIT NË KUADËR TË MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR"[2]

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe formatet e të dhënave që i raportohen Komisionit të BE-së (në vijim Komisioni), sipas detyrimeve të informimit, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" (në vijim Kodi), nenin 3,

[1] *Kjo rregullore përafron plotësisht, me:*
- Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2015/1100, të 7 korrikut 2015, mbi detyrimet e raportimit të shteteve anëtare, në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor, nr. CELEX - 32015R1100, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria OJ L 181, datë 9.7.2015, faqe 1–26.

[2] *Kjo rregullore përafron plotësisht, me:*
- 32015R1100, Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2015/1100, e 7 korrikut 2015, mbi detyrimet e raportimit të shteteve anëtare në kuadër të monitorimit të tregut hekurudhor.

të udhëzimit nr. 15, datë 14.12.2023, "Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve". Përveç tyre, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Tarifat e përdorimit të infrastrukturës**" (TPI) nënkupton tarifat e mbledhura për paketën minimale të aksesit të përmendur në nenin 32, pika 3, e Kodit;

2. "**Shërbime me shpejtësi të lartë**" nënkupton shërbimet hekurudhore të udhëtarëve të ofruara nga trena me shpejtësi të lartë, duke përfshirë trenat me shpejtësi, që udhëtojnë me të paktën 200 km/orë për të paktën një pjesë të shërbimit; përdorimi i infrastrukturës me shpejtësi të lartë nuk është gjithmonë i nevojshëm;

3. "**Shërbime konvencionale në distanca të gjata**" nënkupton shërbime të transportit hekurudhor të udhëtarëve, përveç shërbimeve urbane, periferike, rajonale ose me shpejtësi të lartë;

4. "**Stacion**" nënkupton një vendndodhje në hekurudhë ku mund të fillojë, ndalojë ose mbarojë një shërbim treni udhëtarësh;

5. "**Terminal mallrash**" nënkupton një vend i pajisur për transferimin e ngarkesës nga një mënyrë transporti në një tjetër, si dhe ruajtjen e njësive të transportit intermodal, ku të paktën një nga mënyrat e transportit është hekurudhor;

6. "**Kompensim total nga shteti**" në kontekstin e marrëveshjeve kontraktuale nënkupton shumën totale që shteti ka rënë dakord t'i paguajë administratorit të infrastrukturës si financim gjatë gjithë periudhës kontraktuale;

7. "**Autoritet monitorues**" nënkupton Autoritetin Rregullator Hekurudhor (në vijim ARRH-ja) që, sipas legjislacionit në fuqi, monitoron dhe verifikon përputhshmërinë e transportit hekurudhor në linjë me parimet ndërkombëtare;

8. "**Linjë e dedikuar me shpejtësi të lartë**" nënkupton një linjë e ndërtuar posaçërisht për të lejuar trafikun të udhëtojë me shpejtësi, përgjithësisht të barabarta ose më të mëdha se 250 km/orë, në segmentet e saj kryesore; ajo mund të përfshijë segmente lidhëse ku shpejtësitë janë të reduktuara për të marrë parasysh kushtet lokale;

9. "**Nyjë**" nënkupton një pikë e rëndësishme në rrjetin hekurudhor ku bashkohen, kryqëzohen ose degëzohen shume linja hekurudhore;

10. "**Shërbim transporti mallrash vendas**" nënkupton një shërbim mallrash që nuk kalon kufirin shtetëror;

11. "**Ndarje itinerari**" nënkupton një vendim mbi ndarjen e itinerareve individuale të trenit për operacione; ndarja e itinerarit për çdo shërbim treni që operon si pjesë e një shërbimi të rregullt të planifikuar llogaritet si një ndarje e veçantë itinerari;

12. "**Itinerar i planifikuar i trenit**", nënkupton një itinerar të caktuar sipas rregullave të planifikimit të parashikuara në nenin 45, të Kodit;

13. "**Ndarje e refuzuar e itinerarit**" nënkupton një kërkesë për një itinerar që refuzohet nga administratori i infrastrukturës pas procesit të koordinimit të përcaktuar në nenin 46, pika, të Kodit. Çdo anulim i shërbimit të trenit që operon si pjesë e një shërbimi të rregullt të planifikuar llogaritet si një ndarje itinerari e refuzuar;

14. "**Mirëmbajtje**" nënkupton shpenzime jokapitale që administratori i infrastrukturës kryen me qëllim ruajtjen e gjendjes dhe aftësisë së infrastrukturës ekzistuese;

15. "**Rindërtime**" nënkupton shpenzime kapitale për një punim të madh modifikimi të infrastrukturës që përmirëson performancën e saj të përgjithshme;

16. "**Infrastrukturë e re**" nënkupton shpenzime kapitale për projektet për ndërtimin e instalimeve të reja të infrastrukturës;

17. "**Fondet publike**" në kontekstin e shpenzimeve për infrastrukturën nënkupton fonde të buruara direkt nga grantet e investimeve publike;

18. "**Fonde vetjake**" nënkupton fonde nga të ardhurat e fituara nga administratorët e infrastrukturës ose operatorët e impianteve të shërbimit përmes tarifave të aksesit dhe me mjete të tjera;

19. "**Të ardhura**" nënkupton totali i tarifave të mbledhura nga ofrimi i shërbimeve të transportit hekurudhor gjatë periudhës raportuese; përjashton të ardhura të tjera siç janë të ardhurat nga shërbimi i ushqimit, shërbimet e stacionit dhe shërbimet në bord;

20. "**Trafik hekurudhor në territorin kombëtar**" nënkupton çdo lëvizje e mjeteve hekurudhore brenda kufijve të një vendi, pavarësisht nga vendi në të cilin janë regjistruar mjetet;

21. "**Vonesë**" nënkupton ndryshimi në kohë midis kohës së specifikuar në orarin e një treni dhe kohës aktuale në të cilën ai kalon një vendndodhje specifike në itinerarin e trenit në të cilën regjistrohen të dhënat e udhëtimit;

22. "**Shërbim i anuluar**" nënkupton një tren i anuluar në fazën e operimit për shkak të arsyeve që lidhen me shërbimin hekurudhor, duke përfshirë humbjen e një ndalese të planifikuar nëse një tren ndërron itinerar ose duke zëvendësuar një shërbim hekurudhor me një shërbim rrugor;

23. "**Shpejtësia mesatare e orarit**" nënkupton shpejtësinë e llogaritur duke pjesëtuar gjatësinë totale të një udhëtimi me kohën që pritet të zgjasë udhëtimi sipas orarit;

24. "**Shërbime tregtare**" nënkupton të gjitha shërbimet e udhëtarëve që nuk bien brenda fushëveprimit të shërbimeve të ofruara sipas detyrimeve të shërbimit publik;

25. "**Sipërmarrje kryesore hekurudhore**" nënkuptohet sipërmarrja më e madhe për sa i përket udhëtarëve–km ose ton–km;

26. "**Licencë aktive**" nënkupton një licencë e dhënë një sipërmarrjeje hekurudhore që ka filluar dhe nuk ka ndërprerë veprimtarinë brenda periudhave të përcaktuara në nenin 25, pika 4, të Kodit;

27. "**Licencë pasive**" nënkupton një licencë e dhënë një sipërmarrjeje hekurudhore që nuk ka filluar ose ka ndërprerë veprimtarinë brenda periudhave të përcaktuara me nenin 25, pika 4, të Kodit, dhe licencat që janë pezulluar ose revokuar;

28. "**Tarifë për marrjen e një licence**" nënkupton të gjitha tarifat e ngarkuara nga Autoriteti Licencues Hekurudhor në lidhje me përpunimin e kërkesës;

29. "**Koha për marrjen e një licence**" nënkupton kohëzgjatjen midis datës në të cilën paraqitet një kërkesë e plotë për licencë dhe datës së vendimit përfundimtar;

30. "**Ekuivalentët me kohë të plotë**" nënkupton totali i orëve, duke përfshirë orët shtesë, të punuara në një punë gjatë një viti, i pjesëtuar me numrin mesatar të orëve të punuara në vit në një punë me kohë të plotë;

31. "**Kantier manovrimi, *depot***" nënkupton një territor hekurudhor ose një pjesë e tij, i pajisur me një numër vijash hekurudhore ose pajisjesh të tjera, që përdoren për operacionet e renditjes së mjeteve hekurudhore, duke përfshirë dhe ndërrimin e vijave hekurudhore.

Neni 3
Mbledhja dhe dorëzimi i të dhënave

1. Deri më 31 dhjetor të çdo viti, administratorët e infrastrukturës hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore dhe poseduesit e impianteve të shërbimit, informojnë te ARRH-ja, të dhënat e specifikuara në pyetësorin e përfshirë në shtojcë, në lidhje me vitin paraprak.

2. ARRH-ja i paraqet Komisionit të dhënat në lidhje me transportin hekurudhor në territorin shqiptar.

3. Kur një sipërmarrje hekurudhore operon në më shumë se një shtet, ajo duhet t'u ofrojë autoriteteve kombëtare të dhëna të ndara për secilin shtet në të cilin operon.

4. ARRH-ja merr të dhënat e nevojshme nga një kombinim i burimeve të mëposhtme:

a) anketat e detyrueshme;

b) të dhëna administrative, duke përfshirë të dhënat e mbledhura nga zyrat statistikore dhe autoritetet e tjera;

c) vlerësime statistikore, duke shpjeguar metodat e përdorura;

ç) të dhënat e ofruara nga organizatat përkatëse të industrisë ose palët e tjera të interesuara; dhe

d) studime *ad hoc*.

Subjektet e mësipërme, që mbajnë të dhënat përkatëse duhet t'i japin ato në kohën kur kërkohen.

5. Informacioni duhet mbledhur dhe përgatitur sipas materialeve udhëzuese metodologjike të sjella nga Komisioni në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave.

6. ARRH-ja, mbi bazën e të dhënave që mbledh, plotëson dhe dërgon formularin elektronik të pyetësorit që është i disponueshëm në faqen e internetit të Komisionit.

7. ARRH-ja respekton konfidencialitetin tregtar të informacionit që i ofrohet asaj.

Neni 4
Dispozitat kalimtare

1. Mbledhja e të dhënave duhet të sigurojë informacionin sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcë, duke filluar nga viti 2027. Kur identifikohen vështirësi të konsiderueshme në mbledhjen e të dhënave ose ka shqetësime, në lidhje me rëndësinë ose domosdoshmërinë e kategorive të caktuara të të dhënave, duhet të kërkohet vlerësim për përshtatjen e shtojcës.

2. Kur, gjatë periudhës kalimtare, nuk mund të jepen të dhënat sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcë, dhënia e tyre bëhet në format të ngjashëm duke treguar mospërputhjet kur i dorëzojnë të dhënat.

SHTOJCË
PYETËSORI I MONITORIMIT TË TREGUT HEKURUDHOR

Informacion mbi sfondin

Shteti anëtar:
☐ BE ☐BG ☐ CZ ☐ DK ☐ DE ☐ EE ☐ IE ☐ EL ☐ ES ☐ FR ☐ HR ☐ IT ☐ CY ☐ LV ☐ LT ☐ MT ☐ LU
☐ AT ☐ PL ☐ PT ☐ RO ☐ SI ☐ SK ☐ FI ☐ SE ☐ MB
☐ JO
Periudha e informimit: ☐☐/☐☐/☐☐ — ☐☐/☐☐/☐☐
Autoriteti përgjegjës:
Adresa e *email*-it për kontakt:

Meqë monedha kombëtare nuk është euro, duhet të përdoret kursi mesatar i këmbimit gjatë periudhës raportuese për të kthyer vlerat monetare nga monedha lekë në euro. Kursi i këmbimit i përdorur duhet të tregohet më poshtë.

1 ☐☐☐ = ☐,☐☐☐☐ EUR

Pyetjet e shënuara me një yll (*) janë opsionale.

Kur detyrimet e informimit në këtë shtojcë i referohen sipërmarrjeve hekurudhore, ato nuk zbatohen për sipërmarrjet hekurudhore të cilat operojnë vetëm shërbime urbane, periferike ose rajonale në rrjete të pavarura lokale dhe rajonale, siç përcaktohet në nenin 3, pika 2, të Kodit.

1. Tarifimi i infrastrukturës

1.1 Tarifat mesatare të përdorimit të infrastrukturës (TPI) për tren–km për kategori të ndryshme trenash

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenave në përdorim. Kur mesataret aritmetike nuk mund të llogariten, mund të jepet një vlerësim i TPI-ve të kategorive të ndryshme të trenave. Metoda e përdorur për të llogaritur ose vlerësuar TPI-të duhet të shpjegohet në kuadratin e paragrafit 1.5, ([1])më poshtë.

Kategoria e trenit ***(vetëm nëse është në përdorim)***	**Tarifa e përdorimit të infrastrukturës, duke përjashtuar shtesat** ***(euro/tren–km)***
Shërbimet për udhëtarët:	
Tren udhëtarësh që ofron shërbime periferike dhe rajonale	☐☐☐,☐☐
Tren udhëtarësh që ofron shërbime konvencionale në distanca të gjata	☐☐☐,☐☐
Tren udhëtarësh që ofron shërbime me shpejtësi të lartë në linja të dedikuara me shpejtësi të lartë	☐☐☐,☐☐
Shërbimet e transportit të mallrave:	
Tren mallrash me peshë bruto 1000 ton	☐☐☐,☐☐
Tren mallrash me kapacitet 1600 ton bruto	☐☐☐,☐☐
Tren mallrash me peshë bruto 6 000 ton	☐☐☐,☐☐

1.2 Të ardhurat e administratorëve të infrastrukturës nga tarifat e infrastrukturës, stacioneve dhe terminaleve

Vetëm tarifat e mbledhura nga administratorët e infrastrukturës duhet të informohen. Këto përfshijnë tarifat e mbledhura për mjediset e stacioneve dhe terminalet e mallrave në pronësi ose të menaxhuara nga administratorët e infrastrukturës.

Të ardhurat ***(mijë euro)***	
Shërbimet për udhëtarët:	
Të ardhurat totale nga tarifat e aksesit në shina, duke përfshirë rritjet e çmimeve	☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐
Të ardhurat totale nga tarifat e stacionit	☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐
Nga të cilat:	
Tarifat e stacionit për trenat periferikë dhe rajonalë (*)	☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐
Tarifat e stacionit për trenat konvencionalë të distancave të gjata dhe me shpejtësi të lartë (*)	☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐

Tarifa të tjera të mbledhura nga operatorët e trenave të udhëtarëve	□□□□□□□□□□□
Shërbimet e transportit të mallrave:	
Të ardhurat totale nga tarifat e aksesit në shina, duke përfshirë rritjet e çmimeve	□□□□□□□□□□□
Të ardhurat totale nga tarifat e terminalit të mallrave	□□□□□□□□□□□
Tarifa të tjera të mbledhura nga operatorët e trenave të mallrave	□□□□□□□□□□□
Të ardhurat totale të mbledhura nga menaxherët e infrastrukturës	□□□□□□□□□□□

1.3 Karakteristikat kryesore të marrëveshjeve kontraktuale, të lidhura në përputhje me nenin 30, pikës 2, të Kodit

Administrator i infrastrukturës *(emri)*	**Gjatësia e rrjetit të mbuluar *(km)***	**Data e fillimit**	**Data e mbarimit**	**A janë rënë dakord për treguesit e performancës?** (2) **Nëse po, ju lutem specifikoni**		**Kompensimi total nga shteti *(mijëra euro)***	**Ekzistenca e një organi monitorues të kontratës? Nëse po, ju lutem specifikoni *(emri)***	
				☐ PO ☐ JO		□□□□□□□□	☐ PO ☐ JO	
				☐ PO ☐ JO		□□□□□□□□	☐ PO ☐ JO	
				☐ PO ☐ JO		□□□□□□□□	☐ PO ☐ JO	
				☐ PO ☐ JO		□□□□□□□□	☐ PO ☐ JO	
				☐ PO ☐ JO		□□□□□□□□	☐ PO ☐ JO	

1.4 Ulja e zhurmës

A ka rregulla të detyrueshme (qoftë në fuqi ose që do të futen) që i detyrojnë operatorët hekurudhorë dhe/ose administratorët e infrastrukturës të marrin masa për të zvogëluar ekspozimin e popullsisë ndaj zhurmës hekurudhore? Këto masa mund të përfshijnë kufizime në vëllimet e trafikut, barriera zhurmash ose TPI të diferencuara për shkak të zhurmës që synojnë përshpejtimin e pajisjes së vagonëve të mallrave me blloqe frenash "pa zhurmë".

☐ PO ☐ JO

Nëse po, ju lutemi specifikoni:

1.5 Komente shtesë (*):

Mund të shtohen komente të mëtejshme mbi pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Shpjegoni se si janë llogaritur TPI-të mesatare për tren–km në tabelën 1.1, duke përfshirë edhe cilët komponentë të tarifave përfshihen.
- Specifikoni nëse aplikohen rritje çmimesh përveç TPI-ve të raportuara.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Tregoni nëse janë aplikuar TPI-të e diferencuara të ERTMS.(3)

2. Ndarja e kapaciteteve

2.1 Seksionet e mbingarkuara të infrastrukturës

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me seksionet e mbingarkuara, siç përcaktohet në nenin 47, pikës 1, të Kodit, në lidhje me situatën në fund të periudhës raportuese.

Gjatësia totale e binarëve të prekur nga mbingarkesa *(km)*	□□□□□□□
Nga të cilat:	
Linja të dedikuara me shpejtësi të lartë *(km)*	□□□□□□□
Korridoret hekurudhore të mallrave *(km)*	□□□□□□□
Numri i nyjave të mbingarkuara	□□□

2.2 Shërbime prioritare

Jepni renditjen (1 që do të thotë prioriteti më i lartë) e shërbimeve hekurudhore kur duhet të përcaktohen përparësitë për ndarjen e kapacitetit të infrastrukturës, p.sh. brenda procesit të planifikimit dhe koordinimit dhe në rastet e kufizimeve ose shqetësimeve të përkohshme të kapacitetit. Nëse ndonjë nga shërbimet e listuara nuk është i përshtatshëm për rregullat e prioritetit, ju lutemi vendosni një kryq ('x') në kuti.

☐ Shërbimet e ofruara sipas detyrimeve të shërbimit publik (PSO);	
☐ Shërbime vendase me shpejtësi të lartë;	
☐ Shërbime të tjera të brendshme për pasagjerë;	
☐ Shërbimet ndërkombëtare të pasagjerëve;	
☐ Shërbime transporti të brendshëm;	
☐ Shërbime ndërkombëtare të transportit të mallrave,	
☐ Të tjera	Ju lutem specifikoni:

2.3. Shpërndarje të suksesshme dhe të refuzuara të itinerareve për shërbime të ndryshme

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenave në përdorim. Ju lutemi të jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me situatën pas proceseve të planifikimit dhe koordinimit të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të Kodit.

Shërbim	**Itinerare të planifikuara të trenave**		**Itinerare treni *ad hoc***	
	Shpërndarje të suksesshme të itinerarëve *(numër)*	**Shpërndarjet e itinerarëve të refuzuara *(numër)***	**Shpërndarje të suksesshme të itinerarëve *(numër)***	**Shpërndarjet e itinerarëve të refuzuara *(numër)***
Shërbimet totale për udhëtarë:	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Vendase, periferike dhe rajonale	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Transporti konvencional vendas në distanca të gjata	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shpejtësi e lartë vendase	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Ndërkombëtar	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shërbime totale të transportit të mallrave:	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Transporti vendas	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Transport ndërkombëtar	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Nga të cilat:				
Itineraret e ndara nga qendrat e vetme të korridoreve hekurudhore të mallrave	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□

2.4 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Jepni një përshkrim të shkurtër të kritereve të përparësisë, të përdorura nga administratorët e infrastrukturës për ndarjen e itinerareve, në lidhje me rrethanat në të cilat zbatohen këto kritere, p.sh. brenda procesit të planifikimit dhe koordinimit dhe në rast të kufizimit ose shqetësimit të përkohshëm të kapacitetit.
- Specifikoni nëse është përdorur tarifa e mungesës së kapacitetit të përcaktuar në nenin 32, pika 4 të Kodit.
- Specifikoni nëse janë përgatitur dhe zbatuar planet e rritjes së kapaciteteve të përcaktuar në nenin 51 të Kodit.

3. Shpenzimet për infrastrukturën

Tregoni shpenzimet e bëra gjatë periudhës raportuese nga administratorët kryesorë të infrastrukturës hekurudhore dhe nga pronarët e tjerë të stacioneve dhe terminaleve të mallrave. Në tregjet e fragmentuara, fushëveprimi i raportimit mund të kufizohet në shpenzimet e pronarëve të stacioneve kryesore dhe terminaleve të mallrave.([4]) Për stacionet dhe terminalet intermodale, përfshini vetëm pjesën e shpenzimeve që lidhen me transportin hekurudhor.

3.1 Përmbledhje e shpenzimeve për infrastrukturën hekurudhore

(mijë euro)				
	Mirëmbajtje	**Rinovimet**	**Përmirësime**	**Infrastrukturë e re**
Linjat konvencionale	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Linja të dedikuara me shpejtësi të lartë	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Stacionet kryesore	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Terminalet kryesore të mallrave	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shpenzimet totale	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□

3.2 Burimi i financimit për shpenzimet për komponentë të ndryshëm të infrastrukturës(5)

(mijë euro)			
	Fondet publike	**Fondet e BE-së**	**Fondet e veta**
Infrastruktura ekzistuese, duke përfshirë stacionet kryesore dhe terminalet e mallrave	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Infrastrukturë e re			
Linja konvencionale dhe të dedikuara me shpejtësi të lartë	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Stacionet kryesore	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Terminalet kryesore të mallrave	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shpenzimet totale	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□

3.3 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

- Bëni referencë në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Infrastrukturës, në përputhje me nenin 10, pikës 2, të Kodit.

4. Të ardhurat dhe vëllimet e trafikut

4.1 Të ardhurat dhe vëllimet e shërbimeve të udhëtarëve dhe mallrave

Për të siguruar që vëllimi i shërbimeve dhe të ardhurat e paraqitura përputhen, në këtë tabelë duhet të jepen vetëm të ardhurat e gjeneruara nga trafiku hekurudhor në territorin shqiptar. Mund të përdoren vlerësimet statistikore, nëse është e nevojshme. Nëse statistikat zyrtare mbi vëllimet e trafikut nuk janë ende të disponueshme, mund të jepen vlera paraprake dhe më pas të rregullohen në një datë të mëvonshme.

Shërbimet për udhëtarët:	
Të ardhurat totale të ndërmarrjeve hekurudhore nga shërbimet e transportit *(mijëra euro)*	□□□□□□□□□□□
Vëllimi total i shërbimeve *(mijë tren–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi total i shërbimeve *(milion pasagjerë–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve të brendshme *(milion pasagjerë–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve ndërkombëtare *(milion pasagjerë–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve të tranzitit (*) *(milion pasagjerë–km)*	□□□□□□□,□
Të ardhurat nga dhe vëllimet e PSO-së dhe shërbimeve tregtare ***Shërbimet PSO:***	
Të ardhurat nga tarifat *(mijëra euro)*	□□□□□□□□□□□
Kompensimi i PSO-së *(mijë euro)* (6)	□□□□□□□□□□□
Vëllimi i shërbimeve *(milion pasagjerë–km)* (7)	□□□□□□□,□
Shërbime komerciale:	
Të ardhurat nga tarifat *(mijëra euro)*	□□□□□□□□□□□
Vëllimi i shërbimeve *(milion pasagjerë–km)*	□□□□□□□,□

Shërbimet e transportit të mallrave:	
Të ardhurat totale të ndërmarrjeve hekurudhore nga shërbimet e transportit *(mijëra euro)*	□□□□□□□□□□□
Vëllimi total i shërbimeve *(mijë tren–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi total i shërbimeve *(milion ton–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve vendase *(milion ton–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve ndërkombëtare *(milion ton–km)*	□□□□□□□,□
Vëllimi i shërbimeve të tranzitit (*) *(milion ton–km)*	□□□□□□□,□

4.2 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Tregoni nëse vlerat e dhëna për të ardhurat e gjeneruara nga trafiku hekurudhor në territorin kombëtar janë shifra të raportuara apo vlerësime. Kur janë përdorur mostra ose vlerësime, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Specifikoni nëse ka pasur ndonjë boshllëk ose mospërputhje në të dhënat e futura.

5. Cilësia e shërbimeve hekurudhore

Tabelat duhet të plotësohen vetëm për kategoritë e trenit në përdorim.

5.1 Saktësia dhe anulimet e shërbimeve të udhëtarëve

Shërbimet për udhëtarët:	Numri total i shërbimeve	Numri i trenave që mbërrijnë në kohë (vonesë prej 5 minutash ose më pak)	Numri i shërbimeve të anuluara
Shërbime periferike dhe rajonale	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shërbime konvencionale në distanca të gjata dhe me shpejtësi të lartë	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□

5.2 Përpikmëria dhe anulimet e shërbimeve të transportit të mallrave ([8])

Shërbimet e transportit të mallrave:	Numri total i shërbimeve	Numri i trenave që mbërrijnë në kohë (vonesë prej 15 minutash ose më pak)	Numri i shërbimeve të anuluara
Shërbimet e brendshme	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□
Shërbime ndërkombëtare	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□	□□□□□□□□□□□

5.3 Shpejtësia mesatare e orarit të shërbimeve të mallrave (*)

Shërbimet e transportit të mallrave:	Shpejtësia mesatare e orarit (km/orë)
Shërbimet e brendshme	□□□
Shërbime ndërkombëtare	□□□

5.4 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.
- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.
- Shpjegoni se si është matur 'vonesa' e një treni (p.sh. vetëm në ndalesën e fundit ose si mesatare mbi të gjitha ndalesat e planifikuara).
- Jepni referenca për raportet e performancës dhe anketat e kënaqësisë të publikuara nga bordi i menaxhimit të korridorit hekurudhor të mallrave në të cilën përfshihemi([9]).
- Jepni referenca për çdo anketë tjetër mbi cilësinë e shërbimeve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve që është kryer kohët e fundit.

6. Detyrimet e shërbimit publik (PSO)

6.1 Vëllimi i shërbimeve dhe kompensimi i paguar për shërbimet e ofruara sipas PSO-ve në segmente të ndryshme të tregut

Tabela duhet të plotësohet vetëm për kategoritë e trenit në përdorim.

	Vëllimi i shërbimeve *(milion udhëtarë–km)*			Vëllimi i shërbimeve *(mijë tren–km)*	Kompensimi PSO *(mijë euro)*([10])
	Totali	*Nga të cilat:*			
		Ofertuar në mënyrë konkurruese	I dhënë drejtpërdrejt		
Shërbimet totale PSO	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□□□
Nga të cilat:					
Periferike dhe rajonale	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□□□
Distancë e gjatë konvencionale	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□□□
Shpejtësi e lartë	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□□□
Nga të cilat:					
Shërbimet ndërkombëtare të ofruara në kuadër të PSO-ve	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□,□	□□□□□□□□□□□

6.2 Qasja në mjetet lëvizëse në kontekstin e shërbimeve PSO

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me secilën kontratë PSO të dhënë gjatë periudhës raportuese.

	Përshkrimi *(rajonet ose linjat e mbuluara)*	Kohëzgjatja *(vite)*	Vëllimi i kontratës *(mijë tren–km/vit)*	Operatori *(emri)*	A u ofrua kontrata në mënyrë konkurruese?	Marrëveshjet për sigurimin e mjeteve lëvizëse	
						I përcaktuar në specifikimet e tenderit?	Përshkrimi ([11])
1.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
2.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
3.					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	
…					☐ PO ☐ JO	☐ PO ☐ JO	

6.3 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

7. Shkalla e hapjes së tregut

Renditni sipërmarrjet hekurudhore që kanë një pjesë tregu prej 1% ose më shumë. Kur ka më shumë se dhjetë sipërmarrje me një pjesë tregu prej 1% ose më shumë, renditni vetëm 10 më të mëdhatë. Pjesa e tregut që mbajnë sipërmarrjet e tjera hekurudhore mund të jepet si total nën 'Të tjera'.

Nëse për arsye të konfidencialitetit tregtar emri i një sipërmarrjeje hekurudhore nuk mund të tregohet, ju lutemi përdorni pseudonime, p.sh. 'RU 1', 'RU 2'. Nëse kjo nuk do të ishte e mjaftueshme për të zgjidhur çështjet e konfidencialitetit, pjesët e tregut të sipërmarrjes hekurudhore, përveç asaj të sipërmarrjes kryesore ose ekzistuese hekurudhore, mund të grupohen më tej.

7.1 Tregu i udhëtarëve – shërbimet PSO

Sipërmarrja hekurudhore *(emri ose pseudonimi)*	Pjesa e tregut të shërbimeve PSO *(përqindje)* ([12])
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %

	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.2 Tregu i udhëtarëve – shërbime tregtare

Sipërmarrja hekurudhore ***(emri ose pseudonimi)***	**Pjesa e tregut të shërbimeve komerciale** ***(përqindje)*** (13)
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.3 Tregu i mallrave

Sipërmarrja hekurudhore ***(emri ose pseudonimi)***	**Pjesa e tregut të shërbimeve të transportit të mallrave** ***(përqindje)*** (14)
Sipërmarrja kryesore ose ekzistuese hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Sipërmarrje të tjera hekurudhore:	
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
	□□□,□ %
Të tjerë:	□□□,□ %

7.4 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

- Tregoni nëse ndonjë sipërmarrje e re hekurudhore e madhe ka hyrë në tregun e pasagjerëve ose të mallrave gjatë periudhës së raportimit.

8. Shkalla e harmonizimit dhe zhvillimet legjislative (*)

Informacioni mbi shkallën e harmonizimit ligjor është tashmë në dispozicion të Komisionit, pasi kemi njoftuar Komisionin kur e kemi transpozuar legjislacionin. Ky seksion u lejon vendeve të tjera të komentojnë mbi çdo çështje të pazgjidhur që lidhet me tregun hekurudhor të BE-së ose me zhvillimin e ligjeve kombëtare mbi hekurudhat.

8.1. Komente shtesë (*):

9. Licencimi

9.1 Numri i licencave të lëshuara për sipërmarrjet hekurudhore(15)

Numri i licencave aktive në fillim të periudhës raportuese (A)	□□□□
Numri i licencave të pezulluara ose të revokuara gjatë periudhës raportuese (16) (B)	□□□□
Numri i licencave të dhëna gjatë periudhës raportuese (C)	□□□□
Numri i licencave aktive në fund të periudhës raportuese (A – B + C)	□□□□
Numri i licencave pasive në fund të periudhës raportuese	□□□□

9.2 Tarifat dhe koha e nevojshme për marrjen e një licence

Tarifa mesatare për të marrë një licencë *(euro)*	□□□□□□□
Koha mesatare për marrjen e një licence *(ditë kalendarike)*	□□□

9.3. Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

10. Punësimi dhe kushtet sociale

10.1 Punonjësit në sektorin hekurudhor sipas gjinisë dhe grup-moshës

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me situatën në fund të periudhës raportuese. Kur ndonjë nga sipërmarrjet ofron shërbime edhe për sektorë të tjerë përveç sektorit hekurudhor, numri i punonjësve mund të deklarohet bazuar në një vlerësim të përqindjes së totalit të punonjësve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të lidhura me hekurudhën.

	Totali ***(ekuivalentët me kohë të plotë)***	**Burra** ***(%)***	**Gratë** ***(%)***	**< 30 vjet** ***(%)***	**30–50 vjet** ***(%)***	**> 50 vjet** ***(%)***
Stafi total i sipërmarrjeve hekurudhore ekzistuese ose sipërmarrjeve të tjera kryesore(17)	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Nga të cilat: **makinistët e trenave**	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Totali i stafit të sipërmarrjeve të tjera hekurudhore	□□□□□□□					
Nga të cilat: **makinistët e trenave**	□□□□□□□					
Stafi total i administratorëve kryesorë të infrastrukturës	□□□□□□□	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Stafi total i administratorëve të tjerë të infrastrukturës	□□□□□□□					
Stafi i kompanive të tjera që ofrojnë shërbime të lidhura me transportin hekurudhor (*) (18)	□□□□□□□					
Nga të cilat:						
Stacione (*)	□□□□□□□					
Terminalet e mallrave (*)	□□□□□□□					
Mirëmbajtja e mjeteve hekurudhore (*)	□□□□□□□					
Mirëmbajtja e infrastrukturës (*)	□□□□□□□					
Organizata të specializuara trajnimi (*)	□□□□□□□					
Qiradhënie me makinist treni (*)	□□□□□□□					
Furnizimi me energji (*)	□□□□□□□					
Shërbime pastrimi të mjeteve lëvizëse (*)	□□□□□□□					
Tjetër (*)	□□□□□□□					

10.2 Punonjësit sipas llojit të kontratës

Jepni informacionin e mëposhtëm, në lidhje me situatën në fund të periudhës së raportimit.

	Kontrata të përhershme Një (19) ***(%)***	**Kontrata të përkohshme B*(%)***	**Kontrata me kohë të pjesshme** ***(%)***	**Praktikantë dhe praktikante** ***(%)***
Stafi total i sipërmarrjeve hekurudhore ekzistuese ose sipërmarrjeve të tjera kryesore (20)	□□□,□ %	□□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Nga të cilat **makinistët e trenave**	□□□,□ %	□□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %
Stafi total i administratorëve kryesorë të infrastrukturës	□□□,□ %	□□□,□ %	□□,□ %	□□,□ %

10.3 Komente shtesë (*):

Mund të shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Kur është përdorur marrja e mostrave ose vlerësimet për të përpiluar të dhënat, shpjegoni shkurtimisht qasjen e ndjekur.

- Jepni detaje mbi programet ose aktivitetet e trajnimit të synuara për punonjësit hekurudhorë.

- Specifikoni nëse autoriteti kompetent e ka përdorur të drejtën që i është dhënë në nenin 5, pika 1, shkronja "dh", të udhëzimit nr. 15, datë 14.12.2023, "Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve", në lidhje me të drejtat e stafit dhe standardet sociale të zbatueshme për operatorët e shërbimeve publike.

- Nëse në tabelën 10.1 janë raportuar të dhënat mbi 'stafin e kompanive të tjera që ofrojnë shërbime të lidhura me transportin hekurudhor', shpjegoni shkurtimisht se cilat kompani janë përfshirë.

11. Pajisjet e shërbimit

11.1 Pronësia dhe menaxhimi i impianteve kryesore të shërbimit

Për qëllimet e këtij pyetësori, objektet e shërbimit janë sipas përshkrimit të nenit 5, pika 5, të Kodit. Tregoni numrin e objekteve të operuara sipas secilit lloj pronësie ose operatori.

Objekt infrastrukturor	Pronësia						Operatori					
	Sipërmarrja hekurudhore ekzistuese dhe kompanitë e lidhura me të[21]	Kompani të tjera					Sipërmarrja hekurudhore ekzistuese dhe kompanitë e lidhura me të	Kompani të tjera				
		Administratorët e infrastrukturës	Sipërmarrjet hekurudhore	Kompanitë e integruara [22]	Drejtimi [23]	Të tjera		Administratorët e infrastrukturës	Sipërmarrjet hekurudhore	Kompanitë e integruara	Drejtimi	Të tjera
Stacione totale	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Stacione që u shërbejnë mbi 25 000 udhëtarëve në ditë	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Stacione që u shërbejnë 10 000–25 000 udhëtarëve në ditë	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Stacione që u shërbejnë 1 000–10 000 udhëtarëve në ditë	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Stacione që u shërbejnë më pak se 1000 udhëtarëve në ditë	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Terminalet e mallrave	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Depot	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Pajisjet e mirëmbajtjes	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Pajisjet portuale detare dhe të brendshme të lidhura me shërbimet hekurudhore	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□
Impiante furnizimi me karburant	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□	□□□			

11.2 Numri i ankesave që lidhen me objektet e shërbimit

Deklaroni numrin e ankesave të bëra në lidhje me aksesin në ambiente, nivelin e tarifave ose cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ankesat që aktualisht po përpunohen nga organi rregullator	□□□
Vendimet e marra mbi ankesat gjatë periudhës raportuese	□□□

11.3 Përshkrimi i ankesave:

Jepni një përshkrim të shkurtër dhe të përgjithshëm të rasteve kryesore (deri në dhjetë) për të cilat është marrë një vendim gjatë periudhës raportuese. Tregoni nëse ndonjë nga ankesat ka ngritur pyetje në lidhje me

interpretimin e *acquis* evropiane të hekurudhave dhe përshkruani veprimet e propozuara për të korrigjuar situatën.

11.4 Komente shtesë (*):

Shtoni çdo koment tjetër, duke përfshirë pikat e mëposhtme:

- Gjatë periudhës kalimtare të përmendur në nenin 4 të rregullores, jepni informacion në rast se të dhënat e raportuara nuk përputhen plotësisht me përmbajtjen dhe/ose formatin e kërkuar.

- Specifikoni nëse Autoriteti Rregullator Hekurudhor është konsultuar në ndonjë rast.

[1] *Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e qasjeve të mundshme që mund të ndërmerren gjatë llogaritjes së TPI-ve, të dhënat e ofruara në këtë tabelë nga shtete të ndryshme anëtare nuk do të jenë domosdoshmërish të krahasueshme dhe do të jenë kryesisht të dobishme për monitorimin e trendeve brenda secilit shtet anëtar.*

[2] *Siç specifikohet në nenin 31, pika 2, shkronja "c", e Kodit.*

[3] *Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor.*

[4] *Për qëllimet e këtij pyetësori, stacionet që u shërbejnë mbi 10 000 udhëtarëve në ditë jave konsiderohen si 'stacione kryesore', dhe terminalet e mallrave me një kapacitet mbi 100 000 kontejnerë në vit ose mbi 1 milion ton në vit konsiderohen si 'terminale kryesore mallrash'.*

[5] *Totali i shpenzimeve të raportuara në tabelat 3.1 dhe 3.2 duhet të jetë përgjithësisht afërsisht i barabartë.*

[6] *Shifra e raportuar këtu duhet të jetë e njëjtë me atë të raportuar në tabelën 6.1. Pagesat e koncesionit nga një operator për një autoritet publik duhet të trajtohen si kompensime 'negative' të PSO-së.*

[7] *Shifra e raportuar këtu duhet të jetë e njëjtë me atë të raportuar në tabelën 6.1.*

[8] *Vetëm për shërbimet e planifikuara.*

[9] *Rregullorja në lidhje me një rrjet hekurudhor evropian për transportin konkurrues të mallrave.*

[10] *Pagesat e koncesionit nga një operator për autoritetin publik duhet të trajtohen si kompensim 'negativ' i PSO-së.*

[11] *Marrëveshje e dakordësuar për sigurimin e materialit lëvizës për secilën kontratë, p.sh. në pronësi, të subvencionuar ose të garantuar nga autoriteti kontraktues; e ofruar nga ndërmarrja hekurudhore ose e marrë me qira.*

[12] *Në bazë të udhëtarëve-km të ofruara në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.*

[13] *Në bazë të udhëtarëve-km të ofruara në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.*

[14] *Në bazë të ton-km të dhëna në territorin kombëtar gjatë periudhës së raportimit. Totali i kolonës duhet të jetë 100%.*

[15] *Nuk do të jetë e detyruar plotësimi i këtij seksioni pasi informacioni mbi licencat e sipërmarrjeve hekurudhore të jetë i disponueshëm për të gjitha shtetet në Bazën e të Dhënave të Agjencisë Evropiane të Hekurudhave për Ndërveprimin dhe Sigurinë (Eradis).*

[16] *Duke përjashtuar licencat e riaktivizuara gjatë periudhës së raportimit.*

[17] *Shtrirja e raportimit duhet të mbulojë të paktën 50% të tregut (bazuar në udhëtarë-km dhe ton-km).*

[18] *Kur ata nuk përfshihen në stafin e sipërmarrjes hekurudhore ose të administratorit të infrastrukturës të dhënë më sipër.*

[19] *A + B = 100%.*

[20] *Shtrirja e raportimit duhet të mbulojë të paktën 50% të tregut (bazuar në udhëtarë-km dhe ton-km).*

[21] *Duke përfshirë administratorët e infrastrukturës së integruar dhe bashkimin e shoqërive.*

[22] *Duke përfshirë sipërmarrjet hekurudhore joaktive dhe administratorët e infrastrukturës, të cilët janë pjesë e bashkimit të shoqërive.*

[23] *Qeverisje kombëtare, rajonale ose lokale.*

URDHËR
Nr. 179, datë 30.7.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KUSHTET TEKNIKE PËR NDËRVEPRIMIN NË LIDHJE ME NËNSISTEMIN 'INFRASTRUKTURË' TË SISTEMIT HEKURUDHOR"[3]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 135, të ligjit nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë"; nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim–Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare"', si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024, "Për miratimin e dokumentit të politikës 'Agjenda Kombëtare e Reformave 2024– 2027"', në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për kushtet teknike për ndërveprimin në lidhje me nënsistemin

[3] *Kjo rregullore përafron plotësisht me:*

- Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1299/2014, e datës 18 nëntor 2014, mbi specifikimet teknike për ndërveprimin në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë' të sistemit hekurudhor në Bashkimin Evropian nr. CELEX - 02014R1299-20230928, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria OJ L 356, datë 12.12.2014, faqe 1, e ndryshuar.

'Infrastrukturë' të sistemit hekurudhor'', sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Sigurisë Hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE "PËR KUSHTET TEKNIKE PËR NDËRVEPRIM NË LIDHJE ME NËNSISTEMIN 'INFRASTRUKTURË' TË SISTEMIT HEKURUDHOR"[4]

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore miraton kushtet teknike për ndërveprimin (TSI) që lidhet me nënsistemin 'Infrastrukturë' të sistemit hekurudhor, siç përcaktohet në aneks.

Neni 2
Fushëveprimi

1. TSI-ja zbatohet për të gjithë infrastrukturën e re, të përmirësuar ose të rinovuar të sistemit hekurudhor, siç përcaktohet në nenin 143, pika 2, shkronja "a", nënparagrafi "i", të ligjit nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" (në vijim Kodi).

2. Pa cenuar nenet 7, 8 dhe pikën 7.2 të aneksit, TSI-ja zbatohet për linjat e reja hekurudhore të cilat vihen në shërbim pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. TSI-ja nuk zbatohet për infrastrukturën ekzistuese të sistemit hekurudhor e cila është vënë tashmë në shërbim në të gjithë ose një pjesë të rrjetit, përveç rasteve kur i nënshtrohet rinovimit ose përmirësimit në përputhje me nenin 145, të Kodit dhe seksionin 7.3, të aneksit.

4. TSI-ja zbatohet për rrjetin e sistemit hekurudhor, siç përshkruhet në nenin 111, të Kodit, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 3, pika 2, të Kodit.

5. TSI-ja zbatohet për rrjetet me gjerësitë nominale të vijës hekurudhore 1435 mm.

6. Matësi metrik përjashtohet nga fushëveprimi teknik i kësaj TSI-je.

7. Fusha teknike dhe gjeografike e kësaj rregulloreje përcaktohet në seksionet 1.1 dhe 1.2 të aneksit.

Neni 3
Pikat e hapura

1. Lidhur me aspektet e listuar si 'pika të hapura' në shtojcën Ë të aneksit së kësaj rregulloreje, kushtet që duhen përmbushur për verifikimin e kërkesave thelbësore janë ato të përcaktuara nga rregullat kombëtare në fuqi që autorizojnë vënien në shërbim të nënsistemit të mbuluar nga kjo rregullore.

2. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore (në vijim ASH-ja), njofton ministrinë përgjegjëse për transportin (në vijim ministrinë), në lidhje me informacionin e mëposhtëm:

a) rregullat kombëtare të përmendura në paragrafin 1;

b) procedurat e vlerësimit dhe verifikimit të konformitetit që duhen kryer për të zbatuar rregullat kombëtare të përmendura në paragrafin 1;

c) organet e caktuara për të kryer procedurat e vlerësimit dhe verifikimit të konformitetit në lidhje me pikat e hapura.

Neni 4
Raste specifike

1. Lidhur me rastet specifike të listuar në seksionin 7.7 të aneksit, kushtet që duhen përmbushur për verifikimin e kërkesave thelbësore janë ato të përcaktuara në seksionin 7.7 të aneksit ose nga rregullat kombëtare në fuqi që autorizojnë

[4] *Kjo rregullore përafron plotësisht me:*
- Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1299/2014, të datës 18 nëntor 2014, mbi specifikimet teknike për ndërveprimin në lidhje me nënsistemin 'Infrastrukturë' të sistemit hekurudhor në Bashkimin Evropian, nr. CELEX - 02014R1299-20230928, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria OJ L 356, datë 12.12.2014, faqe 1, e ndryshuar.

vënien në shërbim të nënsistemit të mbuluar nga kjo rregullore.

2. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, ASH-ja njofton ministrinë, në lidhje me informacionin e mëposhtëm:

a) rregullat kombëtare të përmendura në paragrafin 1;

b) procedurat e vlerësimit dhe verifikimit të konformitetit që duhen kryer për të zbatuar rregullat kombëtare të përmendura në paragrafin 1;

c) organet e caktuara për të kryer procedurat e vlerësimit dhe verifikimit të konformitetit për rregullat kombëtare që lidhen me rastet specifike të përcaktuara në pikën 7.7 të aneksit.

Neni 5
Njoftimi i marrëveshjeve dypalëshe

1. ASH-ja njofton ministrinë për çdo marrëveshje ekzistuese kombëtare, dypalëshe, shumëpalëshe ose ndërkombëtare midis shtetit dhe sipërmarrjeve hekurudhore, administratorëve të infrastrukturës ose vendeve joanëtare, të cilat kërkohen nga natyra shumë specifike ose lokale e shërbimit hekurudhor të synuar ose që ofrojnë nivele të konsiderueshme të ndërveprimit lokal ose rajonal.

2. Ky detyrim nuk zbatohet për marrëveshjet që janë njoftuar më parë.

3. ASH-ja njofton menjëherë ministrinë për çdo marrëveshje të ardhshme ose ndryshim të marrëveshjeve ekzistuese.

Neni 6
Projektet në një fazë të avancuar zhvillimi

Për projektet në një fazë të avancuar zhvillimi, zbatohet neni 134, pika 2 e Kodit, "Moszbatimi i kushteve teknike të ndërveprimit TSI".

Neni 7
Certifikata e verifikimit 'CE'

1. Një certifikatë verifikimi 'CE' për një nënsistem që përmban përbërës të ndërveprimit të cilët nuk kanë një deklaratë 'CE' të konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorim, mund të lëshohet gjatë një periudhe kalimtare deri në ngritjen e organit të certifikimit, me kusht që të përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikën 6.5 të aneksit.

2. Prodhimi, përmirësimi ose rinovimi i nënsistemit me përdorimin e përbërësve të pacertifikuar të ndërveprimit duhet të përfundojë brenda periudhës kalimtare të përcaktuar në paragrafin 1, duke përfshirë edhe vënien e tij në shërbim.

3. Gjatë periudhës kalimtare të përcaktuar në paragrafin 1:

a) arsyet për moscertifikimin e çdo përbërësi të ndërveprimit duhet të identifikohen siç duhet nga organi i njoftuar përpara dhënies së certifikatës 'CE';

b) ASH-ja, në përputhje me detyrat e caktuara në Kod dhe akte të tjera në zbatim të Kodit, duhet të raportojë mbi përdorimin e përbërësve të ndërveprimit të pacertifikuar në kontekstin e procedurave të autorizimit në raportin vjetor.

4. Përbërësit e ndërveprimit të prodhuar rishtazi do të mbulohen nga deklarata 'CE' e konformitetit ose e përshtatshmërisë për përdorim.

Neni 8
Vlerësimi i konformitetit

1. Procedurat për vlerësimin e konformitetit, përshtatshmërisë për përdorim dhe verifikimit 'CE' të përcaktuara në seksionin 6, të aneksit do të bazohen në rregulloren "Mbi modulet për procedurat për vlerësimin e konformitetit, përshtatshmërisë për përdorim dhe verifikimin 'CE' që do të përdoren në kushtet teknike për ndërveprim".

2. Certifikata e ekzaminimit të tipit ose të projektimit të përbërësve të ndërveprimit është e vlefshme për një periudhë shtatëvjeçare. Gjatë kësaj periudhe, përbërësit e rinj të të njëjtit lloj lejohen të vihen në shërbim pa një vlerësim të ri të konformitetit.

3. Certifikatat e përmendura në paragrafin 2, të cilat janë lëshuar më parë, mbeten të vlefshme, pa pasur nevojë për një vlerësim të ri të konformitetit, deri në datën e përfundimit të përcaktuar fillimisht. Për të rinovuar një certifikatë, projekti ose tipi duhet të rivlerësohet vetëm sipas kërkesave të reja ose të modifikuara të përcaktuara në aneksin e kësaj rregulloreje.

Neni 9
Zbatimi

1. Seksioni 7 i Aneksit përcakton hapat që duhen ndjekur për zbatimin e një nënsistemi infrastrukture plotësisht ndërveprues. ASH-ja përgatit një plan

kombëtar zbatimi, duke përshkruar veprimet e tij në përputhje me këtë TSI dhe njofton ministrinë.

2. ASH-ja i dërgon ministrisë një raport mbi zbatimin, në lidhje me nënsistemin infrastrukturë tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 10
Zgjidhje novatore

1. Për të mbajtur ritmin me progresin teknologjik, mund të kërkohen zgjidhje novatore, të cilat nuk përputhen me specifikimet e përcaktuara në aneks ose për të cilat metodat e vlerësimit të përcaktuara në aneks nuk mund të zbatohen.

2. Zgjidhjet novatore mund të lidhen me nënsistemin e infrastrukturës, pjesët e tij dhe përbërësit e tij të ndërveprimit.

3. Nëse propozohet një zgjidhje novatore, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar deklaron se si ajo devijon nga ose plotëson dispozitat përkatëse të kësaj TSI-je dhe i paraqet devijimet tek ASH-ja për analizë, i cili, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë mendimin e Agjencisë Evropiane të Hekurudhave, ERA, për zgjidhjen e propozuar novatore.

4. ASH-ja jep një opinion mbi zgjidhjen e propozuar novatore. Nëse ky opinion është pozitiv, specifikimet e duhura funksionale, të ndërveprimit dhe metoda e vlerësimit, të cilat duhet të përfshihen në TSI për të lejuar përdorimin e kësaj zgjidhjeje novatore, do të zhvillohen dhe më pas të integrohen në TSI gjatë procesit të rishikimit, në përputhje në përputhje me nenin 135, të Kodit. Nëse opinioni është negativ, zgjidhja e propozuar novatore nuk mund të përdoret.

5. Në pritje të shqyrtimit të TSI-së, opinioni pozitiv i dhënë nga ASH-ja konsiderohet si një mjet i pranueshëm përputhshmërie me kërkesat thelbësore të Kodit dhe mund të përdoret për vlerësimin e nënsistemit.

Neni 11
Dispozitat përfundimtare

TSI-të për infrastrukturën vazhdojnë të zbatohen, për:

a) nënsistemet e autorizuara më parë;

b) projekte për nënsisteme të reja, të rinovuara ose të përmirësuara, të cilat, me hyrjen të kësaj rregulloreje, janë në një fazë të avancuar zhvillimi ose janë objekt i një kontrate në vazhdim.

ANEKSI

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje
1.1 Fushëveprimi teknik
1.2 Shtrirja gjeografike
1.3 Përmbajtja e kësaj TSI-je
2. Përkufizimi dhe fushëveprimi i nënsistemit
2.1 Përkufizimi i nënsistemit të infrastrukturës
2.2 Ndërveprimet e kësaj TSI-je me TSI-të e tjera
2.3 Ndërveprimet e kësaj TSI-je me TSI-në e personave me lëvizshmëri të kufizuar
2.4 Ndërveprimet e kësaj TSI-je me TSI-në e sigurisë në tunelet hekurudhore
2.5 Lidhja me sistemin e menaxhimit të sigurisë
3. Kërkesat thelbësore
4. Përshkrimi i nënsistemit të infrastrukturës
4.1 Hyrje
4.2 Specifikimet funksionale dhe teknike të nënsistemit
4.2.1 Kategoritë e linjës TSI
4.2.2 Parametrat bazë që karakterizojnë nënsistemin e infrastrukturës
4.2.3 Paraqitja e vijës hekurudhore
4.2.4 Parametrat e vijës hekurudhore
4.2.5 Ndërrueset hekurudhore
4.2.6 Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave të aplikuara
4.2.7 Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut
4.2.8 Kufizimet e ndërhyrjes së menjëhershme në defektet e gjeometrisë së vijës hekurudhore

4.2.9 Platformat
4.2.10 Shëndeti, siguria dhe mjedisi
4.2.11 Dispozitë për funksionim
4.2.12 Instalime fikse për mirëmbajtjen e trenave
4.3 Specifikimi funksional dhe teknik i ndërveprimit
4.3.1 Ndërveprimet me nënsistemin e mjeteve hekurudhore
4.3.2 Ndërveprimet me nënsistemin e energjisë
4.3.3 Ndërveprimet me nënsistemin e komandës së kontrollit dhe sinjalizimit
4.3.4 Ndërveprimet me nënsistemin e operimit dhe menaxhimit të trafikut
4.4 Rregullat e funksionimit
4.5 Rregullat e mirëmbajtjes
4.5.1 Dosja e mirëmbajtjes
4.5.2 Plani i mirëmbajtjes
4.6 Kualifikimet profesionale
4.7 Kushtet e shëndetit dhe sigurisë
5. Përbërësit e ndërveprimit
5.1 Baza mbi të cilën janë përzgjedhur përbërësit e ndërveprimit
5.2 Lista e përbërësve
5.3 Performancat dhe specifikimet e përbërësve
5.3.1 Shinat
5.3.2 Sistemet e fiksimit të shinave
5.3.3 Traversat në shina
6. Vlerësimi i konformitetit të përbërësve të ndërveprimit dhe verifikimi CE i nënsistemeve
6.1 Përbërësit e ndërveprimit
6.1.1 Procedurat e vlerësimit të konformitetit
6.1.2 Zbatimi i moduleve
6.1.3 Zgjidhje novatore për përbërësit e ndërveprimit
6.1.4 Deklarata CE e konformitetit për përbërësit e ndërveprimit
6.1.5 Procedurat e veçanta të vlerësimit për përbërësit e ndërveprimit
6.2 Nënsistemi i infrastrukturës
6.2.1 Dispozita të përgjithshme
6.2.2 Zbatimi i moduleve
6.2.3 Zgjidhje novatore
6.2.4 Procedura të veçanta vlerësimi për nënsistemin e infrastrukturës
6.2.5 Zgjidhje teknike që japin supozim konformiteti në fazën e projektimit
6.3 Verifikimi CE kur shpejtësia përdoret si kriter kalimi
6.4 Vlerësimi i dosjes së mirëmbajtjes
6.5 Nënsisteme që përmbajnë përbërës të ndërveprimit që nuk kanë një deklaratë CE
6.5.1 Kushtet
6.5.2 Dokumentacioni
6.5.3 Mirëmbajtja e nënsistemeve të certifikuara sipas 6.5.1
6.6 Nënsistemi që përmban përbërës të ndërveprimit të nevojshëm që janë të përshtatshëm për ripërdorim
6.6.1 Kushtet
6.6.2 Dokumentacioni
6.6.3 Përdorimi i përbërësve të ndërveprimit të nevojshëm në mirëmbajtje
7. Zbatimi i TSI-së së infrastrukturës
7.1 Zbatimi i kësaj TSI-je në linjat hekurudhore
7.2 Zbatimi i kësaj TSI-je në linjat e reja hekurudhore
7.3 Zbatimi i kësaj TSI-je në linjat ekzistuese hekurudhore
7.3.1 Rinovimi i një linje
7.3.3 Zëvendësimi në kuadër të mirëmbajtjes
7.3.4 Linjat ekzistuese që nuk i nënshtrohen një projekti rinovimi ose përmirësimi
7.4 Zbatimi i kësaj TSI-je në platformat ekzistuese
7.5. Shpejtësia si kriter zbatimi

7.6 Konstatimi i përputhshmërisë së infrastrukturës dhe mjeteve hekurudhore pas autorizimit të mjeteve hekurudhore
Shtojca A – Vlerësimi i përbërësve të ndërveprimit
Shtojca B – Vlerësimi i nënsistemit të infrastrukturës
Shtojca C – Karakteristikat teknike të projektimit të vijës hekurudhore dhe të ndërruesve
Shtojca Ç – Kushtet e përdorimit të projektimit të vijës hekurudhore dhe të ndërruesve
Shtojca D – Kërkesat e aftësisë për strukturat sipas kodit të trafikut
Shtojca DH – Garanci sigurie mbi kalimet e gjera
Shtojca E – Baza e kërkesave minimale për strukturat për vagonët e udhëtarëve dhe njësitë e shumëfishta
Shtojca Ë – Lista e pikave të hapura
Shtojca F – Fjalor
Shtojca G – Specifikimet teknike të referuara në këtë TSI

1. Hyrje

1.1 Fushëveprimi teknik

Kjo TSI ka të bëjë me nënsistemin e infrastrukturës dhe një pjesë të nënsistemit të mirëmbajtjes së sistemit hekurudhor shqiptar. Nënsistemet e infrastrukturës dhe të mirëmbajtjes përcaktohen përkatësisht në pikat 2, shkronjat "a", pika "i" dhe "b", pika "ii", të nenit 143 të Kodit. Fusha teknike e kësaj TSI-je përcaktohet më tej në nenin 2, pikat 1, 5 dhe 6, të kësaj rregulloreje.

1.2 Shtrirja gjeografike

Shtrirja gjeografike e kësaj TSI-je përcaktohet në nenin 2, pika 4 të kësaj rregulloreje.

1.3 Përmbajtja e kësaj TSI-je

1. Në përputhje me nenin 143, pika 3, e Kodit, kjo TSI:

a) tregon fushëveprimin e synuar (seksioni 2);

b) përcakton kërkesat thelbësore për infrastrukturën dhe një pjesë të nënsistemeve të mirëmbajtjes (seksioni 3);

c) përcakton specifikimet funksionale dhe teknike që duhet të përmbushen nga infrastruktura dhe një pjesë e nënsistemeve të mirëmbajtjes dhe ndërveprimet e saj në raport me nënsistemet e tjera (seksioni 4);

ç) specifikon përbërësit dhe lidhjet e ndërveprimit që duhet të mbulohen nga specifikimet evropiane, duke përfshirë standardet evropiane, të cilat janë të nevojshme për të arritur ndërveprimin brenda sistemit hekurudhor (seksioni 5);

d) përcakton, në secilin rast në shqyrtim, cilat procedura duhet të përdoren për të vlerësuar konformitetin ose përshtatshmërinë për përdorim të përbërësve të ndërveprimit, nga njëra anë, ose verifikimin CE të nënsistemeve, nga ana tjetër (seksioni 6);

dh) tregon strategjinë për zbatimin e kësaj TSI-je (seksioni 7);

e) tregon, për stafin përkatës, kualifikimet profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë të kërkuara për funksionimin dhe mirëmbajtjen e nënsistemit të infrastrukturës, si dhe për zbatimin e kësaj TSI-je (seksioni 4);

ë) tregon dispozitat e zbatueshme për nënsistemin ekzistues të infrastrukturës, veçanërisht në rast të përmirësimit dhe rinovimit dhe, në raste të tilla, punimeve të modifikimit që kërkojnë një kërkesë për një autorizim të ri;

f) tregon parametrat e nënsistemit të infrastrukturës që duhen kontrolluar nga sipërmarrja hekurudhore dhe procedurat që duhen zbatuar për të kontrolluar këto parametra pas dorëzimit të autorizimit të mjetit për vendosje në treg dhe para përdorimit të parë të mjetit për të siguruar përputhshmërinë midis mjeteve dhe itinerareve në të cilat ato do të operohen. Dispozitat për raste specifike tregohen në seksionin 7.

2. Kërkesat në këtë TSI janë të vlefshme për të gjitha sistemet e gjerësisë së vijave hekurudhore brenda fushëveprimit të kësaj TSI-je, përveç nëse një paragraf i referohet sistemeve specifike të gjerësisë së vijave hekurudhore ose gjerësive nominale specifike të vijave hekurudhore.

2.Përkufizimi dhe fushëveprimi i nënsistemit

2.1 Përkufizimi i nënsistemit të infrastrukturës

Kjo TSI mbulon:

a) nënsistemin strukturor të infrastrukturës,

b) pjesën e nënsistemit funksional të mirëmbajtjes që lidhet me nënsistemin e infrastrukturës (domethënë: impiantet e larjes për pastrimin e jashtëm të trenave, rimbushja e furnizimit me ujë, furnizimi me karburant, instalimet fikse për shkarkimin e tualeteve dhe furnizimet elektrike në binarë).

Fushëveprimi i kësaj TSI-je përfshin aspektet e mëposhtme të nënsistemit të infrastrukturës:

a) Paraqitja e linjës;

b) Parametrat e vijës hekurudhore;

c) Ndërruese hekurudhore;

ç) Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave të aplikuara;

d) Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut;

dh) Kufizimet e ndërhyrjes së menjëhershme në defektet e gjeometrisë së vijës hekurudhore;

e) Platformat;

ë) Shëndeti, siguria dhe mjedisi;

f) Dispozicion për funksionim;

g) Instalime fikse për mirëmbajtjen e trenave.

Detajet e mëtejshme përcaktohen në pikën 4.2.2 të kësaj TSI-je.

2.2 Ndërveprimet e kësaj TSI-je me TSI-të e tjera

Pika 4.3 e kësaj TSI-je përcakton specifikimet funksionale dhe teknike të ndërveprimeve me nënsistemet e mëposhtme, siç përcaktohen në TSI-të përkatëse:

a) Nënsistemi i mjeteve hekurudhore,

b) Nënsistemi i energjisë,

c) Nënsistemi i komandës, kontrollit dhe sinjalizimit,

ç) Nënsistemi i operimit dhe menaxhimit të trafikut.

Ndërveprimet me TSI-në e personave me lëvizshmëri të kufizuar (TSI PRM) përshkruhen në pikën 2.3 më poshtë, ndërsa me TSI-në e sigurisë në tunelet hekurudhore (TSI SRT) përshkruhen në pikën 2.4 më poshtë.

2.3 Lidhjet e kësaj TSI-je me TSI-në e personave me lëvizshmëri të kufizuar

Të gjitha kërkesat që lidhen me nënsistemin e infrastrukturës për aksesin e personave me lëvizshmëri të kufizuar në sistemin hekurudhor janë përcaktuar në TSI-në e personave me lëvizshmëri të kufizuar.

2.4 Lidhjet e kësaj TSI-je me TSI-në e sigurisë në tunelet hekurudhore

Të gjitha kërkesat që lidhen me nënsistemin e infrastrukturës për sigurinë në tunelet hekurudhore janë përcaktuar në TSI-në e sigurisë në tunelet hekurudhore.

2.5 Lidhja me sistemin e menaxhimit të sigurisë

Proceset e nevojshme për të menaxhuar sigurinë dhe operacionet sipas kërkesave në fushëveprimin e kësaj TSI-je, duke përfshirë ndërveprimet me njerëzit, organizatat ose sisteme të tjera teknike, duhet të hartohen dhe zbatohen në sistemin e menaxhimit të sigurisë të administratorit të infrastrukturës, siç kërkohet nga Kodi.

2.6 Lidhja me kodifikimin e transportit të kombinuar

1. Dispozitat për dimensionin e seksionit të lirë përcaktohen në pikën 4.2.3.1.

2. Sistemi i kodifikimit të përdorur për transportimin e njësive të ngarkesës intermodale në transportin e kombinuar duhet të jetë në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi A. Ai bazohet në:

a) karakteristikat e vijës dhe pozicioni i saktë i pengesave;

b) profili i referencës së dimensionit të seksionit të lirë të asaj linje;

c) një kombinim i metodave të përmendura në pikat "a" dhe "b".

3. Kërkesat thelbësore

Tabela e mëposhtme tregon parametrat bazë të kësaj TSI-je dhe korrespondencën e tyre me kërkesat thelbësore siç përcaktohen në Kod.

Tabela 1: Parametrat bazë të nënsistemit të infrastrukturës që korrespondojnë me kërkesat thelbësore

Pika TSI	Titulli i pikës TSI	Siguria	Besueshmëria, disponueshmëria	Shëndetësi	Mbrojtja e mjedisit	Përputhshmëria teknike	Aksesueshmëria
4.2.3.1	Dimensioni i profilit të lirë	1.1.1, 2.1.1				1.5	
4.2.3.2	Distanca midis qendrave të shinave	1.1.1, 2.1.1				1.5	

4.2.3.3	Pjerrësitë maksimale	1.1.1				1.5	
4.2.3.4	Rrezja më e vogël e lejueshme e kthesës hekurudhore në planin horizontal të një vije hekurudhore	1.1.3				1.5	
4.2.3.5	Rrezja më e vogël e harkut që formohet në drejtimin vertikal të vijës hekurudhore	1.1.3				1.5	
4.2.4.1	Gjerësia nominale e vijës hekurudhore					1.5	
4.2.4.2	Ndryshimi në lartësi midis dy shinave në një seksion të lakuar (mbilartësimi)	1.1.1, 2.1.1				1.5	1.6.1
4.2.4.3	Mbilartësimi i shinës së jashtme në kthesat hekurudhore, më i vogël për shpejtësinë e lejuar	1.1.1				1.5	
4.2.4.4	Mbilartësimi i shinës së jashtme në kthesat hekurudhore	2.1.1					
4.2.4.5	Koniciteti ekuivalent	1.1.1, 1.1.2				1.5	
4.2.4.6	Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë	1.1.1, 1.1.2				1.5	
4.2.4.7	Pjerrësia e vijave hekurudhore	1.1.1, 1.1.2				1.5	
4.2.5.1	Gjeometria e projektimit të ndërruesve hekurudhorë	1.1.1, 1.1.2, 1.1.3				1.5	
4.2.5.2	Përdorimi i pajisjeve në ndërrueset hekurudhore	1.1.2, 1.1.3					

4.2.5.3	Gjatësia maksimale e pa udhëzuar në ndërrueset hekurudhore me dy zemra (Tip Obtuse)	1.1.1, 1.1.2				1.5	
4.2.6.1	Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale	1.1.1, 1.1.2, 1.1.3				1.5	
4.2.6.2	Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave gjatësore	1.1.1, 1.1.2, 1.1.3				1.5	
4.2.6.3	Rezistenca anësore e vijës hekurudhore	1.1.1, 1.1.2, 1.1.3				1.5	
4.2.7.1	Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut	1.1.1, 1.1.3				1.5	
4.2.7.2	Ngarkesë vertikale ekuivalente për punimet e reja të dheut dhe efektet e presionit të tokës të imponuara në strukturat e reja	1.1.1, 1.1.3				1.5	
4.2.7.3	Rezistenca e strukturave të reja mbi ose ngjitur me shinat	1.1.1, 1.1.3				1.5	
4.2.7.4	Rezistenca e urave dhe punimeve ekzistuese të tokës ndaj ngarkesave të trafikut	1.1.1, 1.1.3				1.5	
4.2.8.1	Kufiri i veprimit të menjëhershëm për shtrirjen	1.1.1, 1.1.2	1.2				
4.2.8.2	Kufiri i veprimit të menjëhershëm për nivelin vertikal të vijës hekurudhore	1.1.1, 1.1.2	1.2				

4.2.8.3	Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për disnivelin e shinave në vijën hekurudhore	1.1.1, 1.1.2	1.2				
4.2.8.4	Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për hapjen e vijës hekurudhore mbi vlerat e lejuara	1.1.1, 1.1.2	1.2				
4.2.8.5	Kufiri i veprimit të menjëhershëm për mbilartësimin jo normal të vijës hekurudhore	1.1.1, 1.1.2	1.2				
4.2.8.6	Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme në ndërruesit hekurudhorë	1.1.1, 1.1.2	1.2			1.5	
4.2.9.1	Gjatësia e përdorshme e platformave	1.1.1, 2.1.1				1.5	
4.2.9.2	Lartësia e platformës	1.1.1, 2.1.1				1.5	1.6.1
4.2.9.3	Distanca horizontale midis aksit të vijës hekurudhore dhe buzës së platformës të stacionit	1.1.1, 2.1.1				1.5	1.6.1
4.2.9.4	Planifikimi i vijës hekurudhore përgjatë platformave	1.1.1, 2.1.1				1.5	1.6.1
4.2.10.1	Ndryshimet maksimale të presionit në tunele	1.1.1, 2.1.1				1.5	
4.2.10.2	Efekti i erërave tërthore	1.1.1, 2.1.1	1.2			1.5	
4.2.10.3	Efekti aerodinamik në vijat hekurudhore me balast	1.1.1	1.2			1.5	

4.2.11.1	Shenjat e vendndodhjes	1.1.1	1.2				
4.2.11.2	Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal	1.1.1, 1.1.2				1.5	
4.2.12.2	Shkarkimi i tualetit	1.1.5	1.2	1.3.1		1.5	
4.2.12.3	Pajisjet e pastrimit të jashtëm të trenit		1.2			1.5	
4.2.12.4	Rimbushja e rezervave me ujë	1.1.5	1.2	1.3.1		1.5	
4.2.12.5	Furnizimi me karburant	1.1.5	1.2	1.3.1		1.5	
4.2.12.6	Furnizim elektrik nga burim i jashtëm	1.1.5	1.2			1.5	
4.4	Rregullat e funksionimit		1.2				
4.5	Rregullat e mirëmbajtjes		1.2				
4.6	Kualifikimet profesionale	1.1.5	1.2				
4.7	Kushtet e shëndetit dhe sigurisë	1.1.5	1.2	1.3	1.4.1		

4. Përshkrimi i nënsistemit të infrastrukturës

4.1 Hyrje

1. Sistemi hekurudhor për të cilin zbatohet Kodi dhe pjesë e së cilës janë nënsistemet e infrastrukturës dhe mirëmbajtjes, është një sistem i integruar, qëndrueshmëria e të cilit duhet të verifikohet. Kjo qëndrueshmëri duhet të kontrollohet në veçanti, në lidhje me specifikimet e nënsistemit të infrastrukturës, ndërveprimet e tij në lidhje me nënsistemet e tjera të sistemit hekurudhor në të cilin është integruar, si dhe rregullat e operimit dhe mirëmbajtjes.

2. Vlerat kufizuese të përcaktuara në këtë TSI nuk synojnë të imponohen si vlera të zakonshme të projektimit. Megjithatë, vlerat e projektimit duhet të jenë brenda kufijve të përcaktuar në këtë TSI.

3. Specifikimet funksionale dhe teknike të infrastrukturës dhe një pjese të nënsistemeve të mirëmbajtjes dhe ndërveprimeve të tyre, siç përshkruhen në pikat 4.2 dhe 4.3, nuk imponojnë përdorimin e teknologjive ose zgjidhjeve teknike specifike, përveç rasteve kur kjo është rreptësisht e nevojshme për ndërveprimin e sistemit hekurudhor.

4. Zgjidhjet novatore për ndërveprimin të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e specifikuara në këtë TSI dhe të cilat nuk janë të vlerësueshme siç përcaktohet në këtë TSI, kërkojnë specifikime të reja dhe metoda të reja vlerësimi. Për të lejuar inovacionin teknologjik, këto specifikime dhe metoda vlerësimi duhet të zhvillohen sipas procesit për zgjidhje novatore të përshkruara në nenin 10.

5. Kur bëhet referencë për standardet EN, çdo ndryshim i quajtur 'devijime kombëtare' në EN nuk zbatohet, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë TSI.

6. Kur shpejtësitë e linjës deklarohen në (km/orë) si një kategori ose parametër performance në këtë TSI, lejohet përkthimi i shpejtësisë në ekuivalentin (mph).

4.2 Specifikimet funksionale dhe teknike të nënsistemit të infrastrukturës

4.2.1 Kategoritë e linjës TSI

1. Elementet e infrastrukturës hekurudhore përcaktohen në nenin 111 të Kodit. Me qëllim që të ofrohet ndërveprimi me kosto efektive, çdo elementi të rrjetit hekurudhor do i caktohet një 'kategori linje TSI'.

2. Kategoria TSI e linjës duhet të jetë një kombinim i kodeve të trafikut. Për linjat ku kryhet vetëm një lloj trafiku (për shembull, një linjë vetëm mallrash), mund të përdoret një kod i vetëm për të përshkruar performancën; aty ku zhvillohet trafik i përzier, kategoria do të përshkruhet nga një ose më shumë kode për udhëtarë dhe mallra. Kodet e kombinuara të trafikut përshkruajnë gamën brenda së cilës mund të akomodohet përzierja e dëshiruar e trafikut.

3. Këto kategori të linjave TSI do të përdoren për klasifikimin e linjave ekzistuese për të përcaktuar një sistem të synuar në mënyrë që të përmbushen parametrat përkatës të performancës.

4. Linjat duhet të klasifikohen bazuar në llojin e trafikut (kodin e trafikut) të karakterizuar nga parametrat e mëposhtëm të performancës:

- dimensioni i profilit të lirë;
- ngarkesa aksiale;
- shpejtësia e linjës;
- gjatësia e trenit;
- gjatësia e përdorshme e platformës.

Vlerat në kolonat për 'Dimensioni i profilit të lirë' dhe 'ngarkesës aksiale', të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në lëvizjen e trenit, duhet të jenë nivele minimale të detyrueshme sipas kodit të trafikut të synuar. Pavarësisht kërkesave të TEN-T, diapazoni i vlerave të treguara në kolonat për 'shpejtësinë e linjës', 'gjatësinë e përdorshme të platformës' dhe 'gjatësinë e trenit' duhet të zbatohet, për sa kohë që është praktikisht e arsyeshme.

5. Parametrat e performancës të listuara në tabelën 2 dhe tabelën 3 nuk synojnë të përdoren për kontrollet e përputhshmërisë midis mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës. Kontrollet e përputhshmërisë së itinerarit i nënshtrohen pikës 4.2.2.5.

6. Informacioni që përcakton kërkesat minimale të aftësive për strukturat ekzistuese, në lidhje me llojet e ndryshme të trenave është dhënë në shtojcën D.

7. Nivelet e performancës për llojet e trafikut janë përcaktuar në tabelën 2 dhe tabelën 3.

Tabela 2: Parametrat e performancës së infrastrukturës për trafikun e pasagjerëve (kontrollet e përputhshmërisë së itinerarit i nënshtrohen pikës 4.2.2.5 dhe shtojcës D.1 të TSI OPE)

Kodi i trafikut	Dimensioni i profilit të lirë	Ngarkesa aksiale (t)	Shpejtësia e linjës (km/orë)	Gjatësia e përdorshme e platformës (m)
P1	GC	17 (1)/21,5 (2)	250 -350	400
P2	GB	20 (1)/22,5 (2)	200 -250	200 -400
P3	DE3	22,5 (3)	120 -200	200 -400
P4	GB	22,5 (3)	120 -200	200 -400
P5	GA	20 (3)	80 -120	50 -200
P6	G1	12 (3)	jo	jo
P1520	S	22,5 (3)	80 -160	35 -400
P1600	IRL1	22,5 (3)	80 -160	75 -240

(1) Vlerat minimale të kërkuara të ngarkesës aksiale që do të përdoren për kontrollet e urave, duke përdorur një vlerësim dinamik, bazuar në masën e projektimit në gjendje pune për kokat e fuqisë dhe lokomotivat, dhe masën operative nën ngarkesë normale për mjetet e afta të mbajnë një ngarkesë udhëtarësh ose bagazhesh (përkufizimet e masës në përputhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (1).

(2) Vlerat minimale të kërkuara të ngarkesës boshtore që do të përdoren për kontrollet e infrastrukturës, duke përdorur një ngarkesë statike, bazuar në masën e projektuar nën ngarkesë të jashtëzakonshme për mjetet e afta të mbajnë një ngarkesë udhëtarësh ose bagazhesh (përkufizimet e masës, në përputhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (1), në lidhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (2)). Kjo ngarkesë boshtore mund të lidhet me shpejtësi të kufizuar.

(3) Të përdoret për kontrollet e infrastrukturës së përdorur për ngarkesë statike, bazuar në masën e projektuar në gjendje pune për kokat e fuqisë dhe lokomotivat, dhe masën e projektuar nën ngarkesë të jashtëzakonshme për mjete të tjera

(përkufizimet e masës, në përputhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (1), në lidhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (2)). Kjo ngarkesë boshtore mund të lidhet me shpejtësi të kufizuar.

Tabela 3: Parametrat e performancës së infrastrukturës për trafikun e mallrave (kontrollet e përputhshmërisë së itinerarit i nënshtrohen pikës 4.2.2.5)

Kodi i trafikut	Dimensioni i profilit të lirë	Ngarkesa aksiale (t)	Shpejtësia e linjës (km/orë)	Gjatësia e trenit (m)
F1	GC	22,5 (1)	100 -120	740 -1 050
F2	GB	22,5 (1)	100 -120	600 -1 050
F3	GA	20 (1)	60 -100	500 -1 050
F4	G1	18 (1)	jo	jo
F1520	S	25 (1)	50 -120	1 050
F1600	IRL1	22,5 (1)	50 -100	150 -450
(1) Për t'u përdorur për kontrolle statike të infrastrukturës, bazuar në masën e projektuar në gjendje pune për kokat e fuqisë dhe lokomotivat dhe masën e projektuar nën ngarkesë normale për mjete të tjera (përkufizimet e masës në përputhje me specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (1)). Kjo ngarkesë aksiale mund të lidhet me shpejtësi të kufizuar.				

Shënim. Tabelat 2 dhe 3 nuk duhen përdorur për verifikime të përputhshmërisë midis mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës.

8. Për strukturat, ngarkesa aksiale në vetvete nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar kërkesat për infrastrukturën. Kërkesat specifikohen si më poshtë:

- për strukturat e reja, në pikat 4.2.7.1 dhe 4.2.7.2,
- për strukturat ekzistuese, në pikën 4.2.7.4,
- për shinën, në pikën 4.2.6.

9. Qendrat e udhëtarëve, qendrat e mallrave dhe linjat lidhëse përfshihen në kodet e trafikut të mësipërme, sipas rastit.

10. Në përputhje me nenin 133, të Kodit, i cili parashikon që TSI-të nuk pengojnë vendosjen për përdorimin e infrastrukturave për lëvizjen e mjeteve që nuk mbulohen nga TSI-të, lejohet të projektohen linja të reja dhe të përmirësuara të afta të akomodojnë:

- dimension të profilit të lirë më të mëdhenj;
- ngarkesa më të larta për aks;
- shpejtësi më të mëdha;
- gjatësia e përdorshme e platformës është më e madhe;
- trena më të gjatë,

sesa ato të specifikuara në tabelën 2 dhe tabelën 3.

11. Lejohet të projektohen seksione të caktuara të vijës hekurudhore për shpejtësi linje, gjatësi të dobishme të platformave dhe gjatësi trenash më të ulëta se ato të treguara në tabelat 2 dhe 3, nëse kjo justifikohet siç duhet nga kërkesat gjeografike, urbane ose mjedisore.

4.2.2 Parametrat bazë që karakterizojnë nënsistemin e infrastrukturës

4.2.2.1 Lista e parametrave bazë

Parametrat bazë që karakterizojnë nënsistemin e infrastrukturës, të grupuar sipas parametrave të listuar në pikën 2.1, janë:

A. Paraqitja e vijës hekurudhore:

a) Dimensioni i profilit të lirë (4.2.3.1);

b) Distanca midis akseve të vijës hekurudhore (4.2.3.2);

c) Pjerrësi maksimale (4.2.3.3);

d) Rrezja minimale e kthesës në planin horizontal (4.2.3.4);

e) Rrezja minimale e kthesës në planin vertikal (4.2.3.5).

B. Parametrat e vijës hekurudhore:

a) Gjerësia nominale e vijës hekurudhore (4.2.4.1);

b) Pjerrësia (4.2.4.2);

c) Pjerrësia maksimale (4.2.4.3);

ç) Ndryshim i menjëhershëm i pjerrësisë (4.2.4.4);

d) Koniciteti ekuivalent (4.2.4.5);

dh) Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë (4.2.4.6);

e) Këndi i pjerrësisë së shinave (4.2.4.7).

C. Ndërruesit hekurudhorë

a) Gjeometria e projektimit të ndërruesve (4.2.5.1);

b) Përdorimi i pajisjeve në ndërrueset hekurudhore (4.2.5.2);

c) Gjatësia maksimale e pa udhëzuar në ndërrueset hekurudhore me dy zemra (Tip Obtuse) (4.2.5.3).

Ç. Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave të aplikuara:

a) Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale (4.2.6.1);

b) Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave gjatësore (4.2.6.2);

c) Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave anësore (4.2.6.3).

D. Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut:

a) Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut (4.2.7.1);

b) Ngarkesa vertikale ekuivalente për punimet e reja të dheut dhe efektet e presionit të tokës të imponuara në strukturat e reja (4.2.7.2);

c) Rezistenca e strukturave të reja mbi ose ngjitur me shinat (4.2.7.3);

d) Rezistenca e urave dhe punimeve të dheut ekzistuese ndaj ngarkesave të trafikut (4.2.7.4).

DH. Kufizime të menjëhershme për veprimin ndaj defekteve të gjeometrisë së vijës hekurudhore

a) Kufiri i veprimit të menjëhershëm për drejtimin e vijës hekurudhore (4.2.8.1);

b) Kufiri i veprimit të menjëhershëm për nivelin vertikal të vijës hekurudhore (4.2.8.2);

c) Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për disnivelin e shinave në vijën hekurudhore (4.2.8.3);

ç) Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për hapjen e vijës hekurudhore mbi vlerat e lejuara (4.2.8.4);

d) Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për mbilartësimin jo normal në vijën hekurudhore (4.2.8.5);

dh) Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme për ndërrueset hekurudhore (4.2.8.6).

E. Platformat

a) Gjatësia e përdorshme e platformave (4.2.9.1);

b) Lartësia e platformës (4.2.9.2);

c) Distanca horizontale midis aksit të vijës hekurudhore dhe buzës së platformës të stacionit (4.2.9.3);

d) Planifikimi i vijës hekurudhore përgjatë platformave (4.2.9.4).

Ë. Shëndeti, siguria dhe mjedisi:

a) Ndryshimi maksimal i presionit në tunele (4.2.10.1);

b) Efekti i erërave anësore (4.2.10.2);

c) Efekti aerodinamik në binarë me balast (4.2.10.3).

F. Dispozitë për funksionim

a) Shënuesit e vendndodhjes (4.2.11.1);

b) Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal (4.2.11.2).

G. Instalime fikse për mirëmbajtjen e trenave:

a) Të përgjithshme (4.2.12.1);

b) Shkarkimi i tualetit (4.2.12.2);

c) Pajisjet e pastrimit të jashtëm të trenit (4.2.12.3);

d) Rimbushja e rezervave me ujë (4.2.12.4);

e) Furnizimi me karburant (4.2.12.5);

f) Furnizim elektrik në linjë hekurudhore (4.2.12.6).

GJ. Rregullat e mirëmbajtjes:

a) Dosja e mirëmbajtjes (4.5.1);

b) Plani i mirëmbajtjes (4.5.2).

4.2.2.2 Kërkesat për parametrat bazë

1. Këto kërkesa përshkruhen në paragrafët vijues, së bashku me çdo kusht të veçantë që mund të lejohet në secilin rast për parametrat bazë dhe ndërveprimet përkatëse.

2. Vlerat e parametrave bazë të specifikuar janë të vlefshme vetëm deri në një shpejtësi maksimale të linjës prej 350 km/orë.

3. Në rastin e një linje me shumë vija hekurudhore, kërkesat e kësaj TSI-je duhet të zbatohen veçmas për secilën vijë hekurudhore që janë projektuar të përdoren si vija hekurudhore të veçanta.

4. Kërkesat për linjat që përfaqësojnë raste specifike përshkruhen në pikën 7.7.

5. Lejohet një seksion i shkurtër i binarit me pajisje që lejojnë kalimin midis gjerësive të ndryshme nominale të vijës hekurudhore.

6. Kërkesat përshkruhen për nënsistemin në kushte normale shërbimi. Pasojat, nëse ka, të ekzekutimit të punimeve, të cilat mund të kërkojnë përjashtime të përkohshme për sa i përket performancës së nënsistemit, trajtohen në pikën 4.4.

7. Nivelet e performancës së trenave mund të përmirësohen duke miratuar sisteme specifike, të tilla si pjerrësia e karrocerisë së mjetit. Lejohen kushte të veçanta për drejtimin e trenave të tillë, me kusht që ato të mos sjellin kufizime për trenat e tjerë që nuk janë të pajisur me sisteme të tilla.

4.2.3 Paraqitja e vijës hekurudhore

4.2.3.1 Dimensioni i seksionit të lirë

1. Pjesa e sipërme e dimensionit të profilit të lirë duhet të vendoset në bazë të gabariteve të zgjedhura në përputhje me pikën 4.2.1, të cilat janë përcaktuar në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 3.

2. Pjesa e poshtme e dimensionit të profilit të lirë duhet të jetë GI2 siç përcaktohet në specifikimin e referuar në indeksin e shtojcës G (3). Kur shinat janë të pajisura me frena shinash, dimensioni i strukturës GI1 siç përcaktohet në të njëjtin specifikim duhet të zbatohet për pjesën e poshtme të dimensionit.

3. Llogaritjet e dimensionit të profilit të lirë duhet të bëhen duke përdorur metodën kinematike në përputhje me kërkesat e specifikimit të përmendur në shtojcën G, indeksi 3.

4.2.3.2 Distanca midis akseve të vijave hekurudhore

1. Distanca midis akseve të vijave hekurudhore duhet të përcaktohet në bazë të përmasave të përzgjedhura sipas pikës 4.2.1.

2. Distanca nominale horizontale midis qendrave të vijave hekurudhore për linjat e reja duhet të specifikohet për projektimin dhe nuk duhet të jetë më e vogël se vlerat nga tabela 4; ajo merr në konsideratë kufijtë për efektet aerodinamike.

Tabela 4: Distanca minimale nominale horizontale midis qendrave të vijave hekurudhore

Shpejtësia maksimale e lejuar (km/orë)	Distanca minimale nominale horizontale midis akseve të vijës hekurudhore (m)
$160 < v \leq 200$	3,80
$200 < v \leq 250$	4,00
$250 < v \leq 300$	4,20
$v > 300$	4,50

3. Distanca midis qendrave të vijave hekurudhore duhet të përmbushë të paktën kërkesat për distancën limit të instalimit midis qendrave të vijave hekurudhore, të përcaktuara në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 3.

4.2.3.3 Pjerrësitë maksimale

1. Pjerrësia e vijave hekurudhore përmes platformave të udhëtarëve të linjave të reja nuk duhet të jetë më shumë se 2,5 mm/m, kur mjetet janë të destinuara të bashkëngjiten ose të shkëputen rregullisht.

2. Pjerrësia e vijave hekurudhore të reja të ambienteve të destinuara për parkimin e mjeteve hekurudhore nuk duhet të jetë më shumë se 2,5 mm/m, përveç nëse merren masa të veçanta për të parandaluar largimin e mjeteve hekurudhore.

3. Pjerrësi deri në 35 mm/m lejohen për vijat hekurudhore kryesore në linjat e reja P1 të dedikuara për transportin e udhëtarëve në fazën e projektimit, me kusht që të respektohen kërkesat e mëposhtme:

a) pjerrësia e profilit mesatar mbi 10 km është më e vogël ose e barabartë me 25 mm/m;

b) gjatësia maksimale e pjerrësisë së vazhdueshme prej 35 mm/m nuk i kalon 6 km.

4.2.3.4 Rrezja minimale e kthesës horizontale

Rrezja minimale e projektimit të kthesës horizontale duhet të zgjidhet duke marrë parasysh shpejtësinë lokale të projektimit të kthesës.

1. Rrezja minimale e lakimit horizontal të projektimit për linjat e reja nuk duhet të jetë më pak se 150 m.

2. Kthesat e kundërta, përveç në stacionet e manovrimit ku vagonët devijohen individualisht, me rreze të vogla për linjat e reja duhet të projektohen për të parandaluar ndalimin e detyruar të trenave me tupik (*buffer*). Tupik është një pajisje sigurie në fund të një linje që parandalon trenat të kalojnë pjesën fundore të shinave dhe të përplasen me ndërtesa ose pengesa të tjera. Për elementet e ndërmjetme të shinave të drejta midis kthesave, do të zbatohet specifikimi i referuar në shtojcën G, indeksi 4, vlerat e të cilit bazohen në mjetet referuese të përcaktuara në të njëjtin specifikim. Për të parandaluar ndalimin e detyruar të trenave për mjetet ekzistuese që nuk plotësojnë specifikimet e mjeteve referuese, administratori i infrastrukturës mund të llogarisë gjatësi më të gjata të elementit të ndërmjetëm të drejtë. Për elementet e ndërmjetme të shinave jo

të drejta, duhet të bëhet një llogaritje e detajuar për të kontrolluar madhësinë e ndryshimeve në ndalën fundore.

4.2.3.5 Rrezja minimale e kthesës vertikale

1. Rrezja e kthesave vertikale (me përjashtim të pjerrësive në sheshet e formimit të trenave) duhet të jetë të paktën 500 m pika më e lartë ose 900 m pika më e ulët.

2. Për pjerrësitë në sheshet e formimit të trenave, rrezja e kthesave vertikale duhet të jetë të paktën 250 m më e lartë ose 300 m pika më e ulët.

4.2.4 Parametrat e vijës hekurudhore

4.2.4.1 Gjerësia nominale e vijës hekurudhore

1. Gjerësia nominale standarde evropiane e vijës hekurudhore duhet të jetë 1435 mm.

4.2.4.2 Pjerrësia

1. Pjerrësia e projektimit për linjat duhet të kufizohet siç përcaktohet në tabelën 5.

Tabela 5: Pjerrësia e projektimit (mm)

	Mallra dhe trafik i përzier	Trafiku i udhëtarëve
Vija hekurudhore me balast	160	180
Vija hekurudhore pa balast	170	180

2. Mbilartësimi i projektuar në shinat e jashtme ngjitur me platformat e stacioneve ku trenat parashikohet të ndalojnë gjatë shërbimit normal nuk duhet të kalojë 110 mm.

3. Linja të reja me trafik të përzier ose mallrash në kthesa me një rreze më të vogël se 305 m dhe një kalim të pjerrësisë më të pjerrët se 1 mm/m, pjerrësia duhet të kufizohet në limitin e dhënë nga formula e mëposhtme:

$D \leq (R - 50)/1,5$

ku D është pjerrësia në mm dhe R është rrezja në m.

4.2.4.3 Pjerrësia maksimale

1. Vlerat për pjerrësinë maksimale janë përcaktuar në tabelën 6.

Tabela 6: Mbilartësimi maksimal i shinës (mm)

Shpejtësia e projektuar (km/orë)	$v \leq 160$	$160 < v \leq 300$	$v > 300$
Për operimin e mjeteve hekurudhore, në përputhje me TSI-në e lokomotivave dhe udhëtarëve	**153**		**100**
Për operimin e mjeteve hekurudhore, në përputhje me TSI-në e vagonëve të mallrave	**130**	**—**	**—**

2. Lejohet që trenat e projektuar posaçërisht për të udhëtuar me pjerrësi më të lartë (për shembull njësi të shumëfishta me ngarkesa aksi më të ulëta se ato të përcaktuara në tabelën 2; mjete me pajisje speciale për kalimin e kthesave) të qarkullojnë me vlera më të larta të pjerrësisë, me kusht që të demonstrohet se kjo mund të arrihet në mënyrë të sigurt.

4.2.4.4 Ndryshim i menjëhershëm i mbilartësimit të shinës

1. Vlerat maksimale të ndryshimit të menjëhershëm të mbilartësimit të shinës, duhet të jenë:

a) 130 mm për $v \leq 60$ km/orë;

b) 125 mm për 60 km/orë $< v \leq 200$ km/orë;

c) 85 mm për 200 km/orë $< v \leq 230$ km/orë;

ç) 25 mm për $v > 230$ km/orë.

2. Kur $v \leq 40$ km/orë dhe mangësia e pjerrësisë ≤ 75 mm si para ashtu edhe pas një ndryshimi të menjëhershëm të kthesës, vlera e ndryshimit të menjëhershëm të mbilartësimit të shinës mund të rritet në 150 mm.

4.2.4.5 Koniciteti ekuivalent

1. Vlerat kufizuese për konicitetin ekuivalent të cituara në tabelën 7 duhet të llogariten për amplitudën (y) të zhvendosjes anësore të çiftit të rrotave:

— y = 3 mm,	nëse (TG – SR) ≥ 7 mm
— $y = \left(\frac{(TG - SR) - 1}{2}\right)$	nëse 5 mm ≤ (TG – SR) < 7 mm
— y = 2 mm,	nëse (TG – SR) < 5 mm

ku TG është gjerësia e shinave dhe SR është distanca midis faqeve të kontaktit të fllanxhave të çiftit të rrotave.

2. Nuk kërkohet vlerësim i konicitetit ekuivalent për ndërrueset hekurudhore.

3. Gjerësia e shinave të projektuara, profili i kokës së shinës dhe pjerrësia e shinës për linjën e thjeshtë duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që të mos tejkalohen kufijtë e konicitetit ekuivalent të përcaktuar në tabelën 7.

Tabela 7: Vlerat kufitare të projektimit të konicitetit ekuivalent

	Profili i rrotës
Diapazoni i shpejtësisë (km/orë)	**S1002, GV1/40**
v ≤ 60	Vlerësimi nuk kërkohet
60 < v ≤ 200	0,25
200 < v ≤ 280	0,20
v > 280	0,10

4. Setet e mëposhtme të rrotave, siç përcaktohen në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 6, duhet të modelohen duke kaluar mbi kushtet e shinave të projektuar (të simuluara me llogaritje në përputhje me specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 5:

a) S 1002 me SR1;

b) S 1002 me SR2;

c) GV 1/40 me SR1;

d) GV 1/40 me SR2.

Për SR1 dhe SR2 zbatohen vlerat e mëposhtme:

a) Për sistemin me gjerësi binarësh 1435 mm, SR1 = 1420 mm dhe SR2 = 1426 mm.

4.2.4.6 Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë

1. Profili i kokës së shinës duhet të zgjidhet nga diapazoni i përcaktuar në njërën nga specifikimet e përmendura në shtojcën G, indeksi 7 dhe indeksi 8 ose duhet të jetë në përputhje me pikën 2.

2. Projektimi i profileve të kokës së shinave për linjë të thjeshtë duhet të përfshijë:

a) një pjerrësi anësore në anën e kokës së shinës të vendosur në një kënd midis vertikales dhe 1/16, në lidhje me aksin vertikal të kokës së shinës;

b) distanca vertikale midis majës së kësaj pjerrësie anësore dhe majës së shinës duhet të jetë më pak se 20 mm;

c) një rreze prej të paktën 12 mm në cepin e matësit;

ç) distanca horizontale midis majës së shinës dhe pikës tangjente duhet të jetë midis 31 dhe 37,5 mm.

Figura 1: *Profili i kokës së shinës*



3. Këto kërkesa nuk zbatohen për zgjatimin e shinave.

4.2.4.7 Pjerrësia e shinave

4.2.4.7.1 Vijë e thjeshtë

1. Shina duhet të jetë e pjerrët drejt aksit të vijës hekurudhore.

2. Për shinat e destinuara të operohen me shpejtësi më të madhe se 60 km/orë, pjerrësia e shinave për një itinerar të caktuar duhet të zgjidhet nga diapazoni 1/20 deri në 1/40.

3. Për seksionet jo më shumë se 100 m midis ndërruesve hekurudhore pa pjerrësi, ku shpejtësia e lëvizjes nuk është më shumë se 200 km/orë, lejohet shtrimi i shinave pa pjerrësi.

4.2.4.7.2 Kërkesat për ndërrueset hekurudhore

1. Shina duhet të projektohet të jetë vertikale ose e pjerrët.

2. Nëse shina është e pjerrët, pjerrësia e projektuar duhet të zgjidhet nga diapazoni 1/20 deri në 1/40.

3. Pjerrësia mund të jepet nga forma e pjesës aktive të profilit të kokës së shinës.

4. Brenda ndërruesve dhe kalimeve ku shpejtësia e lëvizjes është më shumë se 200 km/orë dhe jo më shumë se 250 km/orë, lejohet shtrimi i shinave pa pjerrësi, me kusht që të kufizohet në seksione që nuk i kalojnë 50 m.

5. Për shpejtësi më të mëdha se 250 km/orë, shinat duhet të jenë të pjerrëta.

4.2.5 Ndërrueset hekurudhore

4.2.5.1 Gjeometria e projektimit të ndërruesve hekurudhore

Pika 4.2.8.6 e kësaj TSI-je përcakton kufijtë e veprimit të menjëhershëm për ndërrueset hekurudhore që janë në përputhje me karakteristikat gjeometrike të seteve të rrotave, siç përcaktohen në TSI-të e mjeteve hekurudhore. Do të jetë detyrë e administratorit të infrastrukturës të vendosë vlerat gjeometrike të projektimit të përshtatshme për planin e tij të mirëmbajtjes.

4.2.5.2 Përdorimi i ndërrueseve hekurudhore me zemër ndërruese të lëvizshme

Për shpejtësi më të larta se 250 km/orë, ndërrueset hekurudhore duhet të pajisen me zemër ndërruese të lëvizshme.

4.2.5.3 Gjatësia maksimale e paudhëzuar e ndërruesve hekurudhor fiks të tipit obtuz

Vlera e projektimit të gjatësisë maksimale të paudhëzuar të ndërruesve hekurudhor fiks të tipit obtuz duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën E të kësaj TSI-je.

4.2.6 Rezistenca e vijave hekurudhore ndaj ngarkesave të aplikuara

4.2.6.1 Rezistenca e vijave hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale

Projektimi i vijave hekurudhore, duke përfshirë ndërrueset hekurudhore, duhet të marrë në konsideratë të paktën forcat e mëposhtme:

a) ngarkesa e aksit e zgjedhur sipas pikës 4.2.1;

b) forcat maksimale vertikale të rrotës. Forcat maksimale të rrotës për kushtet e përcaktuara të testimit janë përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën T, indeksi 9;

c) forcat maksimale statike vertikale të ushtruara nga rrotat për kushtet e përcaktuara të testimit janë

përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën T, indeksi 9.

4.2.6.2 Rezistenca gjatësore e vijave hekurudhore

4.2.6.2.1 Forcat e projektimit

Vijat hekurudhore duke përfshirë ndërrueset, duhet të projektohen për t'i bërë ballë forcave gjatësore ekuivalente me forcën që rrjedh nga frenimi prej 2,5 m/s2 për parametrat e performancës të zgjedhur në përputhje me pikën 4.2.1.

4.2.6.2.2 Pajtueshmëria me sistemet e frenimit

1. Vijat hekurudhore përfshirë ndërrueset, duhet të projektohet që të jenë të pajtueshëm me përdorimin e sistemeve të frenimit magnetik për frenim emergjent.

2. Dispozitat për përdorimin e sistemeve të frenimit me rrymë vorbull (duke përdorur forca elektromagnetike) duhet të përcaktohen në nivel operacional nga administratori i infrastrukturës në bazë të karakteristikave specifike të vijave hekurudhore, duke përfshirë ndërrueset. Kushtet e përdorimit të këtij sistemi frenimi regjistrohen në përputhje me rregulloren e regjistrit të infrastrukturës(RINF).

4.2.6.3 Rezistenca anësore e vijave hekurudhore

Projektimi i vijave hekurudhore, duke përfshirë ndërrueset, duhet të marrë në konsideratë të paktën forcat e mëposhtme:

a) forcat anësore; forcat maksimale anësore (tërthore) të ushtruara nga një çift rrotash në vijat hekurudhore për kushte të përcaktuara testimi janë përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 9;

b) forcat udhëzuese jo plotësisht statike; forcat maksimale udhëzuese jo plotësisht statike Y_{qst} për rreze të përcaktuara dhe kushte testimi janë përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 9.

4.2.7 Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut

Kërkesat e specifikimeve të përmendura në shtojcën G, indeksin 10 dhe indeksin 11 të specifikuara në këtë pikë të TSI-së duhet të zbatohen në përputhje me pikat përkatëse në shtojcat kombëtare të këtyre specifikimeve, nëse ato ekzistojnë.

4.2.7.1 Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut

4.2.7.1.1 Ngarkesa vertikale

1. Urat duhet të projektohen për të mbështetur ngarkesa vertikale në përputhje me modelet e mëposhtme të ngarkesës, të përcaktuara në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10:

a) Modeli i ngarkesës 71, siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10;

b)përveç kësaj, për urat e vazhdueshme, modeli i ngarkesës SW/0, siç përcaktohet në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10.

2. Modelet e ngarkesës duhet të shumëzohen me faktorin alfa (α) siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10.

3. Vlera e faktorit alfa (α) duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se vlerat e përcaktuara në tabelën 8.

Tabela 8: Faktori alfa (α) për projektimin e urave të reja

Lloji i trafikut	Faktori minimal alfa (α)
P1, P2, P3, P4	1,0
P5	0,91
P6	0,83
P1520	1
P1600	1,1
F1, F2, F3	1,0
F4	0,91
F1520	1,46
F1600	1,1

4.2.7.1.2 Marrja në konsideratë e efekteve dinamike të ngarkesave vertikale

1. Efektet e ngarkesës nga modeli i ngarkesës 71 dhe modeli i ngarkesës SW/0 duhet të përforcohen nga faktori dinamik φ(Φ) siç përcaktohet në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10.

2. Për urat për shpejtësi mbi 200 km/orë, ku specifikimi i referuar në shtojcën G, indeksi 10 kërkon kryerjen e një analize dinamike, ura duhet të projektohet, gjithashtu, për HSLM të përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10.

3. Lejohet të projektohen ura të reja në mënyrë të tillë që ato të akomodojnë edhe një tren individual udhëtarësh me ngarkesa boshti më të larta se ato të mbuluara nga HSLM. Analiza dinamike duhet të

kryhet duke përdorur vlerën karakteristike të ngarkesës nga treni individual i marrë si masa e projektimit nën ngarkesë normale të dobishme në përputhje me shtojcën Ë me një tolerancë për udhëtarët në zonat në këmbë në përputhje me shënimin 1, të shtojcës Ë.

4.2.7.1.3 Forcat centrifugale

Kur vija hekurudhore në një urë është e lakuar mbi të gjithë gjatësinë ose një pjesë të saj, forca centrifugale duhet të merret parasysh në projektimin e urave, siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10.

4.2.7.1.4 Forcat e shtytjes anësore të rrotës ndaj shinës

Këto forca duhet të merret parasysh në projektimin e urave siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10.

4.2.7.1.5 Veprimet për shkak të tërheqjes dhe frenimit (ngarkesat gjatësore)

Forcat e tërheqjes dhe të frenimit duhet të merren parasysh në projektimin e urave, siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10.

4.2.7.1.6 Disniveli i shinave në vijën hekurudhore të projektuar për shkak të veprimeve të trafikut hekurudhor

Disniveli maksimal i projektuar ndërmjet shinave të vijës hekurudhore për shkak të veprimeve të trafikut hekurudhor nuk duhet të kalojë vlerat e përcaktuara në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 11.

4.2.7.2 Ngarkesa vertikale që treni i transmeton strukturës së tokës, e konvertuar në një ngarkesë të vetme ekuivalente që përdoret në llogaritje për projektim.

1. Strukturat gjeoteknike dhe punimet e tokës duhet të projektohen dhe efektet e presionit të tokës duhet të specifikohen duke marrë parasysh ngarkesat vertikale të prodhuara nga modeli i ngarkesës 71, siç përcaktohet në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10.

2. Ngarkesa vertikale ekuivalente duhet të shumëzohet me faktorin alfa (α) siç përcaktohet në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10. Vlera e (α)duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se vlerat e përcaktuara në tabelën 8.

4.2.7.3 Rezistenca e strukturave të reja mbi vijat hekurudhore ose ngjitur me to

Veprimet aerodinamike nga trenat që kalojnë duhet të merren në konsideratë siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 10.

4.2.7.4 Rezistenca e strukturave ekzistuese (urave, strukturave gjeoteknike dhe punimeve të dheut) ndaj ngarkesave të trafikut

1. Urat, strukturat gjeoteknike dhe punimet e dheut duhet të sillen në një nivel të specifikuar ndërveprimi në përputhje me kategorinë TSI të linjës së përmendur në pikën 4.2.1.

2. Kërkesat minimale të kapacitetit për strukturat për secilin kod trafiku jepen në shtojcën D dhe duhet të përmbushen që linja të deklarohet e ndërveprueshme.

3. Kushtet e mëposhtme zbatohen:

a) Kur një strukturë ekzistuese zëvendësohet me një strukturë të re, atëherë struktura e re duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pikës 4.2.7.1 ose pikës 4.2.7.2;

b) Nëse aftësia minimale e strukturave ekzistuese përmbush kërkesat në shtojcën D, atëherë strukturat ekzistuese përmbushin kërkesat përkatëse të ndërveprimit;

c) Kur aftësia e një strukture ekzistuese nuk i plotëson kërkesat në shtojcën D dhe po kryhen punime (p.sh. forcim) për të rritur aftësinë e strukturës për të përmbushur kërkesat e kësaj TSI-je (dhe struktura nuk do të zëvendësohet nga një strukturë e re), atëherë struktura duhet të sillet në përputhje me kërkesat në shtojcën D.

4.2.8 Kufizimet e ndërhyrjes së menjëhershme në defektet e gjeometrisë së vijës hekurudhore

4.2.8.1 Kufiri i veprimit të menjëhershëm për drejtimin horizontal të vijës hekurudhore

1. Kufijtë e veprimit të menjëhershëm për defektet e izoluara në drejtimin horizontal të vijës hekurudhore janë përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 12. Defektet e izoluara nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e diapazonit të gjatësisë së valës D1.

2. Kufijtë e veprimit të menjëhershëm për defekte të izoluara në drejtimin horizontal të vijës hekurudhore për shpejtësi më të mëdha se 300 km/orë janë një pikë e hapur.

4.2.8.2 Kufiri i veprimit të menjëhershëm për nivelin gjatësor(vertikal)të vijës hekurudhore

1. Kufijtë e veprimit të menjëhershëm për defektet e izoluara në nivelin gjatësor (vertikal)janë përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G,

indeksi 12. Defektet e izoluara nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e diapazonit të gjatësisë së valës D1.

2. Kufijtë e veprimit të menjëhershëm për defekte të izoluara në nivelin gjatësor(vertikal) për shpejtësi më të madhe se 300 km/orë janë një pikë e hapur.

4.2.8.3 Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për disnivelin e shinave në vijën hekurudhore

1. Limiti i ndërhyrjes së menjëhershme për disnivelin e shinave në vijën hekurudhore si një defekt i izoluar jepet si një vlerë nga zero në maksimum. Disniveli i shinave në vijën hekurudhore është përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 13.

2. Kufiri i disnivelit të shinave në vijën hekurudhore është një funksion i bazës së matjes së aplikuar në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 12.

3. Administratori i infrastrukturës duhet të përcaktojë në planin e mirëmbajtjes gjatësinë bazë mbi të cilën do të matë vijën hekurudhore me qëllim që të kontrollojë përputhshmërinë me këtë kërkesë. Gjatësia bazë e matjes duhet të përfshijë të paktën një bazë midis 2 dhe 5 m.

4.2.8.4 Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme të gjerësisë së vijës hekurudhore kur defekti paraqitet si rast i izoluar

1. Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme të gjerësisë së vijës hekurudhore kur defekti paraqitet si rast i izoluar janë përcaktuar në tabelën 9.

Tabela 9: Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme të gjerësisë së vijës hekurudhore

Shpejtësia (km/orë)	Përmasat (mm)	
	Gjerësia minimale e vijës hekurudhore	Gjerësia maksimale e vijës hekurudhore
v ≤ 120	1 426	1 470
120 < v ≤ 160	1 427	1 470
160 < v ≤ 230	1 428	1 463
v > 230	1 430	1 463

4.2.8.5 Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për diferencën në lartësi midis shinës së jashtme dhe shinës së brendshme në një kthesë

1. Diferenca maksimale e lejuar në lartësi midis shinës së jashtme dhe shinës së brendshme në një kthesë në shërbim është 180 mm.

2. Diferenca maksimale e lejuar në lartësi midis shinës së jashtme dhe shinës së brendshme në një kthesë në shërbim është 190 mm për linjat e dedikuara për transport udhëtarësh.

4.2.8.6 Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme për ndërrueset hekurudhore

Figura 2: Tërheqja e pikës në kalimet e përbashkëta fikse



1 Maja teorike e zemrës (IP)
2 Linja teorike e referencës
3 Maja e zemrës (RP)

1. Karakteristikat teknike të ndërruesve duhet të jenë në përputhje me vlerat e mëposhtme në shërbim:

a)Vlera maksimale e kalimit të lirë të rrotës në zemrën e ndërrueses është 1435 mm;

b)Gjerësia minimale e kanalit të bandazhit është 42 mm;

c)Thellësia minimale e kanalit të bandazhit është 40 mm;

ç) Lartësia maksimale e kundërshinës është 70 mm.

4.2.9 Platformat

1. Kërkesat e kësaj pike zbatohen vetëm për platformat e udhëtarëve ku trenat parashikohet të ndalojnë në shërbim normal.

2. Për kërkesat e kësaj pike, lejohet të projektohen platformat e kërkuara për kërkesën aktuale të shërbimit, me kusht që të merren masa për kërkesat e shërbimit në të ardhmen e parashikueshme në mënyrë të arsyeshme. Kur specifikohen ndërveprimet me trenat që synojnë të ndalen në platformë, duhet të merren në konsideratë si kërkesat aktuale të shërbimit ashtu edhe kërkesat e shërbimit në mënyrë të arsyeshme të parashikueshme të paktën 10 vjet pas vënies në shërbim të platformës.

4.2.9.1 Gjatësia e përdorshme e platformave

Gjatësia e përdorshme e një platforme duhet të përcaktohet sipas pikës 4.2.1.

4.2.9.2 Lartësia e platformës

1. Lartësia nominale e platformës duhet të jetë 550 mm ose 760 mm mbi sipërfaqen e lëvizjes për rreze prej 300 m ose më shumë.

2. Për rreze më të vogla, lartësia nominale e platformës mund të rregullohet në varësi të zhvendosjes së platformës për të minimizuar distancën e ecjes midis trenit dhe platformës.

3. Për platformat ku vetëm trenat e udhëtarëve që janë të listuar në mënyrë të qartë si të përjashtuar nga fushëveprimi i rregullores për TSI të mjeteve hekurudhore të saj synojnë të ndalen në shërbim normal, mund të zbatohen dispozita të ndryshme për lartësinë nominale të platformës.

4.2.9.3 Zhvendosja e platformës

4.2.9.3 Distanca horizontale midis aksit të vijës hekurudhore dhe buzës së platformës së stacionit

1. Distanca midis qendrës së vijës hekurudhore dhe skajit të platformës paralel me planin e lëvizjes (bq), siç përcaktohet në specifikimin e përmendur në shtojcën T, indeksi 3, duhet të vendoset në bazë të dimensionit limit të instalimit (b_{qlim}). Dimensioni limit i instalimit duhet të llogaritet në bazë të dimensionit G1.

2. Platforma duhet të ndërtohet afër dimensionit brenda një tolerance maksimale prej 50 mm. Vlera për bq_{qlim}, pra, t'i përgjigjet:

$b_{qlim} \leq b_q \leq b_{qlim} + 50$ mm.

4.2.9.4 Planifikimi i vijës hekurudhore përgjatë platformave

1. Vijat hekurudhore ngjitur me platformat për linjat e reja duhet të jenë mundësisht të drejtë, por askund nuk duhet të ketë një rreze më të vogël se 300 m.

2. Nuk specifikohen vlera për vija hekurudhore ekzistuese përgjatë platformave të reja, të rinovuara ose të përmirësuara.

4.2.10 Shëndeti, siguria dhe mjedisi

4.2.10.1 Ndryshimet maksimale të presionit në tunele

1. Çdo tunel ose strukturë nëntokësore e re që bie në kategoritë e përshkruara në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 14, duhet të sigurojë që ndryshimi maksimal i presionit, i shkaktuar nga kalimi i një treni që lëviz me shpejtësinë maksimale të lejuar në tunel, të mos kalojë 10 kPa gjatë kohës që i duhet trenit për të kaluar nëpër tunel.

2. Kërkesa e pikës 1 duhet të përmbushet përgjatë pjesës së jashtme të çdo treni që përputhet me TSI LOC&PAS.

3. Në rastin e përmirësimit ose rinovimit të nënsistemit të infrastrukturës, tuneli ekzistues ose struktura nëntokësore e destinuar të operohet me shpejtësi më të mëdha ose të barabarta me 200 km/orë duhet të sigurojë që ndryshimi maksimal i presionit, i shkaktuar nga kalimi i një treni që lëviz me shpejtësinë maksimale të lejuar në tunel, të mos kalojë 10 kPa gjatë kohës që treni kalon nëpër tunel. Vlerësimi duhet të kryhet në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 14 ose në pikën 6.2.4.12, 1) kur nuk është e mundur të zbatohet një vlerësim i thjeshtuar i konformitetit.

4.2.10.2 Efekti i erërave anësore

1. Një linjë është e ndërveprueshme nga pikëpamja e erës anësore nëse sigurohet siguria për një tren referues që lëviz përgjatë asaj linje në kushtet më kritike të operimit.

2. Rregullat për vërtetimin e konformitetit duhet të marrin në konsideratë kurbat karakteristike të erës

së trenave referues, të përcaktuara në TSI-në LOC&PAS.

3. Nëse siguria nuk mund të arrihet pa masa zbutëse, qoftë për shkak të situatës gjeografike ose të karakteristikave të tjera specifike të linjës, administratori i infrastrukturës duhet të marrë masat e nevojshme për të ruajtur sigurinë, për shembull duke:

- ulur në nivel lokal shpejtësinë e trenave, ndoshta përkohësisht gjatë periudhave me rrezik nga stuhitë;
- instaluar pajisje për të mbrojtur seksionin përkatës të binarit nga erërat anësore;
- mjete të tjera të përshtatshme.

4. Duhet të demonstrohet se siguria është arritur pas masave të marra.

4.2.10.3 Efekti aerodinamik në vija hekurudhore me balast

1. Ndërveprimi aerodinamik midis mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës mund të shkaktojë ngritjen dhe largimin e mëtejshëm të gurëve të balastit nga shtrati i vijës hekurudhore në vijë të thjeshtë dhe ndërruesit e kryqëzimet (mbledhja e balastit). Ky rrezik duhet të zbutet.

2. Kërkesat për nënsistemin e infrastrukturës që synojnë zbutjen e rrezikut për 'ngritjen e balastit' zbatohen vetëm për linjat e destinuara të operohen me shpejtësi më të madhe se 250 km/orë.

3. Kërkesat e pikës 2 më sipër janë një pikë e hapur.

4.2.11 Dispozita për funksionimin

4.2.11.1 Shenjat (treguesit) e vendndodhjes

Shenjat (treguesit) e vendndodhjes duhet të vendosen në intervale nominale përgjatë vijës hekurudhore prej jo më shumë se 1000 m.

4.2.11.2 Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal

1. Nëse raportohet paqëndrueshmëri e udhëtimit me tren, sipërmarrja hekurudhore dhe administratori i infrastrukturës duhet të lokalizojnë pjesën e linjës në një investigim të përbashkët sipas paragrafëve 2 dhe 3, më poshtë.

Shënim. Ky investigim i përbashkët specifikohet, gjithashtu, në pikën 4.2.3.4.3.2 të TSI LOC & PAS për veprim mbi mjetet hekurudhore.

2. Administratori i infrastrukturës duhet të masë gjerësinë e vijës hekurudhore dhe profilet e kokës së vijës hekurudhore në vendin në fjalë në një distancë prej afërsisht 10 m. Koniciteti mesatar efektiv i rrotës gjatë operimit normal mbi 100 m duhet të llogaritet duke modeluar me setet e rrotave a–ç, të përmendura në paragrafin 4.2.4.5, pika 4 të kësaj TSI-je, me qëllim që të kontrollojë përputhshmërinë, për qëllimin e investigimit të përbashkët, me konicitetin efektiv të rrotës gjatë operimit normal limit për vijën hekurudhore të specifikuar në tabelën 10.

Tabela 10: Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal në vlerat kufitare të shërbimit për shinën (për qëllime hetimi të përbashkët)

Diapazoni i shpejtësisë (km/orë)	Vlera maksimale e konicitetit mesatar efektiv të rrotës gjatë operimit normal mbi 100 m
$v \leq 60$	vlerësimi nuk kërkohet
$60 < v \leq 120$	0,40
$120 < v \leq 160$	0,35
$160 < v \leq 230$	0,30
$v > 230$	0,25

3. Nëse koniciteti mesatar efektiv i rrotës gjatë operimit normal mbi 100 m përputhet me vlerat kufitare në tabelën 10, duhet të ndërmerret një investigim i përbashkët nga sipërmarrja hekurudhore dhe administratori i infrastrukturës për të specifikuar arsyen e paqëndrueshmërisë.

4.2.12 Instalime fikse për shërbimin e trenave

4.2.12.1 Të përgjithshme

Kjo pikë 4.2.12 përcakton elementet e infrastrukturës së nënsistemit të mirëmbajtjes të nevojshëm për mirëmbajtjen e trenave.

4.2.12.2 Shkarkimi i tualetit

Instalimet fikse për shkarkimin e tualeteve duhet të jenë në përputhje me karakteristikat e sistemit të tualeteve mbajtëse të specifikuara në TSI-në LOC & PAS.

4.2.12.3 Pajisjet e pastrimit të jashtëm të trenit

1. Kur ofrohet një impiant larjeje, ai duhet të jetë në gjendje të pastrojë anët e jashtme të trenave me një ose dy kate midis një lartësie prej:

a) 500 deri në 3500 mm për një tren me një kat të vetëm;

b) 500 deri në 4300 mm për trenat me dy kate.

2. Impianti i larjes duhet të projektohet në mënyrë të tillë që trenat të mund të kalojnë nëpër të me çdo shpejtësi midis 2 km/orë dhe 5 km/orë.

4.2.12.4 Rimbushja e rezervave të ujit

1. Pajisjet fikse për rimbushjen e furnizimit me ujë duhet të jenë në përputhje me karakteristikat e sistemit të ujit të specifikuara në TSI-në LOC & PAS.

2. Pajisjet fikse për furnizimin me ujë të destinuar për konsum njerëzor duhet të furnizohen me ujë të pijshëm që përmbush kërkesat e e ujit të destinuar për përdorim njerëzor.

3. Materialet e përdorura për furnizimin e mjeteve hekurudhore me ujë të destinuar për konsum njerëzor (p.sh.: rezervuari, pompa, tubacionet, rubineti i ujit dhe materiali dhe cilësia e vulosjes) duhet të jenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme për ujin e destinuar për konsum njerëzor.

4.2.12.5 Furnizimi me karburant

Pajisjet e furnizimit me karburant duhet të jenë në përputhje me karakteristikat e sistemit të karburantit të specifikuara në TSI-në LOC & PAS.

4.2.12.6 Furnizim elektrik nga burim i jashtëm

Kur ofrohet, furnizimi elektrik nga burim i jashtëm duhet të bëhet me anë të një ose më shumë sistemeve të furnizimit me energji të specifikuara në TSI-në LOC & PAS.

4.3 Specifikimi funksional dhe teknik i ndërfaqeve

Nga pikëpamja e përputhshmërisë teknike, ndërveprimet e nënsistemit të infrastrukturës me nënsistemet e tjera janë siç përshkruhen në pikat e mëposhtme.

4.3.1 Ndërveprimi me nënsistemin e mjeteve hekurudhore

Tabela 11: Ndërveprimet me nënsistemin 'Mjete hekurudhore – lokomotiva dhe mjete hekurudhore për udhëtarë'

Ndërveprimi	Referenca në TSI INF	Referenca në TSI LOC&PAS
Gjerësia e vijës hekurudhore	4.2.4.1 Gjerësia nominale e vijës hekurudhore 4.2.5.1 Gjeometria e projektimit të ndërruesve hekurudhorë 4.2.8.6 Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme për ndërruesit hekurudhorë	4.2.3.5.2.1 Karakteristikat mekanike dhe gjeometrike të çiftit të rrotave 4.2.3.5.2.3 Çift rrotash me gjerësi të ndryshueshme
Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1 Dimensioni i profilit të lirë 4.2.3.2 Distanca midis akseve të vijave hekurudhore 4.2.3.5 Rrezja minimale e kthesës vertikale 4.2.9.3 Zhvendosja e platformës	4.2.3.1 Matja
Ngarkesa aksiale dhe hapësira midis akseve	4.2.6.1 Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale 4.2.6.3 Rezistenca anësore e vijës hekurudhore 4.2.7.1 Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut 4.2.7.2 Ngarkesë vertikale ekuivalente për punimet e reja të dheut dhe efektet e presionit të tokës të imponuara në strukturat e reja 4.2.7.4 Rezistenca e urave dhe punimeve ekzistuese të dheut ndaj ngarkesave të trafikut	4.2.2.10 Kushtet e ngarkesës dhe masa e peshuar 4.2.3.2.1 Parametri i ngarkesës së aksit
Karakteristikat e ecjes	4.2.6.1 Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale 4.2.6.3 Rezistenca anësore e vijës hekurudhore 4.2.7.1.4 Forcat dinamike	4.2.3.4.2.1 Vlerat kufitare për drejtimin e sigurt 4.2.3.4.2.2 Vlerat kufitare të ngarkesës në vijat hekurudhore
Stabiliteti i udhëtimit	4.2.4.4 Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal 4.2.4.6 Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë	4.2.3.4.3 Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal

	4.2.11.2 Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal në shërbim	4.2.3.5.2.2 Karakteristikat mekanike dhe gjeometrike të rrotave
Veprime gjatësore	4.2.6.2 Rezistenca gjatësore e binarit 4.2.7.1.5 Veprimet për shkak të tërheqjes dhe frenimit (ngarkesat gjatësore)	4.2.4.5 Performanca e frenimit
Rrezja minimale e kthesës horizontal	4.2.3.4 Rrezja minimale e kthesës horizontale	4.2.3.6 Rrezja minimale e kthesës Shtojca A, A.1 Tamponët
Sjellja dinamike e ecjes	4.2.4.3 Disniveli maksimal	4.2.3.4.2 Sjellja dinamike e ecjes
Ngadalësimi maksimal	4.2.6.2 Rezistenca gjatësore e vijës hekurudhore 4.2.7.1.5 Veprimet për shkak të tërheqjes dhe frenimit	4.2.4.5 Performanca e frenimit
Efekti aerodinamik	4.2.3.2 Distanca midis akseve të vijave hekurudhore 4.2.7.3 Rezistenca e strukturave të reja mbi vijat hekurudhore ose ngjitur me to 4.2.10.1 Ndryshimet maksimale të presionit në tunele 4.2.10.3 Efekti aerodinamik në vijat hekurudhore me balast	4.2.6.2.1 Efektet e rrjedhës së poshtme te udhëtarët në platforma dhe te punëtorët përgjatë vijës hekurudhore 4.2.6.2.2 Pajtueshmëria me sistemet e frenimit 4.2.6.2.3 Ndryshimet maksimale të presionit në tunele 4.2.6.2.5 Efekti aerodinamik në vijat hekurudhore me balast
Erë anësore	4.2.10.2 Efekti i erërave anësore	4.2.6.2.4 Erë anësore
Instalime për mirëmbajtjen e trenave	4.2.12.2 Shkarkimi i tualetit 4.2.12.3 Pajisjet e pastrimit të jashtëm të trenit 4.2.12.4 Rimbushja e rezervave të ujit 4.2.12.5 Furnizimi me karburant 4.2.12.6 Furnizim elektrik nga burim i jashtëm	4.2.11.3 Sistemi i shkarkimit të tualetit 4.2.11.2.2 Pastrimi i jashtëm nëpërmjet një impianti larjeje 4.2.11.5 Ndërfaqja për mbushjen me ujë 4.2.11.7 Pajisjet e furnizimit me karburant 4.2.11.6 Kërkesa të veçanta për stacionimin e trenave

Tabela 12: Ndërveprimet me nënsistemin 'Mjete hekurudhore – vagonë mallrash'

Ndërveprimi	**Referenca në TSI INF**	**Referenca në TSI WAG**
Gjerësia e vijës hekurudhore	4.2.4.1 Gjerësia nominale e vijës hekurudhore 4.2.4.6 Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë 4.2.5.1 Gjeometria e projektimit të ndërruesve 4.2.8.6 Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme për ndërruesit	4.2.3.6.2 Karakteristikat e seteve të rrotave 4.2.3.6.3 Karakteristikat e rrotave
Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1 Dimensioni i profilit të lirë 4.2.3.2 Distanca midis akseve të vijave hekurudhore 4.2.3.5 Rrezja minimale e disnivelit vertikale 4.2.9.3 Zhvendosja e platformës	4.2.3.1 Matja
Ngarkesa e aksit dhe hapësira midis akseve	4.2.6.1 Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale 4.2.6.3 Rezistenca anësore e vijave hekurudhore 4.2.7.1 Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut 4.2.7.2 Ngarkesë vertikale ekuivalente për punimet e reja të dheut dhe efektet e presionit të tokës të imponuara në strukturat e reja 4.2.7.4 Rezistenca e urave dhe punimeve ekzistuese të dheut ndaj ngarkesave të trafikut	4.2.3.2Pajtueshmëria me kapacitetin mbajtës të ngarkesës së linjave
Sjellja dinamike e ecjes	4.2.8 Kufizime të ndërhyrjes së menjëhershme mbi defektet e gjeometrisë së vijës hekurudhore	4.2.3.5.2 Sjellja dinamike e ecjes
Veprime gjatësore	4.2.6.2 Rezistenca gjatësore e vijës hekurudhore 4.2.7.1.5 Veprimet për shkak të tërheqjes dhe frenimit (ngarkesat gjatësore)	4.2.4.3.2 Performanca e frenave
Rrezja minimale e kthesës	4.2.3.4 Rrezja minimale e kthesës horizontale	4.2.2.1 Ndërveprimi mekanik
Kthesë vertikale	4.2.3.5 Rrezja minimale e kthesës vertikale	4.2.3.1 Matja

4.3.2 Ndërveprimet me nënsistemin e energjisë

Tabela 13: Ndërveprimet me nënsistemin e energjisë

Ndërfaqja	Referenca në TSI INF	Referenca në TSI ENE
Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1 Dimensioni i profilit të lirë	*4.2.10* Gama e pantografëve

4.3.3 Ndërveprimet me nënsistemin e komandës, kontrollit dhe sinjalizimit

Tabela 14: Ndërveprimet me nënsistemin e komandës, kontrollit dhe sinjalizimit

Ndërfaqja	Referenca në TSI INF	Referenca në TSI CCS
Set matësish strukture për instalimet CCS. Dukshmëria e objekteve CCS anash vijës hekurudhore.	4.2.3.1 Dimensioni i strukturës	4.2.5.2.Komunikimi Eurobalise (hapësirë për instalim) 4.2.5.3.Komunikimi Euroloop (hapësirë për instalim) 4.2.10.Sistemet e zbulimit të trenave (hapësirë për instalim) 4.2.15.Dukshmëria e objekteve të komandës, kontrollit dhe sinjalizimit në vijën hekurudhore

4.3.4 Ndërveprimet me nënsistemin e operimit dhe menaxhimit të trafikut

Tabela 15: Ndërveprimet me nënsistemin e operimit dhe menaxhimit të trafikut

Ndërfaqja	Referenca në TSI INF	Referenca në TSI OPE
Stabiliteti i udhëtimit	4.2.11.2 Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal në shërbim	4.2.3.4.4 Cilësia operacionale
Përdorimi i frenave me rrymë vorbull	4.2.6.2 Rezistenca gjatësore e vijës hekurudhore	4.2.2.6.2 Performanca e frenimit
Erërat anësore	4.2.10.2 Efekti i erërave anësore	4.2.3.6.3 Marrëveshjet e emergjencës
Rregullat e funksionimit	4.4 Rregullat e funksionimit	4.2.1.2.2.2 Modifikime në informacionin e përfshirë në librin e itinerarit 4.2.3.6 Operim i degraduar
Kompetencat e stafit	4.6 Kompetencat profesionale	4.2.1.1 Kërkesa të përgjithshme

4.4 Rregullat e funksionimit

1. Rregullat operative zhvillohen brenda procedurave të përshkruara në sistemin e menaxhimit të sigurisë të administratorit të infrastrukturës. Këto rregulla marrin në konsideratë dokumentacionin që lidhet me operimin, i cili përbën një pjesë të dosjes teknike.

2. Në situata të caktuara që përfshijnë punime të planifikuara, mund të jetë e nevojshme të pezullohen përkohësisht specifikimet e nënsistemit të infrastrukturës dhe përbërësve të tij të ndërveprimit të përcaktuar në seksionet 4 dhe 5 të kësaj TSI-je.

4.5 Rregullat e mirëmbajtjes

1. Rregullat e mirëmbajtjes zhvillohen brenda procedurave të përshkruara në sistemin e menaxhimit të sigurisë të administratorit të infrastrukturës.

2. Dosja e mirëmbajtjes duhet të përgatitet para se të vihet në shërbim një linjë si pjesë e dosjes teknike që shoqëron deklaratën e verifikimit.

3. Plani i mirëmbajtjes duhet të hartohet për nënsistemin për të siguruar që kërkesat e përcaktuara në këtë TSI të mirëmbahen gjatë jetëgjatësisë së tij.

4.5.1 Dosja e mirëmbajtjes

Një dosje mirëmbajtjeje duhet të përmbajë të paktën:

a) një grup vlerash për kufijtë e veprimit të menjëhershëm,

b) masat e marra (për shembull kufizimi i shpejtësisë, koha e riparimit) kur nuk përmbushen kufijtë e përcaktuar, lidhur me cilësinë gjeometrike të vijës hekurudhore dhe kufizimet mbi defektet e izoluara.

4.5.2 Plani i mirëmbajtjes

Administratori i infrastrukturës duhet të ketë një plan mirëmbajtjeje që përmban pikat e listuar në pikën 4.5.1 së bashku me të paktën sa vijon:

a) një grup vlerash për kufijtë e ndërhyrjes dhe kufijtë e alarmit;

b) një deklaratë në lidhje me metodat, kompetencat profesionale të stafit dhe pajisjet mbrojtëse personale të sigurisë të nevojshme që do të përdoren;

c) rregullat që duhen zbatuar për mbrojtjen e njerëzve që punojnë në ose pranë vijës hekurudhore;

ç) mjetet e përdorura për të kontrolluar nëse respektohen vlerat në shërbim;

d) masat e marra, për shpejtësi më të madhe se 250 km/orë, për të zbutur rrezikun e ngritjes së balastit.

4.6 Kualifikimet profesionale

Kualifikimet profesionale të stafit të kërkuara për operimin dhe mirëmbajtjen e nënsistemit të infrastrukturës nuk janë përcaktuar në këtë TSI, por përshkruhen në sistemin e menaxhimit të sigurisë të administratorit të infrastrukturës.

4.7 Kushtet e shëndetit dhe sigurisë

1. Kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit të kërkuara për funksionimin dhe mirëmbajtjen e nënsistemit të infrastrukturës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.

2. Çështja mbulohet nga procedurat e përshkruara në sistemin e menaxhimit të sigurisë të administratorit të infrastrukturës.

5.Përbërësit e ndërveprueshmërisë

5.1 Baza mbi të cilën janë përzgjedhur përbërësit e ndërveprimit

1. Kërkesat e pikës 5.3 bazohen në një projektim tradicional të vijës hekurudhore me balast me shinë Vignole (me fund të sheshtë) mbi traversa betoni ose druri dhe fiksim që siguron rezistencë ndaj rrëshqitjes gjatësore duke u mbështetur në fundin e shinës.

2. Komponentët dhe montimet e përdorura për ndërtimin e projektimeve të tjera të vijës hekurudhore nuk konsiderohen përbërës të ndërveprimit.

5.2 Lista e përbërësve

1. Për qëllimet e këtij specifikimi teknik për ndërveprimin, vetëm elementet e mëposhtme, qofshin komponentë individualë apo nën-montime të vijës hekurudhore, deklarohen si 'përbërës të ndërveprimit':

a) shina (5.3.1);

b) sistemet e fiksimit të shinave (5.3.2);

c) traversat në vijën hekurudhore (5.3.3).

2. Pikat e mëposhtme përshkruajnë specifikimet e zbatueshme për secilin prej këtyre përbërësve.

3. Shinat, elementet e fiksimit dhe traversat e përdorura për gjatësi të shkurtra shinash për qëllime specifike, për shembull në ndërrime, në pajisje zgjerimi, pllaka kalimi dhe struktura të veçanta, nuk konsiderohen përbërës të ndërveprimit.

5.3 Performancat dhe specifikimet e përbërësve

5.3.1 Shina

Specifikimet e përbërësit të ndërveprimit hekurudhor kanë të bëjnë me parametrat e mëposhtëm:

a) profili i kokës së shinës,

b) çeliku i shinave.

5.3.1.2 Çelik shinash

1. Çeliku i shinave është i rëndësishëm për kërkesat e pikës 4.2.6 'Rezistenca e shinave ndaj ngarkesave të aplikuara'.

2. Çeliku i shinave duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Fortësia e shinës duhet të jetë të paktën 200 HBW;

b) Rezistenca në tërheqje duhet të jetë të paktën 680 MPa;

c) Numri minimal i cikleve në provën e lodhjes pa defekt duhet të jetë të paktën 5×10^6.

5.3.2 Sistemet e fiksimit të shinave

1. Sistemi i fiksimit të shinave është i rëndësishëm për kërkesat e pikës 4.2.6.1 për 'Rezistencën e shinave ndaj ngarkesave vertikale', pikës 4.2.6.2 për 'Rezistencën gjatësore të shinave' dhe pikës 4.2.6.3 për 'Rezistencën anësore të shinave'.

2. Sistemi i fiksimit të shinave duhet të përputhet në kushtet e testimit laboratorik me kërkesat e mëposhtme:

a) Forca gjatësore e nevojshme për të shkaktuar që shina të fillojë të rrëshqasë (domethënë të lëvizë në mënyrë joelastike) përmes një montimi të vetëm të lidhjes së shinave duhet të jetë të paktën 7 kN dhe për shpejtësi më të mëdha se 250 km/orë duhet të jetë të paktën 9 kN;

b) Mbërthimi i shinave duhet t'i rezistojë aplikimit të 3 000 000 cikleve të ngarkesës tipike të aplikuar në një kthesë të fortë, në mënyrë që ndryshimi në performancën e sistemit të mbërthimit të mos kalojë:

- 20% për sa i përket forcës së shtrëngimit;
- 25% në aspektin e ngurtësisë vertikale;

- një reduktim prej më shumë se 20% për sa i përket kufizimit gjatësor.

Ngarkesa tipike duhet të jetë e përshtatshme për:

- ngarkesën maksimale të aksit që është projektuar të përballojë sistemi i lidhjes së shinave,

- kombinimi i shinës, pjerrësisë së shinës, sipërfaqes së shinës dhe llojit të traversave me të cilat mund të përdoret sistemi i fiksimit.

5.3.3 Traversat në vija hekurudhore

1. Traversat e vijës hekurudhore duhet të projektohen në mënyrë të tillë që, kur përdoren me një shinë dhe sistem të caktuar fiksimi të shinave, ato të kenë veti që janë në përputhje me kërkesat e pikës 4.2.4.1 për 'Gjerësinë nominale të vijës hekurudhore', pikës 4.2.4.7 për 'Pjerrësinë e shinave' dhe pikës 4.2.6 për 'Rezistencën e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave të aplikuara'.

2. Për sistemin me gjerësi nominale binarësh prej 1435 mm, gjerësia e projektuar e vijës hekurudhore për traversat në vija të drejta dhe në kthesa horizontale me rreze më të madhe se 300 m duhet të jetë1437 mm.

6. Vlerësimi i konformitetit të përbërësve të ndërveprimit dhe verifikimi EC i nënsistemeve

Modulet për procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorim dhe verifikimin CE përcaktohen në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

6.1 Përbërësit e ndërveprimit

6.1.1 Procedurat e vlerësimit të konformitetit

1. Procedura e vlerësimit të konformitetit të përbërësve të ndërveprimit, siç përcaktohet në seksionin 5 të kësaj TSI-je, kryhet duke zbatuar modulet përkatëse.

2. Përbërësit e ndërveprimit të dobishëm që janë të përshtatshëm për ripërdorim nuk i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të konformitetit.

6.1.2 Zbatimi i moduleve

1. Për vlerësimin e konformitetit të përbërësve të ndërveprimit përdoren modulet e mëposhtme:

a) CA 'Kontrolli i brendshëm i prodhimit';

b) 'Shqyrtimi i tipit EC' i CB-së;

c) CC 'Përputhshmëria me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit';

ç) CD 'Konformiteti me tipin bazuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë së procesit të prodhimit';

e) CF 'Përputhshmëria me tipin bazuar në verifikimin e produktit';

f) CH 'Konformiteti i bazuar në sistemin e plotë të menaxhimit të cilësisë'.

2. Modulet për vlerësimin e konformitetit të përbërësve të ndërveprimit duhet të zgjidhen nga ato të paraqitura në tabelën 16.

Tabela 16: Modulet për vlerësimin e konformitetit që do të zbatohen për përbërësit e ndërveprimit

Procedurat	Hekurudhë	Sistemi i fiksimit të shinave	Tramvaje në shina
Vendosur në tregun e BE-së para hyrjes në fuqi të TSI-ve përkatëse	CA ose CH	CA ose CH	
Vendosur në tregun e BE-së pas hyrjes në fuqi të TSI-ve përkatëse	CB + CC ose CB + CD ose CB + CF ose CH		

3. Në rastin e produkteve të vendosura në treg para publikimit të TSI-ve përkatëse, tipi konsiderohet i miratuar dhe për këtë arsye shqyrtimi i tipit EC (moduli CB) nuk është i nevojshëm, me kusht që prodhuesi të tregojë se testet dhe verifikimi i përbërësve të ndërveprimit janë konsideruar të suksesshme për aplikimet e mëparshme në kushte të krahasueshme dhe janë në përputhje me kërkesat e kësaj TSI-je. Në këtë rast, këto vlerësime do të mbeten të vlefshme në aplikimin e ri. Nëse nuk është e mundur të tregohet se zgjidhja është provuar pozitivisht në të kaluarën, zbatohet procedura për përbërësit e ndërveprimit të vendosur në tregun e BE-së pas publikimit të kësaj TSI-je.

4. Vlerësimi i konformitetit të përbërësve të ndërveprimit duhet të mbulojë fazat dhe karakteristikat siç tregohet në tabelën 17, të shtojcës A të kësaj TSI-je.

6.1.3 Zgjidhje novatore për përbërësit e ndërveprimit

Nëse propozohet një zgjidhje novatore për një përbërës të ndërveprimit, zbatohet procedura e përshkruar në nenin 10.

6.1.4 Deklarata KE e konformitetit për përbërësit e ndërveprimit

6.1.4.1 Përbërësit e ndërveprimit që i nënshtrohen akteve të tjera ligjore

1. Në përputhje me nenin 133, të Kodit, për përbërësit e ndërveprimit që janë objekt i akteve të tjera ligjore që mbulojnë çështje të tjera, deklarata CE e konformitetit ose e përshtatshmërisë për përdorim duhet të deklarojë se përbërësit e ndërveprimit plotësojnë gjithashtu kërkesat e atyre akteve të tjera ligjore;

2. Deklarata CE e konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorim duhet të përfshijë një listë të kufizimeve ose kushteve të përdorimit.

6.1.4.2.Deklarata CE e konformitetit për shinat

Nuk kërkohet asnjë deklaratë që përcakton kushtet e përdorimit.

6.1.4.3.Deklarata CE e konformitetit për sistemet e lidhjes së shinave

Deklarata CE e konformitetit duhet të shoqërohet nga një deklaratë që përcakton:

a) kombinimi i shinës, pjerrësisë së shinës, sipërfaqes së shinës dhe llojit të traversave me të cilat mund të përdoret sistemi i fiksimit;

b) ngarkesën maksimale të aksit që është projektuar të përballojë sistemi i fiksimit të shinave.

6.1.4.4 Deklarata CE e konformitetit për traversat në vijat hekurudhore

Deklarata CE e konformitetit duhet të shoqërohet nga një deklaratë që përcakton:

a) kombinimi i shinës, pjerrësia e shinës dhe lloji i sistemit të fiksimit të shinës me të cilin mund të përdoret traversa;

b) gjerësia nominale dhe e projektuar e vijës hekurudhore;

c) kombinimet e ngarkesës aksiale dhe shpejtësisë së trenit për të cilat është projektuar të përballojë traversat në vijë hekurudhore.

6.1.5 Procedura të veçanta vlerësimi për përbërësit e ndërveprimit

6.1.5.1 Vlerësimi i shinave

Vlerësimi i çelikut të shinave duhet të bëhet sipas kërkesave të mëposhtme:

a) Fortësia e shinave duhet të testohet për pozicionin RS në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 7.

b) Rezistenca në tërheqje duhet të testohet në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 7.

c) Testi i lodhjes duhet të bëhet në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 7.

6.1.5.2 Vlerësimi i shinave

Për traversat me gjerësi polivalente dhe me gjerësi të shumëfishtë, lejohet që gjatë vlerësimit të vijës hekurudhore të mos merret parasysh dimensioni i projektuar i vijave hekurudhore për dimensionin nominal 1435 mm.

6.2 Nënsistemi i infrastrukturës

6.2.1 Dispozita të përgjithshme

1. Me kërkesë të aplikantit, organi i njoftuar kryen verifikimin CE të nënsistemit të infrastrukturës në përputhje me Kodin dhe në përputhje me dispozitat e moduleve përkatëse.

2. Nëse kërkuesi demonstron se testet ose vlerësimet e një nënsistemi infrastrukture ose pjesëve të nënsistemit janë të njëjta me ato që kanë qenë të suksesshme për aplikimet e mëparshme të një projektimi, organi i njoftuar duhet të marrë në konsideratë rezultatet e këtyre testeve dhe vlerësimeve për verifikimin CE.

3. Verifikimi CE i nënsistemit të infrastrukturës duhet të mbulojë fazat dhe karakteristikat e treguara në tabelën 18, në shtojcën B të kësaj TSI-je.

4. Parametrat e performancës të përcaktuar në pikën 4.2.1 të kësaj TSI-je nuk i nënshtrohen verifikimit CE të nënsistemit.

5. Procedurat e veçanta të vlerësimit për parametrat bazë specifikë të nënsistemit të infrastrukturës përcaktohen në pikën 6.2.4.

6. Kërkuesi duhet të hartojë deklaratën CE të verifikimit për nënsistemin e infrastrukturës në përputhje me Kodin.

6.2.2 Zbatimi i moduleve

Për procedurën e verifikimit CE të nënsistemit të infrastrukturës, kërkuesi mund të zgjedhë njërën nga këto:

a) Moduli SG: Verifikimi CE bazuar në verifikimin e njësisë; ose

b) Moduli SH1: Verifikimi CE bazuar në sistemin e plotë të menaxhimit të cilësisë plus ekzaminimin e projektimit.

6.2.2.1 Zbatimi i modulit SG

Në rastin kur verifikimi CE kryhet në mënyrën më efektive duke përdorur informacionin e mbledhur nga administratori i infrastrukturës, enti kontraktues ose kontraktorët kryesorë të përfshirë (për shembull, të dhënat e marra duke përdorur mjetin e regjistrimit të vijës hekurudhore ose pajisje të tjera matëse), organi i njoftuar duhet ta marrë parasysh këtë informacion për të vlerësuar konformitetin.

6.2.2.2 Zbatimi i modulit SH1

Moduli SH1 mund të zgjidhet vetëm kur aktivitetet që kontribuojnë në nënsistemin e propozuar që do të verifikohet (projektimi, prodhimi, montimi, instalimi) i nënshtrohen një sistemi të menaxhimit të cilësisë për projektimin, prodhimin, inspektimin dhe testimin përfundimtar të produktit, të miratuar dhe të mbikëqyrur nga një organ i notifikuar.

6.2.3 Zgjidhje novatore

Nëse propozohet një zgjidhje novatore për nënsistemin e infrastrukturës, zbatohet procedura e përshkruar në nenin 10.

6.2.4 Procedura të veçanta vlerësimi për nënsistemin e infrastrukturës

6.2.4.1 Vlerësimi i dimensionit të profilit të lirë

1. Vlerësimi i dimensionit të profilit të lirë si një rishikim i projektimit duhet të bëhet kundrejt prerjeve tërthore karakteristike duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të bëra nga administratori i infrastrukturës ose enti kontraktues në bazë të specifikimit të referuar në Shtojcën G, Indeksi (3).

2. Seksionet tërthore karakteristike janë:

a) vija hekurudhore pa mbilartësim;

b) vija hekurudhore me mbilartësim maksimal;

c) vija hekurudhore me një strukturë inxhinierike civile që kalojnë mbi këtë vijë. (tunele, nënkalime hekurudhore, ura etj.);

ç)çdo vendndodhje tjetër ku dimensioni limit i instalimit të projektuar afrohet më pak se 100 mm ose dimensioni nominal i instalimit ose dimensioni uniform afrohet më pak se 50 mm.

3. Pas montimit dhe para vënies në shërbim, hapësirat e lira duhet të verifikohen në vendet ku dimensioni nominal i instalimit të projektuar afrohet më pak se 100 mm ose matësi nominal i instalimit ose matësi uniform afrohet më pak se 50 mm.

6.2.4.2 Vlerësimi i distancës midis akseve të vijave hekurudhore

1. Një rishikim i projektimit për vlerësimin e distancës midis akseve të vijave hekurudhore duhet të bëhet duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të bëra nga administratori i infrastrukturës ose subjekti kontraktues në bazë të specifikimit të referuar në Shtojcën G, Indeksi (3). Distanca nominale midis akseve të vijave hekurudhore duhet të kontrollohet në planin e linjës ku distancat jepen paralelisht me planin horizontal. Distanca kufitare e instalimit midis akseve të vijave hekurudhore duhet të kontrollohet me rrezen dhe pjerrësinë përkatëse.

2. Pas montimit para vënies në shërbim, distanca midis akseve të vijave hekurudhore duhet të verifikohet në vendet kritike ku distanca kufitare e instalimit midis akseve të vijave hekurudhore, siç përcaktohet në përputhje me specifikimin e referuar në Shtojcën G, Indeksi (3), afrohet me më pak se 50 mm.

6.2.4.3 Vlerësimi i gjerësisë nominale midis faqeve të brendshme të shinave të vijës hekurudhore

1. Vlerësimi i gjerësisë nominale midis faqeve të brendshme të shinave të vijës hekurudhore gjatë shqyrtimit të projektit duhet të bëhet duke kontrolluar vetëdeklarimin e kërkuesit.

2. Vlerësimi i gjerësisë nominale midis faqeve të brendshme të shinave të vijës hekurudhore gjatë montimit para vënies në shërbim duhet të bëhet duke kontrolluar certifikatën e traversës së përbërësit të ndërveprimit. Për përbërësit e ndërveprimit të pacertifikuar, vlerësimi i gjerësisë nominale të vijës hekurudhore duhet të bëhet duke kontrolluar vetëdeklarimin e kërkuesit.

6.2.4.4 Vlerësimi i planimetrisë së vijës hekurudhore

1. Gjatë rishikimit të projektimit, rrezja e kthesave, mbilartësimi dhe ndryshimi i menjëhershëm i mbilartësimit duhet të vlerësohen kundrejt shpejtësisë lokale të projektimit.

2. Vlerësimi i planit të ndërruesve nuk është i nevojshëm.

3. Gjatë montimit para vënies në shërbim, për shqyrtimin e kthesës minimale horizontale, duhet të vlerësohen vlerat e matjes të dhëna nga kërkuesi ose administratori i infrastrukturës. Duhet të merren në konsideratë rregullat për pranimin e punimeve të përcaktuara nga administratori i infrastrukturës.

6.2.4.5 Vlerësimi i mbilartësimit të pamjaftueshëm për shpejtësinë me të cilën udhëton treni në një kthesë.

Pika 4.2.4.3, 2, thotë se "Është e lejueshme që trenat e projektuar posaçërisht për të udhëtuar me mbilartësim të pamjaftueshëm (për shembull njësi të shumëfishta me ngarkesa më të ulëta aksiale; mjete me pajisje speciale për përshkimin e kthesave) të ecin me vlera më të larta të mbilartësimit, me kusht që të demonstrohet se kjo mund të arrihet në mënyrë të sigurt". Ky demonstrim është jashtë fushëveprimit të kësaj TSI-je dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohet

një verifikimi nga organi i njoftuar i nënsistemit të infrastrukturës. Demonstrimi duhet të ndërmerret nga sipërmarrja hekurudhore, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me administratorin e infrastrukturës.

6.2.4.6 Vlerësimi i vlerave të projektimit për konicitet efektiv i rrotës gjatë operimit normal

Vlerësimi i vlerave të projektimit për konicitet efektiv të rrotës gjatë operimit normal duhet të bëhet duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të bëra nga administratori i infrastrukturës ose enti kontraktues në bazë të specifikimit të referuar në shtojcën G, indeksi 5.

6.2.4.7 Vlerësimi i profilit të kokës së shinës

1. Profili i projektimit të shinave të reja duhet të kontrollohet në përputhje me pikën 4.2.4.6.

2. Shinat e ripërdorura nuk i nënshtrohen kërkesave për profilin e kokës së shinës, siç përcaktohet në pikën 4.2.4.6.

6.2.4.8 Vlerësimi i ndërruesve

Vlerësimi i ndërruesve hekurudhore që lidhen me pikat 4.2.5.1 deri në 4.2.5.3 duhet të bëhet duke kontrolluar nëse ekziston një vetëdeklarim i administratori të infrastrukturës ose i subjektit kontraktues.

6.2.4.9 Vlerësimi i strukturave të reja, punimeve tokësore dhe efekteve të presionit të tokës

1. Vlerësimi i strukturave të reja duhet të bëhet duke kontrolluar ngarkesat e trafikut dhe limitin e disnivelin të shinave në vijën hekurudhore të përdorur për projektim kundrejt kërkesave minimale të pikave 4.2.7.1 dhe 4.2.7.3. Organi i notifikuar nuk kërkohet të rishikojë projektin dhe as të kryejë ndonjë llogaritje. Kur rishikohet vlera e faktorit alfa e përdorur në projektim sipas pikës 4.2.7.1, është e nevojshme vetëm të kontrollohet nëse vlera e faktorit alfa përputhet me tabelën 8.

2. Vlerësimi i punimeve të reja të tokës dhe efekteve të presionit të tokës duhet të bëhet duke kontrolluar ngarkesat vertikale të përdorura për projektim sipas kërkesave të pikës 4.2.7.2. Kur rishikohet vlera e faktorit alfa të përdorur në projektim sipas pikës 4.2.7.2, është e nevojshme vetëm të kontrollohet nëse vlera e faktorit alfa përputhet me tabelën 8. Organi i notifikuar nuk kërkohet të rishikojë projektin dhe as të kryejë ndonjë llogaritje.

6.2.4.10 Procedura e vlerësimit të strukturave ekzistuese

1. Vlerësimi i strukturave ekzistuese kundrejt kërkesave të pikave 4.2.7.4, pika 3, shkronjat "b" dhe "c", duhet të bëhet me njërën nga metodat e mëposhtme:

a) Një kontroll që vlerat e kategorive të linjave EN, në kombinim me shpejtësinë e lejuar të publikuar ose që synohet të publikohet, për linjat që përmbajnë strukturat, janë në përputhje me kërkesat e shtojcës D;

b) Një kontroll që vlerat e kategorive të linjave EN, në kombinim me shpejtësinë e lejuar të specifikuar për urat ose për projektimin, ose kërkesat alternative të specifikuara me LM71 dhe faktorin alfa (α) për P1 dhe P2, janë në përputhje me kërkesat e shtojcës D;

c) Një kontroll që ngarkesat e trafikut të specifikuara për strukturat ose për projektimin përputhen me kërkesat minimale të pikave 4.2.7.1.1, 4.2.7.1.2 dhe 4.2.7.2. Kur rishikohet vlera e faktorit alfa (α) në përputhje me pikat 4.2.7.1.1 dhe 4.2.7.2, është e nevojshme vetëm të kontrollohet që vlera e faktorit alfa (α) është në përputhje me vlerën e faktorit alfa (α) të përcaktuar në tabelën 8;

ç) Kur kërkesa për një urë ekzistuese specifikohet duke iu referuar modelit të ngarkesës së projektimit

HSLM në shtojcën D, vlerësimi i urës ekzistuese duhet të bëhet me njërën nga metodat e mëposhtme:

- duke kontrolluar specifikimet e projektit të urës ekzistuese;
- duke kontrolluar specifikimin e vlerësimit dinamik;
- kontrollimi i kapacitetit mbajtës të ngarkesës së publikuar të urës ekzistuese në regjistrin e infrastrukturës (RINF) për parametrin 1.1.1.1.2.4.2 (Pajtueshmëria e strukturave me Modelin e Ngarkesës me Shpejtësi të Lartë (HSLM));

d) Kur kërkesa për një urë ekzistuese specifikohet duke iu referuar kërkesave alternative të ngarkesës dinamike, shtojca D, shënimi 8, vlerësimi i urës ekzistuese duhet të bëhet duke kontrolluar specifikimin e vlerësimit dinamik për këto kërkesa alternative të ngarkesës kundrejt kërkesave në shtojcën D shënimi 8.

2. Nuk kërkohet të rishikohet projekti dhe as të kryhen llogaritje.

3. Për vlerësimin e strukturave ekzistuese zbatohet përkatësisht pika 4.2.7.4, pika 4.

6.2.4.11 Vlerësimi i zhvendosjes së platformës

1. Vlerësimi i distancës midis qendrës së linjës hekurudhore dhe skajit të platformës si një rishikim i projektimit duhet të bëhet duke përdorur rezultatet e llogaritjeve të bëra nga administratori i infrastrukturës ose subjekti kontraktues në bazë të specifikimit të referuar në shtojcën G, indeksi 3).

2. Pas montimit para vënies në shërbim, duhet të verifikohen hapësirat e lira. Zhvendosja kontrollohet në skajet e platformës dhe çdo 30 m në linjë hekurudhore të drejtë dhe çdo 10 m në linjë hekurudhore të lakuar.

6.2.4.12 Vlerësimi i ndryshimeve maksimale të presionit në tunele

1. Vlerësimi i ndryshimit maksimal të presionit në tunel (kriteri 10 kPa) duhet të bëhet në përputhje me specifikimin e përmendur në Shtojcën G, Indeksi 14) me trenat që përputhen me TSI LOC&PAS dhe që janë në gjendje të lëvizin me shpejtësinë maksimale të linjës në tunelin specifik që do të vlerësohet.

2. Parametrat hyrës që do të përdoren gjatë vlerësimit duhet të jenë të tillë që të përmbushet nënshkrimi i presionit karakteristik referues të trenave i përcaktuar në TSI LOC&PAS.

3. Sipërfaqet e prerjes tërthore referuese janë përcaktuar në specifikimin e përmendur në Shtojcën G, Indeksi (14).

6.2.4.13 Vlerësimi i efektit të erërave anësore

Ky demonstrim i sigurisë është jashtë fushëveprimit të kësaj TSI-je dhe për këtë arsye nuk i nënshtrohet një verifikimi nga një organ i njoftuar. Demonstrimi duhet të ndërmerret nga administratori i infrastrukturës, nëse është e nevojshme në bashkëpunim me sipërmarrjen hekurudhore.

6.2.4.14 Vlerësimi i instalimeve fikse për shërbimin e trenave

Vlerësimi i instalimeve fikse për shërbimin e trenave është përgjegjësi e ASH.

6.2.4.15 Vlerësimi i përputhshmërisë me sistemet e frenimit

Vlerësimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 4.2.6.2.2, pika 2), nuk është i nevojshëm.

6.2.5 Zgjidhjet teknike që japin supozim konformiteti në fazën e projektimit

Prezumimi i konformitetit në fazën e projektimit për zgjidhjet teknike mund të vlerësohet paraprakisht dhe në mënyrë të pavarur nga një projekt specifik.

6.2.5.1 Vlerësimi i rezistencës së linjës hekurudhore për linjë të thjeshtë

1. Demonstrimi i konformitetit të linjës hekurudhore me kërkesat e pikës 4.2.6 mund të bëhet duke iu referuar një projekti ekzistues të linjës hekurudhore i cili përmbush kushtet e funksionimit të parashikuara për nënsistemin përkatës.

2. Projektimi i linjës hekurudhore përcaktohet nga karakteristikat teknike të përcaktuara në shtojcën C.1 të kësaj TSI-je dhe nga kushtet e tij të funksionimit të përcaktuara në shtojcën Ç.1 të kësaj TSI-je.

3. Një projekt linje hekurudhore konsiderohet ekzistues nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

a) projektimi i linjës hekurudhore ka qenë në funksionim normal për të paktën një vit dhe

b) Tonazhi total mbi linjë hekurudhore ishte të paktën 20 milionë ton bruto për periudhën e funksionimit normal.

4. Kushtet e operimit për një projektim ekzistues të vijës hekurudhore i referohen kushteve që janë aplikuar në operimin normal.

5. Vlerësimi për të konfirmuar një projektim ekzistues të linjës hekurudhore duhet të kryhet duke kontrolluar që karakteristikat teknike të përcaktuara në Shtojcën C.1 të kësaj TSI-je dhe kushtet e përdorimit të përcaktuara në Shtojcën Ç.1 të kësaj TSI-je janë specifikuar dhe që është e disponueshme referenca për përdorimin e mëparshëm të projektimit të linjës hekurudhore.

6. Kur në një projekt përdoret një projekt ekzistues linjës hekurudhore i vlerësuar më parë, organi i notifikuar vlerëson vetëm nëse respektohen kushtet e përdorimit.

7. Për projektimet e reja të vijës hekurudhore që bazohen në projektimet ekzistuese të vijës hekurudhore, mund të kryhet një vlerësim i ri duke verifikuar ndryshimet dhe duke vlerësuar ndikimin e tyre në rezistencën e vijës hekurudhore. Ky vlerësim mund të mbështetet për shembull nga simulimi kompjuterik ose nga testimi laboratorik ose në vend.

8. Një projektim linje hekurudhore konsiderohet i ri, nëse ndryshohet të paktën një nga karakteristikat teknike të përcaktuara në shtojcën C të kësaj TSI-je ose një nga kushtet e përdorimit të përcaktuara në shtojcën Ç të kësaj TSI-je.

6.2.5.2 Vlerësimi për ndërrueset

1. Dispozitat e përcaktuara në pikën 6.2.5.1 zbatohen për vlerësimin e rezistencës së vijës hekurudhore për ndërrueset. shtojca C.2 përcakton karakteristikat teknike të projektimit të ndërruesve dhe shtojca D.2 përcakton kushtet e përdorimit të projektimit të ndërruesve.

2. Vlerësimi i gjeometrisë së projektimit të ndërruesve duhet të bëhet sipas pikës 6.2.4.8 të kësaj TSI-je.

3. Vlerësimi i gjatësisë maksimale të ndërruesve hekurudhore fikse të tipit obtuz duhet të bëhet sipas pikës 6.2.4.8 të kësaj TSI-je.

6.3 Vlerësimi i dosjes së mirëmbajtjes

1. Në përputhje me Kodin, kërkuesi është përgjegjës për përpilimin e dosjes teknike, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar për mirëmbajtje.

2. Organi i njoftuar verifikon vetëm nëse është ofruar dokumentacioni i kërkuar për mirëmbajtje, siç përcaktohet në pikën 4.5.1. Organi i njoftuar nuk është i detyruar të verifikojë informacionin e përfshirë në dokumentacionin e ofruar.

6.4 Nënsisteme që përmbajnë përbërës të ndërveprimit që nuk kanë një deklaratë KE

6.4.1 Kushtet

1. Derisa të rishikohet lista e përbërësve të ndërveprimit të listuar në Kapitullin 5 të kësaj TSI-je, një organ i njoftuar lejohet të lëshojë një certifikatë verifikimi CE për një nënsistem edhe nëse disa nga përbërësit e ndërveprimit të përfshirë brenda nënsistemit nuk mbulohen nga deklaratat përkatëse CE të konformitetit dhe/ose përshtatshmërisë për përdorim sipas kësaj TSI-je, nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) Përputhshmëria e nënsistemit është kontrolluar sipas kërkesave të seksionit 4 dhe në lidhje me seksionet 6.2 deri në 7 (përveç pikës 7.7 'Rastet Specifike') të kësaj TSI-je nga organi i notifikuar. Për më tepër, përputhshmëria e IC-ve me seksionet 5 dhe 6.1 nuk zbatohet, dhe

b) përbërësit e ndërveprimit, të cilët nuk mbulohen nga deklarata përkatëse CE e konformitetit dhe/ose përshtatshmërisë për përdorim, janë përdorur në një nënsistem të miratuar dhe të vënë në shërbim në të paktën para hyrjes në fuqi të kësaj TSI-je.

2. Deklaratat CE të konformitetit dhe/ose përshtatshmërisë për përdorim nuk do të hartohen për përbërësit e ndërveprimit të vlerësuar në këtë mënyrë.

6.4.2 Dokumentacioni

1. Certifikata CE e verifikimit të nënsistemit duhet të tregojë qartë se cilët përbërës të ndërveprimit janë vlerësuar nga organi i notifikuar si pjesë e verifikimit të nënsistemit.

2. Deklarata CE e verifikimit të nënsistemit duhet të tregojë qartë:

a) Cilët përbërës të ndërveprimit janë vlerësuar si pjesë e nënsistemit;

b) Konfirmimi që nënsistemi përmban përbërësit e ndërveprimit identikë me ata të verifikuar si pjesë e nënsistemit;

c) Për ata përbërës të ndërveprimit, arsyeja pse prodhuesi nuk ka siguruar një deklaratë CE të konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorim para përfshirjes së tij në nënsistem, duke përfshirë zbatimin e rregullave kombëtare të njoftuara sipas pikës 4, nenit 62, të Kodit.

6.4.3 Mirëmbajtja e nënsistemeve të certifikuara sipas 6.4.1.

1. Gjatë dhe pas periudhës së tranzicionit dhe derisa nënsistemi të përmirësohet ose rinovohet (duke marrë parasysh vendimin mbi zbatimin e TSI-ve), përbërësit e ndërveprimit që nuk kanë një deklaratë CE të konformitetit ose përshtatshmërisë për përdorim dhe janë të të njëjtit lloj lejohen të përdoren si zëvendësime (pjesë këmbimi) të lidhura me mirëmbajtjen për nënsistemin, nën përgjegjësinë e organit përgjegjës për mirëmbajtjen.

2. Në çdo rast, organi përgjegjës për mirëmbajtjen duhet të sigurojë që komponentët për zëvendësimet që lidhen me mirëmbajtjen të jenë të përshtatshëm për aplikimet e tyre, të përdoren brenda fushës së tyre të përdorimit dhe të mundësojnë arritjen e ndërveprimit brenda sistemit hekurudhor, duke përmbushur në të njëjtën kohë kërkesat thelbësore. Komponentë të tillë duhet të jenë të gjurmueshëm dhe të certifikuar në përputhje me çdo rregull kombëtar ose ndërkombëtar ose çdo kod praktike të pranuar gjerësisht në fushën hekurudhore.

6.5 Nënsistemi që përmban përbërës të ndërveprimit të pjesëve përbërëse që janë të përshtatshëm për ripërdorim

6.5.1 Kushtet

1. Një organ i njoftuar lejohet të lëshojë një certifikatë verifikimi CE për një nënsistem edhe nëse disa nga përbërësit e ndërveprimit të përfshirë

brenda nënsistemit janë përbërës të ndërveprimit të pjesëve përbërëse që janë të përshtatshëm për ripërdorim, nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) Përputhshmëria e nënsistemit është kontrolluar sipas kërkesave të seksionit 4, dhe në lidhje me seksionet 6.2 deri në 7 (përveç pikës 7.7 'Rastet specifike') të kësaj TSI-je nga organi i notifikuar. Për më tepër, përputhshmëria e IC-ve me 6.1 nuk zbatohet; dhe

b) përbërësit e ndërveprimit nuk mbulohen nga deklarata përkatëse CE e konformitetit dhe/ose përshtatshmërisë për përdorim.

2. Deklaratat CE të konformitetit dhe/ose përshtatshmërisë për përdorim nuk do të hartohen për përbërësit e ndërveprimit të vlerësuar në këtë mënyrë.

6.5.2 Dokumentacioni

1. Certifikata CE e verifikimit të nënsistemit duhet të tregojë qartë se cilët përbërës të ndërveprimit janë vlerësuar nga organi i notifikuar si pjesë e verifikimit të nënsistemit.

2. Deklarata CE e verifikimit të nënsistemit duhet të tregojë qartë:

a) Cilët përbërës të ndërveprimit janë përbërës të ndërveprimit të pjesëve përbërëse që janë të përshtatshëm për ripërdorim;

b) Konfirmimi që nënsistemi përmban përbërësit e ndërveprimit identikë me ata të verifikuar si pjesë e nënsistemit.

6.5.3 Përdorimi i përbërësve të ndërveprimit të pjesëve përbërëse në mirëmbajtje

1. Përbërësit e ndërveprimit të pjesëve përbërëse që janë të përshtatshëm për ripërdorim lejohen të përdoren si zëvendësime (pjesë këmbimi) që lidhen me mirëmbajtjen për nënsistemin, nën përgjegjësinë e organit përgjegjës për mirëmbajtjen.

2. Në çdo rast, organi përgjegjës për mirëmbajtjen duhet të sigurojë që komponentët për zëvendësimet që lidhen me mirëmbajtjen të jenë të përshtatshëm për aplikimet e tyre, të përdoren brenda fushës së tyre të përdorimit dhe të mundësojnë arritjen e ndërveprimit brenda sistemit hekurudhor, duke përmbushur në të njëjtën kohë kërkesat thelbësore. Komponentë të tillë duhet të jenë të gjurmueshëm dhe të certifikuar në përputhje me çdo rregull kombëtar ose ndërkombëtar, ose çdo kod praktike të pranuar gjerësisht në fushën hekurudhore.

7. Zbatimi i TSI së infrastrukturës

7.1 Plani kombëtar i zbatimit

ASH-ja duhet të hartojnë një plan kombëtar për zbatimin e kësaj TSI-je, duke synuar koherencën e të gjithë sistemit hekurudhor shqiptar. Ky plan duhet të përfshijë të gjitha projektet në lidhje me nënsistemin e ri, rinovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe duhet të sigurojë një kalim gradual brenda një afati kohor të arsyeshëm drejt një nënsistemi të infrastrukturës së synuar ndërveprues që është plotësisht në përputhje me këtë TSI.

7.2 Zbatimi i kësaj TSI-je në një nënsistem të ri infrastrukture

1. Për një nënsistem të ri infrastrukture, zbatimi i kësaj TSI-je është i detyrueshëm.

2. Një 'nënsistem i ri infrastrukturor' nënkupton një nënsistem infrastrukturor i pa vënë deri tashmë në shërbim, i cili do të krijojë një trafik hekurudhor ose një pjesë të një trafiku aty ku aktualisht nuk ekziston asnjë trafik. Çdo nënsistem tjetër i infrastrukturës do të konsiderohet si 'nënsisteme ekzistuese të infrastrukturës'.

3. Rastet e mëposhtme konsiderohen si 'përmirësim' dhe jo si vënie në shërbim të një nënsistemi të ri infrastrukturor:

a) riorganizimi i një pjese të një trafiku hekurudhor ekzistues;

b) krijimi i një vije të dytë në stacion;

c) shtimi i një ose më shumë vijave hekurudhore në një itinerar ekzistues, pavarësisht distancës midis vijës hekurudhore origjinale dhe vijës hekurudhore shtesë.

7.3 Zbatimi i kësaj TSI-je në një nënsistem ekzistues të infrastrukturës

7.3.1 Kriteret e performancës së nënsistemit

Përveç rasteve të përmendura në pikën 7.2., pika 3), 'përmirësimi' është një punë e madhe modifikimi e një nënsistemi ekzistues të infrastrukturës që rezulton në të paktën pajtueshmëri me një kod shtesë trafiku ose një ndryshim në kombinimin e deklaruar të kodeve të trafikut (referuar tabelës 2 dhe tabelës 3 në pikën 4.2.1).

7.3.2 Zbatimi i TSI-së

Përputhshmëria me këtë TSI është e detyrueshme për një nënsistem ose pjesë të tij që përmirësohen ose rinovohen. Për shkak të karakteristikave të sistemit hekurudhor të trashëguar, përputhshmëria e nënsistemit ekzistues të infrastrukturës me këtë TSI mund të arrihet nëpërmjet një përmirësimi gradual të ndërveprimit:

1. Për nënsistemin e infrastrukturës së përmirësuar, zbatimi i kësaj TSI-je do të jetë i

detyrueshëm dhe do të zbatohet në nënsistemin e përmirësuar brenda mbulimit gjeografik të përmirësimit. Mbulimi gjeografik i përmirësimit do të përcaktohet bazuar në vendndodhjet në vijë hekurudhore dhe referencat metrike dhe do të rezultojë në përputhshmërinë e të gjithë parametrave bazë të nënsistemit të infrastrukturës të lidhur me vijën hekurudhore që i nënshtrohen përmirësimit të nënsistemit të infrastrukturës. Shtimi i një ose më shumë vijave hekurudhore që mbështesin një gjerësi tjetër vijash hekurudhore konsiderohet gjithashtu si përmirësim kur aktivizohen kriteret e performancës së nënsistemit siç përshkruhet në pikën 7.3.1.

2. Në rast të një ndryshimi tjetër përveç një përmirësimi të nënsistemit të infrastrukturës, zbatimi i kësaj TSI-je për secilin parametër bazë (të përmendur në pikën 4.2.2) të prekur nga një ndryshim do të jetë i detyrueshëm kur ndryshimi kërkon kryerjen e një procedure të re verifikimi 'CE'.

3. Në rast të një ndryshimi tjetër përveç një përmirësimi të nënsistemit të infrastrukturës dhe për ato parametra bazë që nuk preken nga ndryshimi, ose kur ndryshimi nuk kërkon një verifikim të ri 'CE', demonstrimi i nivelit të përputhshmërisë me këtë TSI është vullnetar.

4. Në rast të përmirësimit ose rinovimit të nënsistemit të infrastrukturës, nuk kërkohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara për linjat e reja.

5. Në rast të një 'zëvendësimi të madh', siç përcaktohet në nenin 5, pika 56, e Kodit, në kuadër të një 'përmirësimi', elementet e nënsistemit ose pjesët e tij që nuk janë në përputhje me TSI-në duhet të zëvendësohen sistematikisht me elemente që janë në përputhje me TSI-në.

6. 'Zëvendësim në kuadër të mirëmbajtjes' nënkupton çdo zëvendësim i komponentëve me pjesë me funksion dhe performancë identike në kuadër të mirëmbajtjes. Ai duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e kësaj TSI-je, sa herë që është e arsyeshme dhe ekonomikisht e realizueshme dhe nuk kërkon një verifikim 'CE'.

7. Përjashtimet e mëposhtme lejohen për nënsistemin ekzistues të infrastrukturës, në rast të përmirësimit ose rinovimit:

a) Në rastin e përmirësimit ose rinovimit të nënsistemit të infrastrukturës, për parametrat që nuk mund të rregullohen nga pika 4.2.4.2 e kësaj TSI-je dhe mungesa e mbingarkesës e rregulluar nga pika 4.2.4.3 e kësaj TSI-je, lejohet të devijohet nga vlerat kufizuese të përcaktuara në këtë TSI, duke respektuar vlerat kufizuese të jashtëzakonshme dhe duke zbatuar kufizime dhe masa specifike të përcaktuara në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 4. Zbatimi i këtij përjashtimi nuk duhet të pengojë aksesin e mjeteve të autorizuara për vlerat maksimale të kërkuara në pikën 4.2.4.3 të kësaj TSI-je.

b) Në rast të një ndryshimi tjetër përveç përmirësimit të nënsistemit të infrastrukturës, zbatohen kushtet e mëposhtme në lidhje me lartësinë dhe zhvendosjen e platformës, të rregulluara nga pikat 4.2.9.2 dhe 4.2.9.3:

- Lejohet të aplikohen lartësi të tjera nominale të platformës, nëse përputhshmëria me vlerat e përcaktuara në pikën 4.2.9.2 kërkon ndryshime strukturore në çdo element mbajtës ngarkese;

- Lejohet të aplikohet një zhvendosje tjetër e platformës përveç asaj të përcaktuar në pikën 4.2.9.3., pika 2 për sa kohë që vlera për bq është e barabartë ose më e madhe se b_{qlim}.

7.3.3 Linjat ekzistuese që nuk i nënshtrohen një projekti rinovimi ose përmirësimi

Kur një administrator infrastrukture dëshiron të demonstrojë nivelin e përputhshmërisë së një linje ekzistuese me parametrat bazë të kësaj TSI-je, ai duhet të zbatojë procedurën e mbi procedurën për demonstrimin e nivelit të përputhshmërisë së linjave ekzistuese hekurudhore me parametrat bazë të specifikimeve teknike për ndërveprimin.

7.3.4 Kontrollet e përputhshmërisë së itinerarit para përdorimit të mjeteve të autorizuara

Procedura e kontrollit të përputhshmërisë së trafikut hekurudhor që do të zbatohet dhe parametrat e nënsistemit të infrastrukturës që do të përdoren përcaktohen në pikën 4.2.2.5 dhe shtojcën Ç.1 të TSI OPE.

7.4 Raste specifike

Rastet specifike të mëposhtme mund të aplikohen në rrjete të caktuara. Rastet specifike klasifikohen si:

a) Rastet 'P': raste të përhershme;

b) Rastet 'T': raste të përkohshme.

Të gjitha rastet specifike dhe datat e tyre përkatëse do të rishqyrtohen gjatë rishikimeve të ardhshme të TSI-së me qëllim kufizimin e fushëveprimit të tyre teknik dhe gjeografik bazuar në një vlerësim të ndikimit të tyre në siguri, ndërveprim, shërbime ndërkufitare, korridoret TEN-T dhe ndikimet praktike dhe ekonomike të mbajtjes ose

eliminimit të tyre. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet disponueshmërisë së fondeve të BE-së.

Rastet specifike duhet të kufizohen në itinerar ose rrjet kur ato janë rreptësisht të nevojshme dhe të merren parasysh përmes procedurave të përputhshmërisë së itinerarit.

SHTOJCA A
VLERËSIMI I PËRBËRËSVE TË NDËRVEPRIMIT

Karakteristikat e përbërësve të ndërveprimit që do të vlerësohen nga organi i njoftuar ose prodhuesi në përputhje me modulin e zgjedhur, në fazat e ndryshme të projektimit, zhvillimit dhe prodhimit, shënohen me 'X' në tabelën 17. Kur nuk kërkohet vlerësim, ky shënohet me 'na' në tabelë. Nuk ka procedura të veçanta vlerësimi të kërkuara për përbërësit e ndërveprimit të nënsistemit të infrastrukturës.

Tabela 17: Vlerësimi i përbërësve të ndërveprimit për deklaratën CE të konformitetit

Karakteristikat që duhen vlerësuar	Vlerësimi në fazën pasuese			
	Faza e projektimit dhe zhvillimit			Faza e prodhimit Procesi i prodhimit + testimi i produktit
	Rishikimi i dizajnit	Rishikimi i procesit të prodhimit	Testi i tipit	Cilësia e produktit (seri)
5.3.1 Shina				
5.3.1.1 Profili i kokës së shinës	X	jo	X	X
5.3.1.2 Çelik shinash	X	X	X	X
5.3.2 Sistemet e fiksimit të shinave	na	na	X	X
5.3.3 Traversat në binarë	X	X	na	X

SHTOJCA B
VLERËSIMI I NËNSISTEMIT TË INFRASTRUKTURËS

Karakteristikat e nënsistemit që do të vlerësohen në fazat e ndryshme të projektimit, ndërtimit dhe funksionimit janë shënuar me 'X' në tabelën 18.

Kur nuk kërkohet vlerësim nga një organ i njoftuar, kjo shënohet me 'na' në tabelë. Kjo nuk parandalon nevojën për kryerjen e vlerësimeve të tjera në kuadër të fazave të tjera.

Përkufizimi i fazave të vlerësimit:

1. 'Rishikimi i projektimit': përfshin kontrollin e saktësisë së vlerave/parametrave kundrejt kërkesave të zbatueshme të TSI-së që lidhen me projektin përfundimtar.

2. 'Montimi para vënies në shërbim': kontrolli në vend që produkti ose nënsistemi aktual të jetë në përputhje me parametrat përkatës të projektimit pak para se të vihet në funksion

Kolona 3 jep referenca për pikën 6.2.4, "Procedurat e veçanta të vlerësimit për nënsistemin" dhe për pikën 6.2.5, "Zgjidhjet teknike që japin supozimin e konformitetit në fazën e projektimit".

Tabela 18: Vlerësimi i nënsistemit të infrastrukturës për verifikimin CE të konformiteti

Karakteristikat që duhen vlerësuar	Linjë e re ose projekt përmirësimi/rinovimi		Procedura të veçanta vlerësimi
	Rishikimi i dizajnit	Montimi para vënies në shërbim	
	1	2	3
Dimensioni i profilit të lirë (4.2.3.1)	X	X	6.2.4.1

Distanca midis akseve të vijave hekurudhore (4.2.3.2)	X	X	6.2.4.2
Pjerrësi maksimale (4.2.3.3)	X	jo	
Rrezja minimale e kthesës horizontale (4.2.3.4)	X	X	6.2.4.4
Rrezja minimale e kthesës vertikale (4.2.3.5)	X	jo	6.2.4.4
Gjerësia nominale e vijës hekurudhore (4.2.4.1)	X	X	6.2.4.3
Mbilartësimi (4.2.4.2)	X	X	6.2.4.4
Mbilartësimi i pamjaftueshëm (4.2.4.3)	X	na	6.2.4.4 6.2.4.5
Ndryshim i menjëhershëm i mbilartësimit (4.2.4.4)	X	na	6.2.4.4
Vlerësimi i vlerave të projektimit për konicitet efektiv i rrotës gjatë operimit normal (4.2.4.5)	X	na	6.2.4.6
Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë (4.2.4.6)	X	na	6.2.4.7
Mbilartësimi i shinës së jashtme (4.2.4.7)	X	na	
Gjeometria e projektimit të ndërruesve hekurudhorë (4.2.5.1)	X	na	6.2.4.8
Përdorimi i ndërruesve me zemër të lëvizshme (4.2.5.2)	X	na	6.2.4.8
Gjatësia maksimale e ndërruesve hekurudhore fikse të tipit obtuz (4.2.5.3)	X	na	6.2.4.8
Rezistenca e shinave ndaj ngarkesave vertikale (4.2.6.1)	X	na	6.2.5
Rezistenca gjatësore e shinave (4.2.6.2)	X	na	6.2.5 6.2.4.15
Rezistenca anësore e shinave (4.2.6.3)	X	na	6.2.5
Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut (4.2.7.1)	X	na	6.2.4.9
Ngarkesë vertikale ekuivalente për punime të reja dheu dhe efekte të presionit të tokës (4.2.7.2)	X	na	6.2.4.9
Rezistenca e strukturave të reja mbi ose ngjitur me shinat (4.2.7.3)	X	na	6.2.4.9
Rezistenca e urave dhe punimeve të dheut ekzistuese ndaj ngarkesave të trafikut (4.2.7.4)	X	na	6.2.4.10
Kufiri i veprimit të menjëhershëm për shtrirjen (4.2.8.1)	na	na	
Kufiri i veprimit të menjëhershëm për nivelin gjatësor (4.2.8.2)	na	na	
Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për disnivelin e shinave në vijën hekurudhore (4.2.8.3)	na	na	
Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për hapjen e vijës hekurudhore mbi vlerat e lejuara (4.2.8.4)	na	na	
Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme në mbilartësimin jo normal në vijën hekurudhore (4.2.8.5)	na	na	
Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për ndërrueset hekurudhore (4.2.8.6)	na	na	
Gjatësia e përdorshme e platformave (4.2.9.1)	X	na	
Lartësia e platformës (4.2.9.2)	X	X	
Zhvendosja e platformës (4.2.9.3)	X	X	6.2.4.11
Planifikimi i vijës hekurudhore përgjatë platformave (4.2.9.4)	X	na	

Ndryshimi maksimal i presionit në tunele (4.2.10.1)	X	na	6.2.4.12
Efekti i erërave anësore (4.2.10.2)	na	na	6.2.4.13
Shenjat(treguesit) e vendndodhjes (4.2.11.1)	na	na	
Koniciteti efektiv i rrotës gjatë operimit normal (4.2.11.2)	na	na	
Shkarkimi i tualetit (4.2.12.2)	na	na	6.2.4.14
Pajisjet e pastrimit të jashtëm të trenit (4.2.12.3)	na	na	6.2.4.14
Rimbushja e rezervave me ujë (4.2.12.4)	na	na	6.2.4.14
Furnizimi me karburant (4.2.12.5)	na	na	6.2.4.14
Furnizim elektrik në trase (4.2.12.6)	na	na	6.2.4.14
Zbatimi i përbërësve të ndërveprimit	na	X	

SHTOJCA C
KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË PROJEKTIMIT TË VIJËS HEKURUDHORE DHE TË NDËRRUESVE

Shtojca C.1
Karakteristikat teknike të projektimit të vijës hekurudhore

Projektimi i vijës hekurudhore duhet të përcaktohet të paktën nga karakteristikat teknike si më poshtë:

a) Shinat:

- Profili(et) dhe mbilartësimi;
- Shinë e gjatë e salduar ose gjatësi shinash (për seksionet e shinave të bashkuara),

b) Sistemi i fiksimit:

- Lloji;
- Ngurtësia e vijës hekurudhore;
- Forca e shtrëngimit;
- Tërheqja gjatësore,

c) Traversat:

- Tipi;
- Rezistenca ndaj ngarkesave vertikale;
- Betoni: momentet e përkuljes së projektimit;
- Druri: përputhshmëria me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 15;
- Çeliku: momenti i inercisë së prerjes tërthore;
- Rezistenca ndaj ngarkesave gjatësore dhe anësore: gjeometria dhe pesha;
- Gjerësia nominale midis faqeve të brendshme të shinave dhe e projektuar e vijës hekurudhore,

ç) Pjerrësia e shinave (këndi me të cilin shina anohet drejt aksit të vijës hekurudhore);

d) Seksionet tërthore të balastit (gjerësia e balastit - trashësia e balastit);

dh) Lloji i balastit (gradimi = granulometria);

e) Hapi distanca aksiale e vendosjes së traversave;

ë) Pajisje të veçanta: për shembull fiksimet e traversave me shinat Pandol ose Vosslov, shina e tretë/e katërt etj.

Shtojca C.2
Karakteristikat teknike të projektimit të ndërruesve

Projektimi i ndërruesve duhet të përcaktohet të paktën nga karakteristikat teknike, si më poshtë:

a) Shinat:

- Profile(a) dhe klasa (shina ndërruese, shina standarde);
- Shinë e gjatë e salduar ose gjatësi shinash (për seksionet e shinave të bashkuara),

b)Sistemi i fiksimit:

- Lloji;
- Aftësia e strukturës së vijës hekurudhore për të përballuar peshën e trenave që vepron në drejtim vertikal;
- Forca e shtrëngimit;
- Tërheqja gjatësore,

c)Traversa:

- Tipi;
- Rezistenca ndaj ngarkesave vertikale;
- Betoni: momentet e përkuljes së projektimit;
- Druri: përputhshmëria me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 15;
- Çeliku: momenti i inercisë së prerjes tërthore;
- Rezistenca ndaj ngarkesave gjatësore dhe anësore: gjeometria dhe pesha;
- Gjerësia nominale e vijës hekurudhore,

ç) Pjerrësia e shinave në drejtim të aksit të vijës hekurudhore;

d) Seksionet tërthore të balastit (shpatulla e balastit - trashësia e balastit);

dh) Lloji i balastit (gradimi = granulometria);

e) Lloji i kalimit (pikë fikse ose e lëvizshme);

ë) Lloji i bllokimit (me anë të gjilpërave, me zemër me majë të lëvizshme (paneli i çelësave, pika e lëvizshme e kalimit);

f)Pajisje të veçanta: për shembull ankorat e traversave, shina e tretë/e katërt, etj.;

g)Vizatim i përgjithshëm që tregon ndërrime dhe kalime:

- Diagram gjeometrik (trekëndësh) që përshkruan gjatësinë e kthesës dhe tangjentet në fund të kthesës;
- Karakteristikat kryesore gjeometrike si rrezet kryesore në ndërprerës, panelin e mbylljes dhe kryqëzimit, këndi i kryqëzimit;
- Hapi i vendosjes (montimit) të traversave.

SHTOJCA Ç
PARAMETRAT E PROJEKTIMIT TË VIJËS HEKURUDHORE DHE TË NDËRRUESVE

Shtojca Ç.1
Parametrat e projektimit të vijës hekurudhore

Kushtet e përdorimit të projektimit të vijës hekurudhore përcaktohen si më poshtë:

a) Ngarkesa maksimale e aksit(t);

b) Shpejtësia maksimale e linjës (km/orë);

c) Rrezja minimale e kthesës horizontale (m);

ç) Mbilartësia maksimale (mm);

d) Mungesa maksimale e mbilartësisë (mm).

Shtojca Ç.2
Parametrat e projektimit të ndërruesve

Kushtet e përdorimit të projektimit të ndërruesve dhe kalimeve përcaktohen si më poshtë:

a) Ngarkesa maksimale e aksit(t);

b) Shpejtësia maksimale e vijës hekurudhore (km/orë) në një vijë të drejtë dhe në vijat të devijuara nga ndërrueset;

c) Norma për ndërruese të kurbëzuara, bazuar në projekte që tregojnë kurbëzim minimal (për linjë direkte dhe në vija të devijuara nga ndërrueset.)

SHTOJCA D
KËRKESAT E AFTËSISË PËR STRUKTURAT EKZISTUESE NË PËRPUTHJE ME KODIN E TRAFIKUT

Kërkesat minimale të aftësisë për urat ekzistuese në përputhje me pikën 4.2.7.4, pika 2, përcaktohen në tabelën 19A dhe tabelën 20A, në përputhje me kodet e trafikut të dhëna në tabelën 2 dhe tabelën 3. Këto kërkesa të aftësisë përcaktohen duke përdorur vetëm ngarkesën vertikale të përcaktuar nga kategoria e linjës EN me një shpejtësi përkatëse ose nga LM71 me faktorin alfa. Kërkesat shtesë të aftësisë dinamike shprehen nga modeli i ngarkesës dinamike HSLM. Kategoria e linjës EN dhe shpejtësia përkatëse duhet të konsiderohen si një sasi e vetme e kombinuar. Kërkesat minimale të aftësisë për strukturat ekzistuese gjeoteknike dhe punimet tokësore në përputhje me pikën 4.2.7.4, pika 2, janë përcaktuar në tabelën 19B dhe tabelën 20B, në përputhje me kodet e trafikut të dhëna në tabelën 2 dhe tabelën 3.

Kategoritë e linjave EN janë një funksion i ngarkesës së aksit dhe aspekteve gjeometrike që lidhen me hapësirën midis akseve dhe janë përcaktuar në specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 2.

Për urat e vazhdueshme, duhet të merret në konsideratë rasti me efektet më të rënda midis Modelit të Ngarkesës 71(LM71) dhe Modelit të Ngarkesës SW/0 LM71, Modeli i Ngarkesës SW/0 dhe Modeli i Ngarkesës HSLM janë përcaktuar në specifikimin e referuar në Shtojcën G, Indeksi (10).

Tabela 19A: Kërkesat për aftësinë e ngarkimit për urat dhe kërkesat shtesë për shkak të efekteve dinamike(1)

Kodi i trafikut	Trafiku me trena të tërhequr nga lokomotiva: Trena udhëtarësh duke përfshirë vagonët (për udhëtarë, bagazhe dhe transport makinash) dhe vagonët e lehtë të mallrave, lokomotivat dhe kokat e transportit elektrik (2)(3)(5)(6)(4)	Trafiku me Njësi të Shumëfishta Elektrike ose Diezel, Njësi Fuqie dhe Vagonë Hekurudhore (2)(5)(4)
P1	na (7)	HSLM (8) dhe D2-200 ose HSLM (8) dhe LM71 me $\alpha = 1.0$ (14)
P2	HSLM (8) dhe D2-200	HSLM (8) dhe D2-200

	Ose HSLM [8] dhe LM71 me α = 0.91 [14]	Ose HSLM [8] dhe LM71 me α = 0.91 [14]
P3a (> 160 km/orë)	L ≥4m D2-100 dhe Gjatësi <4m D2-200 [9][10][15]	L≥4m C2-100 dhe L<4m C2-200 [9][15]
P3b (≤ 160 km/orë)	L ≥4m D2-100 dhe Gjatësi <4m D2-160 [9][11][15]	L≥4m D2-100 dhe Gjatësi <4m D2-160 [9][15]
P4a (> 160 km/orë)	L ≥4m D2-100 dhe Gjatësi <4m D2-200 [9][12][15]	L≥4m C2-100 dhe L<4m C2-200 [9][15]
P4b (≤ 160 km/orë)	L ≥4m D2-100 dhe Gjatësi <4m D2-160 [9][13][15]	L≥4m C2-100 dhe L<4m C2-160 [9][15]
P5	C2-120	B1-120
P6	a12	
P1520	Pika e hapur	
P1600	Pika e hapur	

Tabela 20A: Kërkesat e aftësisë së ngarkimit për urat e shprehura nga Kategoria e Linjës EN – Shpejtësia e lejuar [1]

Kodi i trafikut	Trena mallrash duke përfshirë vagonët e mallrave, mjete të tjera dhe lokomotiva [2]
F1	D4 – 120
F2	D2 – 120
F3	C2 – 100
F4	B2 – 100
F1520	Pika e hapur
F1600	Pika e hapur

Shënime:

[1]Vlera e shpejtësisë së treguar në tabela përfaqëson kërkesën maksimale për linjën dhe mund të jetë më e ulët në përputhje me kërkesat në pikën 4.2.1, pika 12. Gjatë kontrollit të strukturave individuale në linjë, është e pranueshme të merren parasysh shpejtësitë e lejuara lokale, siç tregohet edhe në shënimet 2 dhe 3, të tabelës 2 dhe në shënimin 1 të tabelës 3.

[2]Vagonët e udhëtarëve (duke përfshirë vagonët për udhëtarë, bagazhe dhe transport makinash), mjetet e tjera, lokomotivat, kokat e fuqisë, njësitë e shumëfishta me naftë dhe elektrike, njësitë e fuqisë dhe vagonët hekurudhorë përcaktohen në TSI LOC&PAS. Vagonët e mallrave të lehta përcaktohen si vagonë mallrash, përveçse lejohen të transportohen në formacione që nuk synojnë transportimin e udhëtarëve.

[3]Kërkesat për strukturat e përcaktuara duke përdorur kategoritë e linjave EN ose modelin e ngarkesës LM71 janë të pajtueshme me deri në dy lokomotiva të lidhura dhe/ose koka fuqie ngjitur. Kërkesat për strukturat janë të pajtueshme me një shpejtësi maksimale prej 120 km/orë për tre ose më shumë lokomotiva dhe/ose koka fuqie të lidhura ngjitur (ose një tren lokomotivash dhe/ose koka fuqie) me kusht që lokomotivat dhe/ose kokat fuqie të plotësojnë kufijtë përkatës për vagonët e mallrave.

[4]Për kodet e trafikut P2, P3 dhe P4, zbatohen kërkesat si për trafikun me trena të tërhequr nga lokomotivat, ashtu edhe për trafikun me njësi të shumëfishta. Për kodin e trafikut P5, ASH-ja mund të tregojë nëse zbatohen kërkesat për lokomotivat dhe kokat e fuqisë.

[5]Kërkesat për strukturat janë të pajtueshme me vagonët, vagonët e mallrave të lehta dhe njësitë e shumëfishta elektrike ose me naftë me një masë

mesatare për njësi gjatësie mbi gjatësinë e secilit automjet prej 2.45 t/m për kategorinë e linjës EN A, 2.75 t/m për kategorinë e linjës EN B1, 3.1 t/m për kategorinë e linjës EN C2 dhe 3.5 t/m për kategorinë e linjës EN D2 (jo për P5).

(6)Kërkesat për strukturat janë të pajtueshme me lokomotivat me 4 akse dhe kokat e fuqisë me një hapësirë aksesh në një vagon prej të paktën 2.6 m dhe masën mesatare për njësi gjatësie mbi gjatësinë e mjetit deri në 5.0 t/m.

(7)Duke marrë parasysh gjendjen e operimit, nuk ka nevojë të përcaktohen kërkesa të harmonizuara për të ofruar një nivel të përshtatshëm ndërveprimi për këto lloje mjetesh për kodin e trafikut P1.

(8)Për linjat P1 dhe P2, duhet të deklarohet përputhshmëria me HSLM në përputhje me specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10) (shih procedurën në pikën 6.2.4.10 të kësaj TSI-je). Nëse nuk mund të tregohet përputhshmëria me HSLM, për qëllime të kontrolleve të përputhshmërisë dinamike të përcaktuara në përputhje me kontrollin e përputhshmërisë së itinerarit në shtojcën Ç.1 të TSI-së OPE (parametri RINF 1.1.1.1.2.4.4), ngarkesa dinamike, për të cilën duhet të kontrollohet përputhshmëria me urat ekzistuese, duhet të jepet në dokumente me procedurën(et) siç përcaktohet në parametrin RINF 1.1.1.1.2.4.4 (shih, gjithashtu, procedurën në pikën 6.2.4.10 të kësaj TSI-je). Kur duhet të ndërmerret një analizë dinamike me modele ngarkese bazuar në trena individualë, vlera karakteristike e ngarkesës për udhëtarët ose mjetet që mbajnë bagazhe duhet të jetë në përputhje me masën e projektimit nën ngarkesë normale në përputhje me Shtojcën Ë të kësaj TSI-je.

(9)Për të shmangur efektet dinamike të tepërta, përfshirë rezonancën, aktualisht nuk është e mundur të specifikohen vetitë minimale të harmonizuara të urës për të shmangur nevojën për një vlerësim dinamik. Ngarkesa dinamike nga mjetet që plotësojnë kërkesat e ngarkesës statike të urës (e specifikuar ose si Kategori Linje në përputhje me specifikimin e referuar në Shtojcën G, Indeksi (2) ose në terma të modelit të ngarkesës LM71) në një numër rastesh mund t'i tejkalojë këto kërkesa normale të ngarkesës statike të urës (kur këto ngarkesa statike rriten nga lejimet normale të industrisë për faktorët dinamikë për rillogaritjen e urës ose projektimin e urës). Ky rrezik për përputhshmërinë midis mjeteve dhe urave menaxhohet nga kontrollet e përputhshmërisë dinamike të përcaktuara në Shtojcën Ç.1 të TSI OPE (parametri RINF 1.1.1.1.2.4.4). Kur duhet të ndërmerret një analizë dinamike me modele ngarkese bazuar në trena individualë, vlera karakteristike e ngarkesës për udhëtarët ose mjetet që mbajnë bagazhe duhet të jetë në përputhje me masën e projektimit nën ngarkesë normale në përputhje me shtojcën Ë të kësaj TSI.

(10)Kërkesat për trenat e udhëtarëve që tërhiqen nga lokomotivat janë të vlefshme për vagonët dhe vagonët e mallrave të lehta që plotësojnë kategorinë A të linjës EN për shpejtësi deri në 200 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale) ose kategorinë C2 të linjës EN për shpejtësi deri në 160 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale).

(11)Kërkesat për trenat e udhëtarëve që tërhiqen nga lokomotivat janë të vlefshme për vagonët dhe vagonët e mallrave të lehta që plotësojnë kategorinë e linjës EN C2 për shpejtësi deri në 160 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale).

(12)Kërkesat për trenat e udhëtarëve që tërhiqen nga lokomotivat janë të vlefshme për vagonët dhe vagonët e mallrave të lehta që plotësojnë kategorinë A të linjës EN për shpejtësi deri në 200 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale) ose kategorinë B1 të linjës EN për shpejtësi deri në 160 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale).

(13)Kërkesat për trenat e udhëtarëve që tërhiqen nga lokomotivat janë të vlefshme për vagonët dhe vagonët e mallrave të lehta që plotësojnë kategorinë e linjës EN B1 për shpejtësi deri në 160 km/orë (shpejtësia e lejuar lokale).

(14)Kërkesat e përcaktuara duke përdorur kategoritë e linjave EN ose modelin e ngarkesës LM71 mund të përmbushen ose nëpërmjet kategorisë së linjës EN me shpejtësinë përkatëse ose me LM71 me faktorin alfa në përputhje me specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 10). Vendimi midis dy opsioneve të disponueshme, jo domosdoshmërish më i vështiri, duhet të merret ekskluzivisht nga aplikanti. Kategoria e linjës EN me shpejtësinë përkatëse bazohet në ngarkesën statike të shumëzuar me një faktor amplifikimi dinamik.

(15)Kur kërkesat minimale të aftësisë për një kod trafiku të dhënë në tabelën 19A jepen për shembull në formën L>=4m D2-100 dhe L<4m

D2-200, duhet të përmbushen kriteret përkatëse në përputhje me gjatësinë e ngarkuar L të elementit të urës që po merret në konsideratë. Kategoria e linjës EN me shpejtësinë përkatëse bazohet në ngarkesën statike të shumëzuar me një faktor amplifikimi dinamik.

Tabela 19B: Kërkesat për kapacitetin e ngarkesës për strukturat gjeoteknike dhe punimet tokësore (1)(2)

Kodi i trafikut	Trafiku me trena të tërhequr nga lokomotiva: Trena udhëtarësh duke përfshirë vagonët (për udhëtarë, bagazhe dhe transport makinash) dhe vagonët e lehtë të mallrave, lokomotivat dhe kokat motorike (3)	Trafiku me Njësi të Shumëfishta Elektrike ose Diezel, Njësi Fuqie dhe Vagonë Hekurudhore (3)
P1	na (4)	D2
P2	D2	D2
P3a (> 160 km/orë)	D2	C2
P3b (≤ 160 km/orë)	D2	D2
P4a (> 160 km/orë)	D2	C2
P4b (≤ 160 km/orë)	D2	C2
P5	C2	B1
P6	a12	
P1520	pikë e hapur	
P1600	pikë e hapur	

Tabela 20B: Kërkesat për kapacitetin e ngarkesës së urave dhe kërkesat shtesë për shkak të efekteve dinamike

Kodi i trafikut	Trena mallrash duke përfshirë vagonët e mallrave, mjete të tjera dhe lokomotiva
F1	D4
F2	D2
F3	C2
F4	B2
F1520	pikë e hapur
F1600	pikë e hapur

Shënime:

(1)Kategoritë e publikuara të linjës së seksionit të linjës, duke përfshirë punimet e dheut, marrin parasysh shpejtësitë e lejuara lokale.

(2)Vagonët e udhëtarëve (duke përfshirë vagonët për udhëtarë, bagazhe dhe transport makinash), mjetet e tjera, lokomotivat, kokat e fuqisë, njësitë e shumëfishta me naftë dhe elektrike, njësitë e fuqisë dhe vagonët hekurudhorë përcaktohen në pikën 2.2 të TSI LOC&PAS. Vagonët e lehtë të mallrave përcaktohen si furgonë, përveçse lejohen të transportohen në formacione që nuk synojnë të transportojnë udhëtarë.

(3)Për kodet e trafikut P2, P3 dhe P4 zbatohen kërkesat si për trafikun me trena të tërhequr nga lokomotivat, ashtu edhe për trafikun me njësi të shumëfishta. Për kodin e trafikut P5, ASH mund të tregojë nëse zbatohen kërkesat për lokomotivat dhe kokat e fuqisë.

(4)Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të funksionimit, nuk ka nevojë të përcaktohen kërkesa të harmonizuara për të ofruar një nivel të përshtatshëm ndërveprimi për këtë lloj automjetesh për kodet e trafikut P1.

SHTOJCA DH
GARANTIMI I SIGURISË NË KRYQËZIMET HEKURUDHORE ME KËND TË GJERË

(Dh.1)Kalimet në kryqëzimet hekurudhore me kënd të gjerë duhet të projektohen në mënyrë që të mos kenë një gjatësi shumë të gjatë pa udhëzues anësor të rrotës. Në kalimet e gjera, shinat e kontrollit nuk mund të ndërtohen për të siguruar udhëzim në të gjithë gjatësinë. Kjo gjatësi e paudhëzuar anësore mund të pranohet deri në një kufi të caktuar, të përcaktuar nga një situatë referimi që përcakton:

a) Këndi minimal i kryqëzimit: tangjent 1 në 9 (tg = 0,11, α= 6°20');
b) Rrezja minimale përmes kalimit të gjerë: 450 m;
c) Lartësia minimale e shinës së kontrollit: 45 mm;
ç) Forma e harkut siç përcaktohet në figurën më poshtë.

Figura 3



Figura 4



X = 3 mm (mbi një gjatësi prej 150 mm).

Y = 8 mm (mbi një gjatësi prej afërsisht 200 deri në 500 mm).

(J.2) Nëse nuk respektohet një ose më shumë nga kërkesat e mësipërme, projekti duhet të kontrollohet, duke verifikuar ose ekuivalencën e gjatësisë së paudhëzuar ose pranimin e ndërhyrjes midis rrotës dhe hundës(pjesë specifike e kryqëzimit ku takohen shinat e krahëve, dhe kjo është një zonë kritike ku rrota po kalon në një trajektore të re) kur ato bien në kontakt.

(J.3) Projektimi duhet të kontrollohet për rrota me diametër midis 630 mm dhe 840 mm. Për diametrat e rrotave midis 330 mm dhe 630 mm kërkohen demonstrime specifike.

(J.4) Grafikët e mëposhtëm lejojnë verifikimin e thjeshtë të gjatësisë së paudhëzuar për situata specifike me kënde të ndryshme kalimi, lartësi të kundërshinës dhe lakim të ndryshëm të kalimit.

Grafikët marrin në konsideratë tolerancat maksimale të shinave si më poshtë:

a) Gjerësia e shinave midis 1433 mm dhe 1439 mm;

b) Mbrojtje e harkut midis 1393 mm dhe 1398 mm;

c) Kalimi i lirë i rrotës ≤ 1 356 mm.

Figura 5 lejon të specifikohet diametri minimal i rrotës që mund të ecë në kalimet e lakuara të gjera me një rreze prej 450 m, ndërsa Figura 5 e lejon këtë për kalimet e drejta të gjera.

Për raste të tjera, mund të kryhen llogaritje specifike.

(J.5) Për sistemet me gjerësi shinash përveç 1435 mm, duhet të kryhen llogaritje specifike.

Figura 5: Diametri minimal i rrotës në lidhje me këndin e ndërrueses për kryqëzim të theksuar me rreze 450m



1. Diametri minimal i rrotës (mm).
2. N për këndin e ndërrueses tangjent 1 në N.
3. Lartësia e kundër shinës (mm) (Z3)

Figura 6: Diametri minimal i rrotës kundrejt në raport me këndin e ndërrueses për një ndërrim të drejtë të gjerë



1. Diametri minimal i rrotës (mm).
2. N për këndin e ndërrueses tangjent 1 në N.
3. Lartësia e kundër shinës (mm) (Z3)

SHTOJCA E
BAZA E KËRKESAVE MINIMALE PËR STRUKTURAT PËR VAGONËT E UDHËTARËVE DHE NJËSITË E SHUMËFISHTA

Përkufizimet e mëposhtme të masës për vagonët e udhëtarëve dhe njësitë e shumëfishta përbëjnë bazën e kërkesave minimale dinamike për strukturat dhe kontrollin e përputhshmërisë së strukturave me vagonët e udhëtarëve dhe njësitë e shumëfishta.

Kur kërkohet një vlerësim dinamik për të përcaktuar kapacitetin mbajtës të ngarkesës së urës, kapaciteti mbajtës i ngarkesës së urës duhet të specifikohet dhe të shprehet në terma të masës së projektimit nën ngarkesë normale në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 1, duke marrë parasysh vlerat për ngarkesën e udhëtarëve në zonat në këmbë të dhëna në tabelën 21.

Përkufizimet e masës për përputhshmërinë statike bazohen në masën e projektimit nën ngarkesë të jashtëzakonshme të përcaktuar në përputhje me specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 1, duke marrë parasysh specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi (2).

Tabela 21: Ngarkesa e udhëtarëve në zonat në këmbë në kg/m2 në përputhje me specifikimin e përmendur në shtojcën G, indeksi 1

Lloji i trenit	***Ngarkesë normale*** **për të specifikuar Përputhshmëria Dinamike**
Trena me shpejtësi të lartë dhe distanca të gjata	160 ([1])
Trena me shpejtësi të lartë dhe distanca të gjata Rezervimi i detyrueshëm	0
Të tjerë (trena rajonalë, të udhëtarëve, të periferive)	280
([1])Ngarkesa normale e dobishme e specifikimit të referuar në shtojcën G, indeksi 1 plus 160 kg/m² shtesë për zonat në këmbë	

SHTOJCA Ë
LISTA E PIKAVE TË HAPURA

1. Kufizimet e veprimit të menjëhershëm për defekte të izoluara në vijë hekurudhore për shpejtësi më të mëdha se 300 km/orë (4.2.8.1).

2. Kufijtë e veprimit të menjëhershëm për defektet e izoluara në nivelin vertikal të vijës hekurudhore për shpejtësi më të mëdha se 300 km/orë (4.2.8.2).

3. Vlera minimale e lejuar e distancës midis qendrave të vijave hekurudhore për dimensionin uniform të strukturës IRL3 është një pikë e hapur (7.7.18.2).

4. Kategoria e Vijës EN – Shpejtësia e lidhur (km/orë) për kodet e trafikut P1520 (të gjitha mjetet), P1600 (të gjitha mjetet), F1520 (të gjitha mjetet) dhe F1600 (të gjitha mjetet) në Shtojcën D, tabelat 19A, 20A, 19B dhe 20B.

5. Numri i Disponueshmërisë së Itinerarit – Shpejtësia e lidhur (milje/orë) për kodet e trafikut P1 (njësi

të shumëfishta), P2 (njësi të shumëfishta), P3a (njësi të shumëfishta), P4a (njësi të shumëfishta), P1600 (të gjitha mjetet) dhe F1600 (të gjitha mjetet).

6. Rregullat dhe vizatimet që lidhen me matësat IRL1, IRL2 dhe IRL3 janë një pikë e hapur.

7. Kërkesat për zbutjen e rrezikut për ngritjen e balastit për shpejtësi më të madhe se 250 km/orë.

SHTOJCA F
FJALORI

Tabela 22: Kushtet

Term i përcaktuar	Pika TSI	Përkufizim
Pika aktuale (RP)	4.2.8.6	Pika aktuale(RP) – është maja e zemrës në ndërruesen hekurudhore. Shih figurën 2, e cila tregon marrëdhënien midis pikës aktuale (RP) dhe pikës së kryqëzimit (IP).
Kufiri i alarmit	4.5.2	Është një sinjal që vendoset në vijën hekurudhore ose në bordin e kabinës, paralajmëron makinistin se po afrohet ose ka kaluar shpejtësinë e lejuar për një seksion të caktuar të vijën hekurudhore që kërkon që gjendja e gjeometrisë së vijës hekurudhore të analizohet dhe të merret në konsideratë në operacionet e mirëmbajtjes të planifikuara rregullisht.
Ngarkesa aksiale	4.2.1, 4.2.6.1	Shuma e forcave statike vertikale të rrotave të ushtruara mbi shinë përmes një çifti rrotash ose një çifti rrotash të pavarura pjesëtuar me përshpejtimin e gravitetit.
Sisteme frenimi të pavarura nga kushtet e fërkimit rrotë-shinë	4.2.6.2.2	'Sisteme frenimi të pavarura nga kushtet e frenimit rrotë-shinë' i referohet të gjitha sistemeve të frenimit të mjetit hekurudhor të afta të zhvillojnë një forcë frenimi të aplikuar në shina pavarësisht nga kushtet e fërkimit rrotë-shinë (p.sh., sistemet magnetike të frenimit dhe sistemet e frenimit me rrymë vorbull).
Mbilartësimi	4.2.4.2 4.2.8.5	Diferenca në lartësi, në lidhje me planin horizontal të dy shinave të një vije hekurudhore të vetëm në një vendndodhje të caktuar, e matur në aksin e kokave të shinave.
Mbilartësimi maksimale	4.2.4.3	Diferenca midis mbilartësimit të aplikuar dhe mbilartësimit të ekuilibrit të sipërm = deficiti i mbilartësimi.
Kalim i përbashkët	4.2.8.6	Rregullim që siguron kryqëzimin e dy skajeve të kundërta të kthesave ose kalimeve në formë diamanti dhe që ka një formë v kalimi dhe dy shina anësore.
Erë anësore	4.2.10.2	Erë e fortë që fryn anash një linje e cila mund të ndikojë negativisht në sigurinë e qarkullimit të trenave.
Vlera e vizatimit	4.2.3.4, 4.2.4.2, 4.2.4.5, 4.2.5.1, 4.2.5.3	Vlerë teorike pa tolerancat e prodhimit, ndërtimit ose mirëmbajtjes.
Gjerësia e vijës hekurudhore të projektimit	5.3.3	Një vlerë e vetme e cila merret kur të gjithë komponentët e vijës hekurudhore përputhen saktësisht me dimensionet e tyre të projektimit ose me dimensionin e tyre mesatar të projektimit kur ka një diapazon.
Distanca midis qendrave të shinave	4.2.3.2	Distanca midis pikave të vijave qendrore të dy shinave në shqyrtim, e matur paralelisht me sipërfaqen e lëvizjes së vijës referuese, domethënë vijës hekurudhore me më pak pjerrësi.
Forca anësore dinamike	4.2.6.3	Shuma e forcave dinamike të ushtruara nga një çift rrotash mbi shinë në drejtimin anësor.
Punime dheu	4.2.7.2, 4.2.7.4	Strukturat e tokës dhe strukturat mbajtëse të tokës që i nënshtrohen ngarkesës së trafikut hekurudhor.
Kategoria e linjës EN	4.2.7.4, Shtojca D	Rezultati i procesit të klasifikimit të përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 2 dhe i referuar në atë standard si 'Kategoria e Linjës'. Ai përfaqëson aftësinë e infrastrukturës për t'i bërë ballë ngarkesave vertikale të imponuara nga mjetet në linjë ose seksion të linjës për shërbim normal.
Koniciteti ekuivalent	4.2.4.5, 4.2.11.2	Tangjentja e këndit konik të një seti rrotash me rrota konike, lëvizja anësore e të cilave ka të njëjtën gjatësi vale kinematike si seti i dhënë i rrotave në vijë të drejtë dhe harku me rreze të madhe.

Mbrojtje fikse e harkut	4.2.5.3, Shtojca Dh	Dimensioni midis harkut të kryqëzimit dhe kundërshinës
Thellësia e fllanxhës	4.2.8.6	Dimensioni midis sipërfaqes së lëvizjes dhe pjesës së poshtme të hapësirës së fllanxhës (shih dimensionin nr. 6, në figurën 6).
Gjerësia e fllanxhës	4.2.8.6	Dimensioni midis një shine lëvizëse dhe një shine anësore ose anësore ngjitur (shih dimensionin nr. 5, në figurën 6).
Kalim i lirë i rrotave në shinën e kundërt	4.2.8.6	Dimensioni midis sipërfaqes së punës së shinës anësore të kryqëzimit dhe sipërfaqes së matësit të shinës lëvizëse përballë matësit të matur në hyrje të shinës anësore përkatësisht. (shih dimensionet nr. 4, në figurën 6). Hyrja në shinën e kontrollit ose shinën anësore është pika në të cilën rrota lejohet të kontaktojë shinën e kontrollit ose shinën anësore.
Kalim i lirë i rrotës në qendrën e ndërrueses	4.2.8.6	Dimensioni midis sipërfaqes së punës së shinës së krahut të kryqëzimit dhe shinës së kontrollit përballë matësit (shih dimensionin nr. 3, në figurën 6).
Kalim i lirë i rrotave në ndërruese	4.2.8.6.	Dimensionet nga sipërfaqja e matshme e njërës shinë ndërruese deri tek skaji i pasmë i shinës së kundërt ndërruese (shih dimensionin nr. 1, në figurën 6).
Gabariti i strukturës	4.2.1, 4.2.3.1	Një grup rregullash që përfshijnë një kontur referimi dhe rregullat e llogaritjes së shoqëruara me të, të cilat lejojnë përcaktimin e dimensioneve të jashtme të mjetit dhe hapësirës që do të lirohet nga infrastruktura.
Strukturat gjeoteknike	4.2.7.2, 4.2.7.4	Një strukturë që përfshin tokë ose element strukturor që mbështetet në rezistencën e tokës. Shënim: Punimet e tokës janë një nëngrup për strukturën gjeoteknike
HBW/HBW/HBW	5.3.1.2	Njësia jo-SI për fortësinë e çelikut e përcaktuar në specifikimin e referuar në shtojcën G, indeksi 16.
Lartësia e kundërshinës	4.2.8.6, Shtojca Dh	Lartësia e kundërshinës mbi sipërfaqen e lëvizjes (shih dimensionin 7 në Figurën 6 më poshtë).
Kufiri i veprimit të menjëhershëm	4.2.8, 4.5	Vlera e cila, nëse tejkalohet, kërkon marrjen e masave për të zvogëluar rrezikun e daljes nga shinat në një nivel të pranueshëm.
Administrator i Infrastrukturës	4.2.5.1, 4.2.8.3, 4.2.8.6, 4.2.11.2 4.4, 4.5.2, 4.6, 4.7, 6.2.2.1, 6.2.4, 6.4	Siç përcaktohet në nenin 5, pika 1 e Kodit.
Vlera në shërbim	4.2.8.5, 4.2.11.2	Vlerë e matur në çdo kohë pasi infrastruktura është vënë në shërbim.
Pika e kryqëzimit (IP)	4.2.8.6	Pika teorike e kryqëzimit të skajeve të kalimit në qendër të kryqëzimit (shih figurën 2).
Kufiri i ndërhyrjes	4.5.2	Vlera, e cila, nëse tejkalohet, kërkon mirëmbajtje korrigjuese në mënyrë që kufiri i veprimit të menjëhershëm të mos arrihet para inspektimit të ardhshëm;
Defekt i izoluar	4.2.8	Një defekt i veçantë i gjeometrisë së vijës hekurudhore.
Shpejtësia e linjës	4.2.1	Shpejtësia maksimale për të cilën është projektuar një linjë.
Dosja e mirëmbajtjes	4.5.1	Elementet e dosjes teknike që lidhen me kushtet dhe kufizimet e përdorimit dhe udhëzimet për mirëmbajtje.
Plani i mirëmbajtjes	4.5.2	Një seri dokumentesh që përcaktojnë procedurat e mirëmbajtjes së infrastrukturës të miratuara nga një administrator infrastrukture.
Vija hekurudhore me shumë shina	4.2.2.2	Vija hekurudhore me më shumë se dy shina, ku të paktën dy palë shina përkatëse janë projektuar për t'u operuar si shina të vetme të ndara, me ose pa gjerësi të ndryshme shinash.
Matësi nominal i vijës hekurudhore	4.2.4.1	Një vlerë e vetme që identifikon gjerësinë e shinave, por që mund të ndryshojë nga gjerësia e shinave të projektuar.
Shërbim normal	4.2.2.2 4.2.9	Hekurudha që operon sipas një orari të planifikuar.

Përgatitje pasive	4.2.9	Parashikimi për ndërtimin e ardhshëm të një zgjerimi fizik të një strukture (për shembull: rritja e gjatësisë së platformës).
Parametri i performancës	4.2.1	Parametër që përshkruan një kategori linje TSI të përdorur si bazë për projektimin e elementeve të nënsistemit të infrastrukturës dhe si tregues i nivelit të performancës së një linje.
Vijë e thjeshtë	4.2.4.5 4.2.4.6 4.2.4.7	Seksion i linjës pa ndërrime dhe kalime.
Kufijtë e ndërhyrjes së menjëhershme për ndërrueset hekurudhore	4.2.8.6	Vija e referencës në një kryqëzim të përbashkët të fiksuar mund të devijojë nga vija teorike e referencës. Nga një distancë e caktuar deri në pikën e kryqëzimit, vija e referencës së vijës V, në varësi të projektimit, mund të tërhiqet nga kjo vijë teorike larg fllanxhës së rrotës në mënyrë që të shmanget kontakti midis të dyja elementeve. Kjo situatë përshkruhet në figurën 2.
Pjerrësia hekurudhore	4.2.4.5 4.2.4.7	Një kënd që përcakton pjerrësinë e kokës së një shine kur instalohet në vijë hekurudhore në krahasim me planin e shinave (sipërfaqja e lëvizjes), i barabartë me këndin midis aksit të simetrisë së shinës (ose të një shine simetrike ekuivalente që ka të njëjtin profil të kokës së shinës) dhe pingules me planin e shinave.
Jastëk hekurudhor	5.3.2	Një shtresë elastike e vendosur midis një shine dhe traversës mbështetëse ose pllakës së bazës.
Kurbë e kundërt	4.2.3.4	Dy kthesa ngjitur me përkulje ose dorë të kundërt
Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1	Përcakton hapësirën në lidhje me binarin referues që duhet të pastrohet nga të gjitha objektet ose strukturat dhe nga trafiku në binarët ngjitur, në mënyrë që të lejojë operimin e sigurt në binarin referues. Përcaktohet në bazë të konturit referues duke zbatuar rregullat përkatëse.
Shinë e lëvizshme	4.2.5.2	Brenda fushës së 'kryqëzimit të përbashkët me pikë të lëvizshme', termi 'shinë lëvizëse" identifikon pjesën e kryqëzimit që formon vijën V dhe që lëvizet për të formuar një skaj të vazhdueshëm lëvizjeje për vijën kryesore ose për vijën e degës.
Ndërruese	4.2.8.6	Një njësi shine që përbëhet nga dy shina të fiksuara (shina standarde) dhe dy shina të lëvizshme (shina ndërruese) të përdorura për të drejtuar mjetet nga një linjë në tjetrën.
Ndërrime dhe kalime hekurudhore	4.2.4.5, 4.2.4.7, 4.2.5, 4.2.6, 4.2.8.6, 5.2, 6.2.4.4, 6.2.4.8, 6.2.5.2, 7.3.3, Shtojca C dhe Ç,	Linja e ndërtuar nga grupe ndërruesish hekurudhorë dhe kalimesh individuale dhe shinat që i lidhin ato.
Lëvizje e vazhdueshme	Shtojca Ç	Në kontekstin e ndërrimeve dhe kalimeve, një rrugë që vazhdon përgjatë një rrjeti hekurudhor, shpesh pa transferime ose përfundime të ndërmjetme.
Projektimi i linjës	4.2.6, 6.2.5, Shtojca C dhe Ç	Projektimi i linjës përbëhet nga një prerje tërthore që përcakton dimensionet bazë dhe përbërësit e linjës (për shembull shina, elementet e lidhjes së vijës hekurudhore, traversat, balasti) të përdorura së bashku me kushtet e operimit me ndikim në forcat që lidhen me 4.2.6, të tilla si ngarkesa aksiale, shpejtësia dhe rrezja e lakimit horizontal.
Gjerësia e shinave	4.2.4.1, 4.2.4.5, 4.2.8.4, 5.3.3, 6.1.5.2, 6.2.4.3.	Distanca midis faqeve të brendshme të kokave të shinave, e matur 14 mm poshtë kokës së shinës.
Mbilartësimi i shinës së jashtme të vijës hekurudhore	4.2.7.1.6 4.2.8.3, 6.2.4.9,	Shtrembërimi i vijës hekurudhore përkufizohet si diferenca algjebrike midis dy niveleve tërthore të matura në një distancë të caktuar. Ai përgjithësisht shprehet si një gradient midis dy pikave të matjes së nivelit tërthor.

Gjatësia e trenit	4.2.1	Gjatësia e një treni, i cili mund të qarkullojë në një linjë të caktuar në funksionim normal.
Gjatësia e pa udhëzuar në ndërrueset hekurudhore me dy zemra	4.2.5.3, Shtojca Dh	Pjesë e kryqëzimit këndor ku nuk ka udhëzim të rrotës, e përshkruar si 'gjatësi e paudhëzuar' në specifikimin e përmendur në Shtojcën G, Indeksi (17).
Gjatësia e përdorshme e një platforme	4.2.1, 4.2.9.1	Gjatësia maksimale e vazhdueshme e asaj pjese të platformës, përpara së cilës një tren është menduar të mbetet i palëvizshëm në kushte normale operimi që udhëtarët të hipin dhe të zbresin nga treni, duke bërë llogaritë e duhura për tolerancat e ndalimit. Kushtet normale të operimit nënkuptojnë që hekurudha po operon në një gjendje jo të degraduar (p.sh., ngjitja në shinë është normale, sinjalet po funksionojnë, gjithçka po funksionon sipas planit).

Figura 6: Gjeometria e ndërruesve



1. Kalim i lirë i rrotave në ndërrues.
2. Distanca midis majës të zemrës së ndërrueses dhe faqes së jashtme të kundërshinës.
3. Distanca midis faqes së jashtme të kundërshinës dhe majës të zemrës së ndërrueses.
4. Distanca midis faqes së brendshme të shinës bazë dhe faqes së jashtme të majës së gjilpërës.
5. Hapësira midis zemrës së ndërrueses dhe majës se gjilpërës.
6. Thellësia e fllanxhës.
7. Lartësia midis kokës së shinës dhe kundërshinës

SHTOJCA G
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË REFERUARA NË KËTË TSI

Tabela 23: Standardet e referuara

Indeksi	Karakteristikat që duhen vlerësuar	Pika TSI	Pika standarde e detyrueshme
(1)	**EN 15663:2017+A1:2018** **Zbatimet hekurudhore – Masat referuese të mjeteve hekurudhore**		
(1.1)	Përkufizimi masiv i mjeteve hekurudhore	4.2.1(7), Tabela 2 Shtojca E	4.5
(1.2)	Përkufizimi masiv i mjeteve hekurudhore	4.2.1(7), Tabela 3	4.5 dhe 7.4
(1.3)	Ngarkesa e udhëtarëve për trenat me shpejtësi të lartë dhe në distanca të gjata	Shtojca E, Tabela 21	Tabela 7
(1.4)	Ngarkesa e udhëtarëve për trenat e tjerë	Shtojca E, Tabela 21	Tabela 8
(2)	**EN 15528:2021**		

	Aplikacione hekurudhore – Kategoritë e linjave për menaxhimin e ndërveprimit midis kufijve të ngarkesës së mjeteve dhe infrastrukturës		
(2.1)	Përkufizimi masiv i mjeteve hekurudhore	4.2.1(7), Tabela 2 Shtojca E	6.4
(2.2)	Kërkesat e aftësisë për strukturat ekzistuese në përputhje me kodin e trafikut	Shtojca D	Shtojca A
(2.3)	Kategoritë e linjave	Shtojca D, Tabela 19A shënimi (9)	
(2.4)	Përkufizimi i kategorisë së linjës	Shtojca F	5
(3)	**EN 15273-3:2013+A1:2016** **Zbatime hekurudhore – Gabaritet – Pjesa 3: gabaritet e strukturës**		
(3.1)	Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1(1)	Shtojca C dhe në Shtojcën Ç, pika Ç.4.8
(3.2)	Dimensioni i profilit të lirë	4.2.3.1(2)	Shtojca C
(3.3)	Dimensioni i profilit të lirë Vlerësim	4.2.3.1(3) 6.2.4.1	5, 7, 10 Shtojca C dhe në Shtojcën Ç, pika Ç.4.8
(3.4)	Distanca midis qendrave të shinave Vlerësim	4.2.3.2(3) 6.2.4.2	9
(3.5)	Zhvendosja e platformës Vlerësim	4.2.9.3(1) 6.2.4.11(1)	13
(4)	**EN 13803:2017** **Zbatime hekurudhore – Vija hekurudhore – Parametrat e projektimit të gjeometrisë së vijës hekurudhore – Gjerësia e vijës hekurudhore 1435 mm e më gjerë**		
(4.1)	Rrezja minimale e kurbës horizontale Përkufizimi i mjetit referues	4.2.3.4(2)	4.2.3.4(2)
(4.2)	Përmirësimi ose rinovimi i infrastrukturës, për parametrat e mbingarkesës dhe mungesës së mbingarkesës	7.3.2	6.2 (Tabela 5) dhe 6.3 (tabela 7 për trenat pa anim) (shih edhe shënimet përkatëse në të dy kapitujt).
(5)	**EN 15302:2021** **Zbatime hekurudhore – Parametrat e gjeometrisë së kontaktit rrotë-shinë – Përkufizime dhe metoda për vlerësim**		
(5.1)	Koniciteti ekuivalent	4.2.4.5(4)	6, 8, 9, 12
(5.2)	Vlerësim	6.2.4.6	6, 8, 9, 12
(6)	**EN 13715:2020** **Zbatime hekurudhore – Sete rrotash dhe vagonë – Rrota – Profili i sipërfaqes së rrotës**		
(6.1)	Koniciteti ekuivalent	4.2.4.5(4)(a) dhe (b)	Shtojca C
(6.2)	Koniciteti ekuivalent	4.2.4.5(4)(c) dhe (d)	Shtojca B
(7)	**EN 13674-1:2011+A1:2017** **Zbatime hekurudhore – Binarë – Shina – Pjesa 1: Shina hekurudhore Vignole 46 kg/m e lart**		
(7.1)	Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë	4.2.4.6(1)	Shtojca A
(7.2)	Vlerësimi i shinave	6.1.5.1(a)	9.1.8
(7.3)	Vlerësimi i shinave	6.1.5.1(b)	9.1.9
(7.4)	Vlerësimi i shinave	6.1.5.1(c)	8.1 dhe 8.4
(8)	**EN 13674-4:2006+A1:2009** **Zbatime hekurudhore - Binari – Shina – Pjesa 4: Shinat hekurudhore Vignole nga 27 kg/m deri në, por duke përjashtuar 46 kg/m**		
(8.1)	Profili i kokës së shinës për linjë të thjeshtë	4.2.4.6(1)	Shtojca A
(9)	**EN 14363:2016+A2:2022** **Zbatime hekurudhore - Testimi dhe simulimi për pranimin e karakteristikave të lëvizjes së mjeteve hekurudhore - Testet e sjelljes së lëvizjes dhe testet stacionare**		
(9.1)	Rezistenca e vijës hekurudhore ndaj ngarkesave vertikale Rezistenca anësore e binarit	4.2.6.1(b) dhe (c) 4.2.6.3(b)	7.5.3
(9.2)	Rezistenca anësore e binarit	4.2.6.3(a)	7.5.2 dhe Tabela 4
(10)	**EN 1991-2:2003/AC:2010**		

	Eurokodi 1: Veprimet mbi strukturat – Pjesa 2: Ngarkesat e trafikut në ura		
(10.1)	Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut	4.2.7	
(10.2)	Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut: Ngarkesa vertikale	4.2.7.1.1(1)(a)	6.3.2 (2)P ([1])
	Ngarkesë vertikale ekuivalente për strukturat e reja gjeoteknike, punimet e dheut dhe efektet e presionit të tokës	4.2.7.2(1)	
	Kërkesat e aftësisë për strukturat ekzistuese në përputhje me kodin e trafikut	Shtojca D – Modeli i Ngarkesës 71	
(10.3)	Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut: Ngarkesa vertikale	4.2.7.1.1(1)(b)	6.3.3 (3)
	Kërkesat e aftësisë për strukturat ekzistuese në përputhje me kodin e trafikut	Shtojca D – Modeli i ngarkesës SW/0	
(10.4)	Rezistenca e urave të reja ndaj ngarkesave të trafikut: Ngarkesa vertikale	4.2.7.1.1(2)	6.3.2 (3) dhe 6.3.3 (5)
	Ngarkesë vertikale ekuivalente për strukturat e reja gjeoteknike, punimet e dheut dhe efektet e presionit të tokës	4.2.7.2(2)	
(10.5)	Llogaritja për efektet dinamike të ngarkesave vertikale	4.2.7.1.2(1)	6.4.3 (1)P dhe 6.4.5.2 (2)
(10.6)	Llogaritja për efektet dinamike të ngarkesave vertikale	4.2.7.1.2(2)	6.4.4
(10.7)	Llogaritja për efektet dinamike të ngarkesave vertikale	4.2.7.1.2(2)	6.4.6.1.1 (3) deri në (6)
	Kërkesat e aftësisë për strukturat ekzistuese në përputhje me kodin e trafikut	Shtojca D – Modeli i ngarkesës HSLM	
(10.8)	Forcat centrifugale	4.2.7.1.3	6.5.1 (2), (4) dhe (7)
(10.9)	Forcat e harkut	4.2.7.1.4	6.5.2
(10.10)	Veprimet për shkak të tërheqjes dhe frenimit (ngarkesat gjatësore)	4.2.7.1.5	6.5.3 (2), (4), (5), (6).dhe (7)
(10.11)	Rezistenca e strukturave të reja mbi ose ngjitur me shinat	4.2.7.3	6.6.2 deri në 6.6.6
(11)	**Shtojca A2 e EN 1990:2002 e lëshuar si EN 1990:2002/A1:2005** **Eurokodi – Bazat e projektimit strukturor**		
(11.1)	Rezistenca e strukturave ndaj ngarkesave të trafikut	4.2.7	
(11.2)	Shtrembërimi i binarit të projektuar për shkak të veprimeve të trafikut hekurudhor	4.2.7.1.6	A2.4.4.2.2(3)P
(12)	**EN 13848-5:2017** **Zbatime hekurudhore – Shina – Cilësia e gjeometrisë së shinës – Pjesa 5: Nivelet e cilësisë gjeometrike – Vijë e thjeshtë, ndërrime dhe kalime**		
(12.1)	Kufiri i veprimit të menjëhershëm për shtrirjen	4.2.8.1(1)	7.5.Kufijtë e diapazonit të gjatësisë së valës D1 janë përcaktuar në tabelën 5
(12.2)	Kufiri i veprimit të menjëhershëm për nivelin gjatësor	4.2.8.2(1)	7.3.Kufijtë e diapazonit të gjatësisë së valës D1 të përcaktuara në tabelën 4
(12.3)	Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për përdredhjen e binarit	4.2.8.3(2)	7.6
(13)	**EN 13848-1:2019** **Zbatime hekurudhore – Bina – Cilësia e gjeometrisë së binarit – Pjesa 1: Karakterizimi i gjeometrisë së binarit**		
(13.1)	Kufiri i ndërhyrjes së menjëhershme për përdredhjen e binarit	4.2.8.3(1)	6.5
(14)	**EN 14067-5:2021/AC:2023** **Zbatimet hekurudhore – Aerodinamika – Pjesa 5: Kërkesat dhe procedurat e testimit për aerodinamikën në tunele**		
(14.1)	Kriter për tunele të reja	4.2.10.1(1)	6.1.3 Tabela 7
(14.2)	Kriter për tunelet ekzistuese	4.2.10.1(3)	6.1.4
(14.3)	Procedura e vlerësimit	6.2.4.12(1)	6.1, 7.4
(14.4)	Prerja tërthore e referencës	6.2.4.12(3)	6.1.2.1

(15)	**EN 13145:2001** **Zbatime hekurudhore – Shina – Traversa dhe mbështetëse druri**		
(15.1)	Rezistenca ndaj ngarkesave vertikale	Shtojca C.1, pika (c) Shtojca C.2, pika (c)	
(16)	**EN ISO 6506-1:2014** **Materiale metalike – Testi i fortësisë Brinell. Metoda e provës.**		
(16.1)	Përkufizimi i fortësisë së çelikut	Shtojca F	
(17)	**EN 13232-3:2003** **Zbatime hekurudhore – Shina – Ndërrime dhe kalime – Pjesa 3: Kërkesat për bashkëveprimin rrotë/shinë**		
(17.1)	Përkufizimi i 'gjatësisë së paudhëzuar të një kryqëzimi të gjerë'	Shtojca F	4.2.5
(1) Nëse miratohet nga ASH, lejohet të projektohen struktura gjeoteknike, punime dheu dhe të llogariten efektet e presionit të tokës duke përdorur ngarkesa në linjë ose ngarkesa pikësore, ku efektet e ngarkesës së tyre korrespondojnë me Modelin e Ngarkesës 71 me faktor α.			

Tabela 24: Dokumente teknike (të disponueshme në faqen e internetit të ERA-s)

Indeksi	Karakteristikat që duhen vlerësuar	Pika TSI	Pikë e detyrueshme e dokumentit teknik
(A)	**Dokumenti Teknik i ERA-s mbi kodifikimin e transportit të kombinuar ERA/TD/2023-01/CCT versioni 1.1 (realizuar më 2023-03-21)**		
(A.1)	Kodifikimi i linjave	2.6	2.1

URDHËR
Nr. 162, datë 10.8.2026

PËR SHFUQIZIM TË URDHRIT NR. 42, DATË 15.2.2024, TË MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME, "PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

URDHËROJ:

1. Urdhri nr. 42, datë 15.2.2024, i ministrit të Punëve të Brendshme, "Për delegim të kompetencave", shfuqizohet.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

URDHËR
Nr. 1593/1, datë 31.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Mbrojtjes zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, për nënshkrimin e akteve administrative, nga data 3.8.2026 deri më datë 6.8.2026.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejdi Joti, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

URDHËR
Nr. 134, datë 6.8.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negociimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën 10-ditore (dhjetëditore), duke filluar nga data 10.8.2026 deri në datën 21.8.2026.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti, drejtor i Negociimit dhe Asistencës Ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 16399/20

ALMA LIÇAJ
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 qershor 2026, si një Komitet i përbërë nga:

Diana Kovatcheva, *Kryetare,*
Darian Pavli,
Vasilka Sancin, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 16399/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) më 8 prill 2020, nga një shtetase shqiptare, znj. Alma Liçaj (kërkuesja), e cila ka lindur në vitin 1976, banon në Vlorë dhe u përfaqësua nga z. A. Saccucci, dhe znj. G. Borgna, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin në Romë;

vendimin për të njoftuar mbi ankesën, në lidhje me të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës private qeverinë shqiptare (Qeveria), përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për ta shpallur pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkarkimin nga detyra të kërkueses nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) në bazë të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar (*Vetting*-u) (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

2. Kërkuesja u emërua gjyqtare në vitin 2000 dhe së fundmi ushtroi detyrën e Kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë. Ajo u martua me M. L.-në në vitin 2003.

3. Më 15 nëntor 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuesen nga detyra. KPK iu referua, veçanërisht, një automjeti të blerë nga M. L. në vitin 2009, i cili rezultonte të ishte raportuar si i vjedhur, dhe që më parë kishte qenë në bashkëpronësi të tij me një person tjetër; si dhe huave private (me sa duket, të paktën njëra prej tyre me para në dorë në vitin 2013) për dy apartamente në Tiranë, të cilat ishin deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar (*vetting*) si pasuri e përbashkët bashkëshortore.

4. Më 23 shtator 2019, KPA-ja la në fuqi shkarkimin e kërkueses në bazë të nenit 61(3) dhe 5 të Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar. KPA-ja vendosi si më poshtë, lidhur me apartamentin e parë në Tiranë.

a) Në vitin 2008, M. L. dhe A. M. kishin nënshkruar një marrëveshje huaje për shumën prej 60,000 eurosh (EUR), të dhëna hua M. L.-së nga kjo e fundit, me qëllim blerjen e një apartamenti.

Nëpërmjet një kontrate ndërtimi të vitit 2009 me kompaninë A. C. dhe kompaninë B., M. L. kishte kontraktuar blerjen e një apartamenti në Tiranë për shumën 97,664 EUR, përfshirë një vendparkim prej 12,000 EUR; kontrata parashikonte dorëzimin brenda 24 muajve dhe penalitet për vonesë. Në deklaratën e saj të pasurisë për vitin 2009, kërkuesja kishte raportuar shumën 72,000 EUR si pagesë për atë apartament. Rezulton se në dhjetor të vitit 2016, kompania B. e kishte ulur çmimin e blerjes me 9,964 EUR dhe ishte lëshuar një procesverbal për dorëzimin e apartamentit. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si burime u renditën: huaja prej 60.000 eurosh, ulja e çmimit me 25.664 euro dhe huaja prej 12.000 eurosh në vitin 2009 nga vëllai i bashkëshortit, A. L.

b) Deklarimi i pasurisë së kërkueses për vitin 2009 kishte treguar si burime financimi për të njëjtën banesë pagat dhe kursimet, dhe kishte lënë pa përmendur vendparkimin me vlerë 12,000 euro, i cili ishte deklaruar për herë të parë në deklaratën e vitit 2016. Deklarata e procesit të rivlerësimit (*vetting*-ut), ndërkohë, iu referua huave. Kur, në vitin 2010, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) kishte konstatuar një mungesë fondesh prej rreth 16,000 eurosh për vitin 2009, kërkuesja kishte përmendur huan prej 12,000 eurosh, për të cilën A. L. kishte nënshkruar një deklaratë të noterizuar të nesërmen. Megjithatë, ajo hua ishte deklaruar për herë të parë vetëm në deklaratën e vitit 2013 (si e pashlyer). A. L., i cili vetë ishte bërë subjekt deklarues në vitin 2013 sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurive të vitit 2003, nuk e kishte deklaruar kurrë atë. Ai pretendonte se kishte pasur mundësi financiare për të dhënë hua nga dy burime: të ardhura të lidhura me kompaninë L., në të cilën pretendohej se kishte qenë i përfshirë si ortak dhe/ose administrator; dhe të ardhura që pretendohej se vinin nga një "zonë ndërtimi", të cilën ai pretendonte se e kishte përfituar përmes një kontrate zhvillimi të vitit 2005 dhe më pas e kishte kthyer në vlerë monetare. Megjithatë, gjatë periudhës 2005–2009, ai nuk kishte pasur asnjë rol në kompani dhe nuk ishin deklaruar apo shpërndarë divendë; ai nuk e kishte marrë zonën e pretenduar të ndërtimit; dhe të dhënat për pagën e tij i përkisnin periudhës së mëvonshme. Kështu, kërkuesja kishte bërë një deklarim të rremë lidhur me huan nga A. L.

c) Kërkuesja pretendonte se A. M. kishte pasur burime të ligjshme për të dhënë shumën prej 60,000 eurosh përmes aktivitetit të biznesit dhe likuiditetit bankar. Megjithatë, KPA-ja konstatoi se fitimet e tij të dokumentuara deri në vitin 2008 kishin qenë të kufizuara, se të dhënat bankare të siguruara nga KPK-ja nuk e mbështetnin një shumë të tillë dhe se mënyra e deklaruar e shlyerjes nuk ishte dokumentuar në mënyrë bindëse. KPA-ja identifikoi mospërputhje në llogaritjet e shlyerjes dhe hodhi poshtë pretendimin për rifinancimin e borxhit të mbetur përmes një huaje prej 30,000 eurosh nga K. S. në vitin 2013. Aftësia financiare e K. S. nuk u konfirmua pas shqyrtimit të të dhënave të tij tatimore, të dhënave mbi pagën, qarkullimin dhe fitimet për periudhën 2012–2013, si dhe të të ardhurave të prindërve të tij nga qiraja, për të cilat nuk ekzistonin prova të transferimeve tek K. S. apo konfirmime tatimore.

d) Kërkuesja pretendoi se shuma e pashlyer prej 25,664 eurosh ishte zbritur nga çmimi prej 97,664 eurosh "me marrëveshje të palëve", për shkak të penaliteteve për vonesë dhe shpenzimeve të M. L. për punimet e ndërtimit. Megjithatë, në vitin 2014 ajo kishte deklaruar para ILDKPKI-së se i kishte "marrë tashmë çelësat e apartamentit" dhe se ajo shumë do të paguhej në momentin e regjistrimit të pronës. Ajo nuk kishte deklaruar as borxhin e mbetur, e as uljen e tij të supozuar vjetore. Dokumentet e punimeve të viteve 2010–2015 përsërisnin të njëjtat punime dhe vlera, si dhe binin në kundërshtim me të dhënat e ILDKPKI-së dhe me kontratën, e cila nuk lejonte kryerjen e punimeve të ndërtimit nga palë të treta. Punimet e pretenduara ishin kryer falas nga kompania L. përmes një nënkontraktori. Asnjë provë nuk tregonte për një marrëveshje specifike midis dy kompanive për uljen e çmimit me 25,664 euro; rrjedhimisht, ulja e pretenduar ishte e paprovuar dhe deklarimi për të ishte i rremë.

5. Lidhur me apartamentin e dytë në Tiranë, KPA-ja vuri në dukje se kërkuesja kishte deklaruar një hua prej 70,000 eurosh, të dhënë nga L. S. në muajin korrik të vitit 2016, si burimin e përdorur nga M. L. për të blerë atë apartament për 60,000 euro në të njëjtin muaj. L. S. deklaroi se i kishte pasur mjetet për të dhënë atë hua nga fitimet e një kompanie, në të cilën zotëronte 50%. KPA-ja shqyrtoi raportet financiare të kompanisë, të dhënat tatimore të saj dhe të L. S., si dhe disa dokumente të tjera. Ajo

konstatoi se aktiviteti i kompanisë ishte pezulluar në vitin 2014 dhe se, megjithëse ajo kishte gjeneruar fitime në vitet e mëparshme, nuk kishte shpërndarë asnjë divident të tatueshëm. KPA-ja vuri, gjithashtu, në dukje se kërkuesja i referohej një pagese të plotë e të menjëhershme me para në dorë në korrik të vitit 2016, ndonëse kontrata pasqyronte këste të mëparshme; se kontratat e shërbimeve për apartamentin ishin në emër të M. L. që nga viti 2014; dhe se çmimi ishte shumë më i ulët si krahasuar me atë që vetë shitësit kishin paguar në vitin 2009, ashtu edhe me vlerën zyrtare të referencës. Kërkuesja nuk provoi një burim të ligjshëm për pagesën prej 60,000 eurosh.

6. Gjithashtu, KPA-ja deklaroi se në vitin 2009, M. L. kishte blerë një makinë për 600,000 lekë (ALL, rreth 4,580 euro në atë kohë) dhe e kishte shitur atë për 20,000 euro në vitin 2010, duke lidhur dy kontrata të ndryshme shitjeje me të njëjtin blerës para noterëve të ndryshëm. KPA-ja e rrëzoi shpjegimin se çmimi i ulët i blerjes ishte vendosur për shkak të dyshimit se makina ishte e vjedhur dhe konstatoi se kontrata e shitjes kishte qenë thjesht një formalitet, me qëllim justifikimin e shumës prej 20,000 eurosh të përdorur atë vit për të blerë një makinë tjetër dhe për të treguar një bilanc pozitiv që mbulonte një pjesë të kredisë së marrë nga A. M. Nuk ishte paguar asnjë tatim mbi fitimin për shitjen e vitit 2010 dhe nuk ishte provuar që M. L. të kishte paguar për ndonjë riparim apo përmirësim që do të shpjegonte rritjen katërfish të vlerës. Për këtë arsye, KPA-ja konstatoi "veprime fiktive", një deklarim të rremë dhe mospërcaktimin e vlerës reale të makinës. Gjetje të ngjashme u konstatuan edhe për një makinë tjetër, të blerë për 500,000 lekë në vitin 2002 dhe të shitur për 15,000 euro në vitin 2013, për të cilën nuk ishte dorëzuar deklarata e detyrueshme e të ardhurave. M. L. pretendoi se të ardhurat ishin përdorur në vitin 2014 për të blerë një makinë tjetër, e cila më vonë ishte shkëmbyer dhe dhuruar për A. L. Vlera doganore e makinës (3,750,000 lekë) ndryshonte nga vlera e deklaruar në kontratën e dhurimit (1,000,000 lekë). Së fundmi, një automjet Volkswagen, i blerë në vitin 2010 për 100,000 lekë ishte shitur në vitin 2014 për 3,000 euro. Në këtë mënyrë, kërkuesja kishte cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë përmes transaksioneve të tilla të dyshimta brenda familjes së saj.

7. Së fundmi, KPA-ja konstatoi edhe disa parregullsi të tjera, përfshirë ato që lidheshin me pasuritë paramartesore të M. L.

8. Kërkuesja argumentoi se shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë i paligjshëm dhe pretendoi, në terma të përgjithshëm, se ai kishte qenë joproporcional sipas nenit 8 të Konventës.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Qëllimi i çështjes

9. Pretendimet e reja të parashtruara nga kërkuesja në vitin 2024 – përfshirë ato lidhur me zbatimin me efekt prapaveprues të rregullave që kanë të bëjnë me fondet e huadhënësve dhe mungesën e parashikueshmërisë – nuk përbëjnë thjesht një shtjellim të ankesës fillestare, e cila përqendrohej në çështje të tjera dhe kryesisht në seriozitetin e parregullsive mbi të cilat u bazua shkarkimi i saj. Këto pretendime dalin jashtë qëllimit të çështjes në gjendjen e saj aktuale (shih *Kulák kundër Sllovakisë*, nr. 57748/21, § 52, 3 prill 2025).

B. Neni 8 i Konventës

1. Parashtrimet e palëve

10. Qeveria përsëriti gjetjet e KPA-së dhe argumentoi se ankesa ishte e pabazuar.

11. Kërkuesja argumentoi se ajo i kishte deklaruar huat dhe shlyerjet në të gjitha deklarimet. Sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurisë të vitit 2003, ajo ishte e detyruar vetëm të deklaronte huat dhe të dorëzonte marrëveshjet, gjë të cilën e kishte bërë. Duke qenë se në atë kohë nuk ekzistonte detyrimi për të verifikuar gjendjen financiare të huadhënësve, imponimi i kësaj kërkese nga organet e rivlerësimit kalimtar (*vetting*-ut) kishte krijuar një barrë të paarsyeshme për të. Në çdo rast, kërkuesja kishte paraqitur prova që demonstronin, në një masë të arsyeshme dhe të mjaftueshme, kapacitetin financiar të huadhënësve. Organet e rivlerësimit kalimtar kishin anashkaluar xhiron e konsiderueshme të gjeneruar nga bizneset e tyre dhe nuk kishin kryer një vlerësim gjithëpërfshirës të pasurive të paluajtshme dhe kursimeve të tyre. Disa të dhëna, si ato që lidheshin me A. M., i cili kishte ndërruar jetë në vitin 2013, kishin qenë të pamundura për t'u siguruar prej saj dhe pa rëndësi për integritetin e saj financiar (shih paragrafin 4(c) më lart).

12. Kërkuesja argumentoi se nuk e kishte deklaruar huan nga A. L. në deklarimin e vitit 2009 për shkak të udhëzimeve të paqarta lidhur me huat familjare (shih paragrafin 4(b) më sipër). Pasi ILDKPKI-ja kishte vënë në dukje atë mosdeklarim,

kërkuesja e kishte deklaruar huan në të gjitha deklarimet pasuese. Fakti që bashkëshorti i saj dhe vëllai i tij e kishin formalizuar huan vetëm në vitin 2010 nuk e bënte atë fiktive. Huat familjare nuk kërkonin marrëveshje me shkrim dhe ata e kishin formalizuar atë për të siguruar përputhshmëri të plotë me ligjin. Organet e rivlerësimit kalimtar i kishin përdorur në mënyrë arbitrare përpjekjet e saj për transparencë kundër saj dhe kishin konstatuar një bilanc negativ për vitin 2009.

13. Raportet e punës konfirmonin se M. L. kishte financuar punimet e ndërtimit të apartamentit të vitit 2009 (shih paragrafin 4(d) më sipër). Çmimi ishte ulur me qëllim shpërblimin e tij dhe si kompensim kontraktual për vonesat. Masa e saktë e asaj uljeje ishte bërë e qartë vetëm në momentin e dorëzimit përfundimtar në vitin 2016. Kështu, kishte qenë e pajustifikuar të kërkohej nga kërkuesja që të deklaronte uljet vjetore të detyrimit të pashlyer bazuar në ecurinë e punimeve të ndërtimit. Ajo kishte dorëzuar raporte të ecurisë së punimeve për periudhën 2010–2015, të cilat dokumentonin punën e kryer, si dhe deklaratën e lëshuar nga kompania, e cila dokumentonte uljen e çmimit.

14. Mospërputhja e pretenduar midis kontratës së blerjes për apartamentin e dytë në vitin 2016 dhe deklaratës së atij viti ishte e pabazuar: çmimi ishte paguar pjesërisht me paradhënie dhe pjesërisht në momentin e nënshkrimit të kontratës, dhe të gjitha pagesat ishin shlyer brenda atij viti (shih paragrafin 5 më sipër). Për këtë arsye, në deklaratë ishte pasqyruar saktë se pagesa ishte shlyer plotësisht në vitin 2016, ndërsa formulari i deklarimit nuk kërkonte që ajo të specifikonte këstet. Organet e rivlerësimit kalimtar nuk kishin shpjeguar se si ndikonte në përshtatshmërinë e saj për detyrën gjyqësore diferenca midis çmimit të blerjes dhe shumës që shitësit kishin paguar fillimisht. Prona ishte blerë në tregun e lirë, ku çmimet varionin për arsye të ndryshme, përfshirë urgjencën e shitësve për të shitur, siç ndodhi në këtë rast.

15. Gjetjet dhe përfundimet e tjera të KPA-së (shih paragrafët 6–7 më sipër) nuk e justifikonin shkarkimin e kërkueses nga detyra.

2. Vlerësimi i Gjykatës

16. Shkarkimi i kërkueses nga detyra përbënte ndërhyrje në të drejtën e saj për respektimin e jetës private dhe cenonte nenin 8 të Konventës, nëse nuk do të justifikohej si masë, në përputhje me ligjin dhe e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim (shih *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, §§ 135 dhe 137, 4 korrik 2023).

17. Gjykata fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e kërkueses, lidhur me gjetjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për huat e konsiderueshme, uljen e pretenduar të çmimit për apartamentin e vitit 2009 dhe transaksionet me automjete.

18. Argumentet e kërkueses, me të cilat ajo kundërshton ligjshmërinë e shkarkimit të saj nga detyra, për aq sa ai bazohej në këto gjetje dhe konteston qëllimet legjitime, janë të ngjashme me ato që Gjykata i ka rrëzuar në një kontekst të ngjashëm (shih *Thanza*, cituar më lart, §§ 141–47, me referenca të mëtejshme). Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të mbajtur një qëndrim të ndryshëm.

19. Mbetet për t'u përcaktuar nëse ndërhyrja ishte proporcionale. Së pari, kërkuesja pretendoi se kishte mangësi procedurale, lidhur me gjetjet e lartpërmendura, duke iu referuar nenit 6 të Konventës. Këto pretendime u shpallën të papranueshme në kohën e komunikimit të kësaj kërkese. Në vitin 2024, kërkuesja i përsëriti të njëjtat pretendime në mbështetje të nenit 8. Gjykata më parë nuk konstatoi mangësi serioze në procesin vendimmarrës përmes të cilit ishte arritur në këto gjetje në nivel kombëtar dhe nuk sheh asnjë arsye për të arritur në një përfundim të ndryshëm, lidhur me pranueshmërinë e atyre pretendimeve sipas nenit 8 (krahasoni *Thanza*, cituar më lart, § 158). Së dyti, kërkuesja kundërshtoi si arbitrare gjetjet dhe interpretimin e ligjit të brendshëm nga ana e KPA-së. Këto pretendime nuk tregojnë asnjë shenjë arbitrariteti ose nuk manifestojnë paarsyeshmëri (shih Yüksel *Yalçınkaya kundër Turqisë* [DHM], nr. 15669/20, § 304 *in fine*, 26 shtator 2023). Prandaj, Gjykata do ta shqyrtojë pretendimin fillestar për mungesë proporcionaliteti mbi bazën e fakteve, ashtu siç këto fakte janë konstatuar dhe vlerësuar në nivel kombëtar.

20. Mosrespektime të caktuara nga ana e zyrtarëve publikë të detyrimeve që lidhen me deklarimin e pasurisë mund të konsiderohet përgjithësisht serioze (shih *Thanza*, të cituar më lart, § 153). Kjo mund të përfshijë pamundësinë për të justifikuar blerje të mëdha përmes kursimeve ose burimeve legjitime dhe të mjaftueshme që disponoheshin në kohën e blerjes, ose pamundësinë për të justifikuar një stil jetese të tepruar apo shpenzime ekstravagante që tejkalojnë qartazi të

ardhurat e ligjshme të deklaruara të zyrtarit përkatës dhe familjes së tij ose të saj. Mund të jetë e ligjshme të merren parasysh të ardhurat dhe deklarimet e bashkëshortit/es së zyrtarit (po aty).

21. Për sa u përket huave, Gjykata vlerëson se kërkesa për të provuar besueshmërinë e një huaje të konsiderueshme dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të huadhënësit të përdorura për atë hua është, në parim, në përputhje me funksionimin efektiv të mekanizmave të rivlerësimit kalimtar (*vetting*-ut), duke kundërshtuar përdorimin e huave fiktive për të "pastruar" pasurinë e pashpjeguar të zyrtarëve publikë ose të familjeve të tyre. Transaksione të tilla mund të ngrenë, gjithashtu, çështje të konfliktit të interesit ose përfitime të tjera të paligjshme të marra nga një gjyqtar. Megjithatë, zbatimi i kësaj kërkese nuk duhet të krijojë një barrë të tepruar ose joproporcionale dhe duhet të vendosë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të ankuesit. Individi duhet të ketë një mundësi efektive dhe reale për të provuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të përdorura, dhe kërkesat lidhur me provat duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh, ndër të tjera, kalimin e kohës dhe kontekstin social e ekonomik në të cilin ato kanë ndodhur (krahasoni *Thanza*, cituar më lart, §§ 155–56, dhe *Gogitidze dhe të Tjerë kundër Gjeorgjisë*, nr. 36862/05, §§ 99–115, 12 maj 2015).

22. Gjatë procedurave të rivlerësimit, kërkuesja iu referua huave nga A. M. dhe A. L. si burime financimi për apartamentin e parë të blerë në Tiranë, në vitin 2009. Ajo iu referua, gjithashtu, një huaje nga L. S. si burimi i vetëm i financimit për një apartament tjetër në vitin 2016, pra në një kohë kur legjislacioni i rivlerësimit, që kërkonte justifikimin e burimeve të huadhënësve, kishte hyrë tashmë në fuqi. A. L. dhe L. S. treguan burime specifike për shumat e huazuara kërkueses (shih paragrafët 4(b) dhe 5 më lart). Nuk rezulton që ajo të ketë provuar para organeve të rivlerësimit se e kishte të pamundur të siguronte informacione ose dokumente vendimtare, lidhur me burimet specifike të këtyre huadhënësve. A. L. dhe L. S. duket se kanë bashkëpunuar plotësisht me kërkuesen, duke vënë në dispozicion prova për origjinën e huave. Dokumentacioni i tyre personal dhe ai përkatës i shoqërive duket se ka qenë i aksesueshëm për të. Për sa i përket të ndjerit A. M., kërkuesja nuk ka specifikuar se cila provë thelbësore ishte e padisponueshme si pasojë e vdekjes së tij në vitin 2013, veçanërisht duke pasur parasysh se KPK-ja kishte siguruar dhe verifikuar të dhënat e tij bankare (shih paragrafin 4(c) më lart). Për këtë arsye, nuk është vërtetuar se, në rrethanat specifike të çështjes në fjalë, kërkuesja është ngarkuar me një barrë të pamundur për të provuar kapacitetin e huadhënësve për të dhënë hua (shih *Thanza*, cituar më lart, § 156). Mjaftueshmëria e të ardhurave të disponueshme të huadhënësve nuk u konfirmua për një pjesë të konsiderueshme të fondeve të huazuara kërkueses.

23. Në arritjen e këtij përfundimi, KPA-ja iu referua, gjithashtu, faktorëve të tjerë që kishin cenuar besueshmërinë e huave. Në veçanti, asnjë hua nga A. L. nuk ishte deklaruar në deklaratat e pasurisë së kërkueses të bëra në kohën përkatëse, qoftë si burim për apartamentin e parë apo si detyrim financiar (shih *Xhoxhaj*, cituar më lart, § 202), e as në deklarimet e vetë A. L.-së sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurive (shih paragrafin 4(b) më lart). Pretendimet e kërkueses lidhur me shlyerjen e huas nga A. M., përfshirë përmes një huaje në para në dorë nga K. S., ishin jo konsistente ose të pambështetura në prova (shih paragrafët 4(c) dhe 6 më lart).

24. Duke pasur parasysh problemet serioze me kredi të shumta të konsiderueshme që pretendohet se kanë financuar pronën martesore (shih paragrafin 3 më sipër), vendimi i KPA-së për të shkarkuar kërkuesen mbi këtë bazë nuk ishte disproporcional (shih, gjithashtu, *Nikëhasani kundër Shqipërisë*, nr. 58997/18, § 123, 13 dhjetor 2022).

25. Gjithashtu, KPA-ja shqyrtoi rregullisht argumentet e kërkueses, në lidhje me uljen e pretenduar prej 25,664 eurosh dhe dokumentet e paraqitura prej saj. Të marrë së bashku, faktorët e përcaktuar nga KPA-ja për periudhën deri në fund të vitit 2016 tregojnë, të paktën, mosdokumentimin e duhur nga ana e saj të një pjese të madhe të asaj shume (shih paragrafin 4(a) dhe (d) më sipër).

26. Së fundmi, transaksionet e makinave ishin të tilla që ngritën pyetje serioze, në lidhje me korrektësinë financiare në marrëdhëniet private brenda familjes së kërkueses (shih paragrafët 3 dhe 6 më sipër).

27. Në rastin kur gjykatat vendase i kanë shqyrtuar me kujdes faktet, i kanë zbatuar standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, në përputhje me Konventën dhe praktikën gjyqësore të saj, si dhe kanë balancuar në mënyrë të përshtatshme interesat

individualë me interesin publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj me atë të gjykatave vendase (shih *Danileţ kundër Rumanisë* [DHM], nr. 16915/21, § 168, 15 dhjetor 2025). Duke marrë parasysh gjetjet në paragrafët 9 dhe 19 më sipër, parregullsitë e përmendura dhe pozicionin e ankueses si gjyqtare dhe kryetare e një gjykate apeli – ku prej saj pritej të përmbushte standarde të larta integriteti dhe ndershmërie në administrimin e çështjeve të saj financiare personale dhe atyre të familjes së saj (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 407 *in fine*) – Gjykata nuk sheh asnjë arsye për t'u distancuar nga përfundimet e KPA-së, lidhur me pasuritë e përmendura më sipër dhe, në mënyrë më të përgjithshme, me rezultatin e çështjes së rivlerësimit (shih, në të kundërt, *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 93 dhe 96, 13 dhjetor 2022). Rrjedhimisht, Gjykata nuk konstaton se shkarkimi i saj nga detyra ishte joproporcional.

28. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme të kryhet një shqyrtim i hollësishëm i argumenteve të ankueses, lidhur me gjetjet dhe përfundimet e tjera të KPA-së (krahasoni *Thanza*, cituar më sipër, § 160).

29. Rrjedhimisht, ankesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 korrik 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Diana Kovatcheva
KRYETARE

URDHËR
Nr. 469, datë 9.8.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar; të pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; të urdhrit nr. 3, datë 11.1.2022, "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Komisionit të Prokurimit Publik, z. Josi Ballauri, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 3.8.2026 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në Buletinin e Njoftimeve Publike.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ismail Shehu

VENDIM
Nr. 130, datë 30.7.2026

"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 380, DATË 30.11.2023, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË DREJTUESVE TË PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM", TË KËSHILLIT"

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 68 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 159, pika 2, germat "a" dhe "e", 164, 166, 189, pika 1, germa "c" dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në relacionin nr. 2894, datë 30.7.2026, të grupit të punës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 380, datë 30.11.2023, "Për miratimin e rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesve të prokurorive të

juridiksionit të përgjithshëm", të Këshillit, bëhen ndryshimet si vijon:

Neni 1

Në aneksin nr. 5 bëhen ndryshimet sipas aneksit të propozuar, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 2

Në aneksin nr. 6 bëhen ndryshimet sipas aneksit të propozuar, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 3

Në aneksin nr. 7 bëhen ndryshimet sipas aneksit të propozuar, bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 4

Në nenin 28, pas pikës 3, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje :

"4. Ndryshimet e përcaktuara në këtë vendim nuk zbatohen për vlerësimin e drejtuesve të zyrave të prokurorive, për të cilët është përfunduar raporti analitik dhe projektraporti i vlerësimit."

II. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 30.7.2026.

KRYETAR
Mirela Bogdani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE

ANEKSI NR.5

PARAQITJA E AKTEVE TË DREJTUESIT TË PROKURORISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË DREJTUESE

A. Aftësitë drejtuese dhe organizatave

1. Mirëorganizimi i prokurorisë në seksione

a. Rregullore, urdhra dhe udhëzime të brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.

b. Urdhër për ndarjen në seksione të prokurorëve.

c. Urdhër për organizimin dhe funksionimin e shpërndarjes së çështjeve me short, përjashtimet e shortit, monitorimin e ngarkesës.

d. Urdhër/akt nënligjor për monitorimin e sistemeve elektronike Presto, SVHOPGJ etj.

e. Akt nënligjor për organizimin dhe funksionimin e administratës së prokurorisë, si edhe mbikëqyrjen periodike.

f. Urdhër/akt nënligjor për aspektet procedurale-administrative të funksionimit të seksionit të policisë gjyqësore brenda prokurorisë.

g. Urdhër për mënyrën e përcaktimit në seksione të prokurorisë të oficerëve të policisë gjyqësore.

h. Urdhër/akt nënligjor për bashkërendimin dhe bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore, si edhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tyre.

i. Informacione mbi veprimtarinë dhe etikën e oficerit të policisë gjyqësore, evidentimi i shkeljeve të mundshme me natyrë disiplinore.

j. Urdhër/akt nënligjor mbi mënyrën e trajtimit të ankesave të paraqitura nga personat fizikë ose jurdikë lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së prokurorisë.

k. Udhëzime të brendshme/akte nënligjore për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

l. Udhëzime të përgjithshme për çështje të natyrës administrative.

m. Udhëzime për çështje konkrete për prokurorët (për çështje konkrete, jo të detyrueshme).

n. Udhëzime të brendshme për zbatimin e planit të veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve prioritare.

o. Kërkesa për informacion për ecurinë e procedimeve në hetim apo gjykim, si edhe për ato me objekt vepra penale sipas rekomandimeve prioritare (për çështje konkrete ose grup çështjesh).

p. Raportet e analizave vjetore.

q. Udhëzim/Akt nënligjor për përcaktimin e detyrave funksionale të zv/drejtuesit të prokurorisë dhe drejtuesit të seksionit.

r. Udhëzim/Akt nënligjor mbi aspektet procedurale-administrative për realizimin e analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit.

s. Udhëzim/Akt nënligjor mbi trajtimin e aspekteve procedurale-administrative të trajtimit të rasteve me persona viktima, të dhunës mbi bazë gjinore, urrejtje, trafikimit, seksuale etj.

t. Protokolle dhe strategji për trajtimin e rasteve me persona viktima, të dhunës mbi bazë gjinore, urrejtje, trafikimit, seksuale etj, nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional etj.

u. Udhëzim/akte nënligjore për normimin e aspekteve procedurale-administrative për fillimin e hetimit kryesisht nga prokurori apo drejtuesi i prokurorisë.

2. Planifikimi i prokurorëve për çështje të natyrës urgjente

a. Urdhër/Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative-procedurale të gatishmërisë në prokurori.

b. Urdhër/Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative-procedurale të gatishmërisë në prokurori në periudha para, gjatë dhe pas zgjedhjeve.

c. Kërkesa për informacione për ecurinë e procedimeve penale në fushën e zgjedhjeve (për çështje të veçanta ose grup çështjesh).

d. Udhëzime për çështje konkrete në procedimet penale me objekt veprat penale në fushën e zgjedhjeve (për çështje të veçanta).

e. Udhëzim/Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative-procedurale për krijimin e grupeve hetimore.

f. Urdhëra për grupe hetimore (për çështje të veçanta).

g. Udhëzime për çështje penale me grupe hetimore (jo të detyrueshme, për çështje konkrete).

h. Udhëzim/Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative-procedurale të bashkëpunimit të Prokurorisë me Policinë e Shtetit, Policinë Shkencore etj për çështje të natyrës urgjente.

i. Udhëzim/Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative-procedurale të bashkëpunimit të Prokurorisë me Prokurorinë e Përgjithshme, MD, KLP, Gjykatën për çështje të natyrës urgjente.

j. Strategjia e komunikimit me publikun për çështjet e natyrës urgjente.

3. Zëvendësimi në kohë i prokurorëve që kanë pengesa në proces.

a. Udhëzime/Akt nënligjor për rregullimin e aspekteve procedurale-administrative të zëvendësimit të prokurorëve.

b. Vendime për zëvendësim prokurori (pranim/refuzim kërkese për heqje dorë, kërkesë për zëvendësim nga palët, nga vetë drejtuesi) (për çështje konkrete ose grup çështjesh sipas rastit).

4. Zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët.

a. Udhëzim/Akt nënligjor për rregullimin e aspekteve administrative të zhvillimit të mbledhjeve me prokurorët.

b. Udhëzime/Akte nënligjore të marra si rrjedhojë e konkretizimit të mendimeve të shfaqura dhe gjithpranuara në mbledhjet e prokurorëve të prokurorisë.

c. Procesverbale të realizimit të mbledhjeve me prokurorët, si edhe të diskutimit të raportit vjetor të prokurorisë.

5. Planifikimi dhe përdorimi efikas i fondeve publike, sipas nevojave të prokurorisë

a. Urdhër/udhëzim/akt nënligjor që lidhet me përdorimin e fondeve publike në përdorim të prokurorisë.

b. Akt nënligjor për normimin e aspekteve administrative për rritjen e buxhetit të prokurorisë me të ardhura nga donacione dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme.

c. Akt nënligjor mbi ushtrimin e mbikëqyrjes së brendshme të veprimtarisë financiare të prokurorisë.

6. Mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë.

a. Urdhër/Udhëzim/Akt nënligjor për pasqyrimin e informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë dhe administrimin e saj.

b. Strategjia e komunikimit publik.

c. Udhëzim/Akt nënligjor lidhur me monitorimin e përmbushjes së detyrave nga personeli përgjegjës për administrimin e faqes zyrtare të prokurorisë (portali unik).

7. Mbikëqyrjen, për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut.

a. Udhëzim/Akt nënligjor mbi mënyrat e përdorimit dhe disponimit të objekteve dhe pasurisë në prokurori.

b. Udhëzim/Akt nënligjor mbi sigurimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve dhe publikut.

c. Udhëzim/Akt nënligjor për përdorimin efikas dhe ekonomizimin e shpenzimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare të prokurorisë.

d. Udhëzim/Akt nënligjor për normimin e aspekteve procedurale dhe administrative për të garantuar marrjen e kallëzimeve penale të viktimave të veprës penale apo subjekteve të tjerë të procedurës penale.

8. Kujdeset për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori.

a. Udhëzim/Urdhra/Akt nënligjor mbi masat e sigurisë në prokurori.

b. Programe apo politika mbi sigurinë në prokurori.

c. Udhëzim/Akt nënligjor mbi normimin e përgjegjësive të stafit për çështje të sigurisë në prokurori.

d. Udhëzime/Akt nënligjor mbi rregullat dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të informacionit.

e. Udhëzim/Akt nënligjor mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin e situatave të emergjencës dhe aktiviteteve qe cenojne sigurinë e prokurorisë.

f. Program auditi periodik për sigurinë në prokurori.

g. Urdhër/Akt nënligjor për përcaktimin e zonave të sigurisë dhe të koordinatorit të sigurisë.

h. Plane apo protokolle për mbrojtjen e institucionit dhe për ndërhyrjen e forcave të zbatimit të ligjit.

i. Urdhëra/Akt nënligjor për zbatimin e masave të sigurimit ndaj zjarrit.

9. Organizimi i trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.

B. Aftësitë komunikuese

1. Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi.

a. Urdhër/Akt nënligjor mbi masat administrative-procedurale që duhen marrë në kuadër të procesit të vlerësimit të prokurorëve.

b. Urdhër/Akt nënligjor mbi marrjen e masave për zbatimin e rregullave të etikës të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe të akteve të tjera nënligjore të Këshillit.

c. Akt nënligjor mbi normimin e bashkëpunimit me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës për çështje që lidhen me rritjen profesionale të prokurorëve dhe me kandidatët për magjistratë.

d. Udhëzim/Akt nënligjor për bashkërendimin e punës me Prokurorinë e Përgjithshme për çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, me drejtoritë përkatëse të prokurorisë së përgjithshme dhe komisionin e policisë gjyqësore.

e. Udhëzim/Akt nënligjor për bashkërendimin e punës me ILD-në për çështje që lidhen me hetimin disiplinor të prokurorëve.

f. Kërkesa drejtuar ILD-së për konstatimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

g. Informacione drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit.

h. Akt nënligjor mbi bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë me MD dhe PP në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike.

i. Akt nënligjor mbi koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera në fushën e hetimit të veprave penale prioritare.

j. Udhëzim/Akt nënligjor për bashkëpunimin me KLSH-në për çështje që lidhen me verifikimet financiare dhe ligjore të kryera nga KLSH-ja.

k. Udhëzime jo të detyryueshme për çështje konkrete, për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga KLSH-ja (për çështje konkrete).

l. Udhëzim/akt nënligjor mbi marrjen e masave për ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese vendase, rajonale dhe ato sipas marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe për luftimin e kriminalitetit brenda dhe jashtë vendit.

m. Komunikimet zyrtare shkresore me KLP, PP, ILD, KLSH, Gjykatën etj.

2. Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme.

a. Akt nënligjor për funksionimin e shërbimeve për marrëdhëniet me publikun dhe caktimin e prokurorit mbikëqyrës dhe koordinatorit të së drejtës për informim.

b. Akt nënligjor mbi përcaktimin e detyrave të subjekteve përgjegjës në garantimin e marrëdhënieve me publikun.

c. Akt nënligjor mbi procedurën e trajtimit të kërkesave dhe mbajtjes së kontakteve me median.

d. Plani i komunikimit publik.

e. Kodi etik për komunikimin publik.

f. Procesverbale të dokumentimit të orareve të pritjes dhe të takimeve me publikun.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE

ANEKSI NR.6

RAPORT ANALITIK PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORIT

Tiranë më __/__/_____

1. Të dhëna të përgjithshme/ të dhënat e prokurorit

Numri i protokollit			
Emër mbiemër i prokurorit			
Datëlindja			
Vendbanimi			
Adresa e e-mail-it zyrtar: Adresa e e-mail-it privat:			
Numer Kontakti			
Prokuroria: Prokuroria:			
Funksioni:			
Seksioni:			
Periudha e vlerësimit:			
Dy vlerësimet e fundit			
Përbërja e Komisionit të Vlerësimit (emri, mbiemri, nënshkrimi)	Emri, mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
	1.	Kryetar	
	2.	Anëtar	
	3.	Anëtar	
Relatori			
Këshilltari përgjegjës		Ndihmësmagjistrat	
Data e dorëzimit			

2. Burimet e Vlerësimit[5]

Burimi 1	
Burimi 2	
Burimi 3	
Burimi 4	
Burimi 5	
Burimi 6	
Burimi 7	
Burimi 8	
Burimi 9	
Burimi 10	
Burimi 11	
Burimi 12	
Burimi 13	
Burimi 14	
Burimi 15	

[5] Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 77, të Ligjit Për Statusin, të individualizuara për prokurorin për të cilin hartohet raporti analitik

3. Kriteret, treguesit, nëntreguesit dhe elementet e vlerësimit[6]

Kriteri Nr. 1 Aftësitë drejtuese dhe organizative	
Treguesi	**Mirëorganizimi i prokurorisë në seksione**
Nën/treguesi	**1.Marrja e masave për ngritjen e seksioneve, bazuar ndër të tjera, në mendimin e mbledhjes së përgjithshme, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit**
Elementët	
a)Respektimi i procedurës ligjore për ngritjen e seksioneve dhe caktimin e drejtuesve të tyre. ***b)Përcaktimi i prokurorëve në seksion në përshtatje me specializimet e tyre.*** ***c)Patundshmëria e lëvizjes nga seksioni*** Koment: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)*	
Nën/treguesi	**2.Organizimi i punës dhe marrja e masave të nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë në tërësi, duke respektuar me rigorozitet parashikimet ligjore, duke siguruar paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë**
Elementët	
a)Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin e punës dhe funksionimin e prokurorisë në tërësi ***b)Miratimi i rregulloreve, urdhrave, udhëzimeve të brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë*** ***c)Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton*** Koment: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)*	
Nën/treguesi	**3.Organizimi i shpërndarjes së çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, në përputhje me ligjin, si dhe sigurimi i përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori**
Elementët	
a)*Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për shpërndarjen e çështjeve me short prokurorëve* ***b)Normimi i aspekteve procedurale për organizimin dhe funksionimin e shpërndarjes së çështjeve me short, duke përcaktuar personat kompetent (përshkruar detyrat e secilit prej tyre) dhe procedurën që ndiqet*** ***c)Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë*** ***d)Marrja e masave për të siguruar përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke bashkërenduar me Prokurorinë e Përgjithshme*** ***e)Përdorimi në çdo rast i shortit elektronik dhe vetëm në raste përjashtimore të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore atë manual*** ***f)Zbatimi i këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore edhe në rastin e ushtrimit të ndjekjes penale nga drejtuesi i prokurorisë*** ***g)Marrja e masave administrative për monitorimin e përditësimit të sistemeve elektronike PRESTO dhe SVHOPGJ, saktësisë së të dhënave*** Koment: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi*	

[6] Raporti analitik përmban listën e akteve të mbledhura gjatë procesit të vlerësimit, si dhe analizën e detajuar dhe të strukturuar të të dhënave të përftuara nga aktet e dosjes së vlerësimit, ***të cilat evidentojnë mosplotësimin e ndonjë treguesi të vlerësimit, nëntreguesi ose elementi përbërës të tyre.***

-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)	
Nën/treguesi	**4.Mbikëqyrja dhe sigurimi i organizimit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë, përpilimi i projekt-vendimit të vlerësimit, projekt-raportit të vlerësimit, së bashku me vetëvlerësimin, si dhe marrja e mendimit me shkrim të të gjithë mbikëqyrësve për vlerësimin e nëpunësve civilë**
Elementët	
a)Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të administratës së prokurorisë ***b)Normimi i aspekteve procedurale për organizimin dhe funksionimin e administratës, duke përcaktuar personat kompetentë, përshkruar detyrat e secilit prej tyre dhe procedurën që ndiqet, dhe mënyrën e bashkëpunimit të sektorëve me njëri-tjetrin*** ***c)Normimi i aspekteve procedurale të mbikëqyrjes periodikisht, duke përcaktuar personat kompetentë, detyrat e tyre, mënyrën e mbikëqyrjes dhe adresimin, zgjidhja e problematikave të konstatuara, si dhe vlerësimi i performancës së tyre me objektivitet*** Koment: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)*	
Nën/treguesi	**5. Drejtimi, bashkërendimi, mbikëqyrja dhe sigurimi i veprimtarisë së policisë gjyqësore, dhënia e urdhrave të detyrueshëm lidhur me ushtrimin e funksioneve dhe përpilimi i raportit të vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore**
Elementët	
a)Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori ***b)Normimi i aspekteve procedurale-administrative të ushtrimit të veprimtarisë së seksionit të policisë gjyqësore*** ***c)Respektimi i procedurës ligjore për caktimin e tyre në seksione në përshtatje me specializimet e tyre, si dhe patundshmëria e lëvizjes nga seksioni*** ***d)Shpërndarja e ngarkesës në mënyrë të barabartë*** ***e)Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit, si dhe shërbimeve të tjera të policisë gjyqësore*** ***f)Marrja e masave për mbikëqyrjen periodike të ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, adresimi dhe zgjidhja e problematikave, si dhe vlerësimi i performancës së tyre me objektivitet*** ***g)Marrja e informacionit për veprimtarinë dhe etikën e oficerit të policisë gjyqësore, si dhe të dhëna statistikore për volumin e punës, shpejtësinë, cilësinë e akteve dhe problematikat e konstatuara në kryerjen e hetimeve*** Koment: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)*	
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**19. Bashkërendimi dhe koordinimi me efiçencë i veprimtarisë me prokuroritë e tjera, me iniciativë ose kur kërkohet në drejtimet/ fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave organizative, procedurale për të siguruar bashkëpunimin me prokuroritë e tjera (normime procedurale- administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); ***b) Planifikimi i takimeve periodike për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre***		
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**20. Marrja e masave për shkëmbimin e ndërsjellët të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masa organizative, procedurale për të siguruar shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit me Kontrollin e Lartë të Shtetit (normime procedurale- administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); ***b) Evidentimi i problematikave dhe masat për zgjidhjen e tyre***		

Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**21. Organizimi dhe bashkëpunimi i trajnimeve të përbashkëta dhe takimeve periodike ndërmjet KLSH-së dhe prokurorisë**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave për të organizuar trajnime të përbashkëta me KLSH-në; ***b) Planifikimi i punës për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve në trajnime***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**22. Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme, *dhe* ose *jo* të detyrueshme për çështje konkrete, për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga KLSH- ja**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Nxjerrja e udhëzimeve procedurale penale apo lidhur me zbatimin e ligjit penal material e qëllim unifikimin e praktikave brenda prokurorisë, ndjekja e zhvillimeve të legjislacionit apo jurisprudencës apo aplikimi i praktikave më të mira; ***b) Nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme me shkrim, të arsyetuara, të qarta për çështje konkrete. Ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe efektiviteti i tyre***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**23. Bashkëpunimi në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të organizojnë dhe zhvillojnë analiza të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave organizative dhe procedurale për të siguruar bashkëpunimin në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër		

veprave penale prrioritare të rekomanduara (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); ***b) Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj për të identifikuar problematikat dhe zgjidhjen e tyre***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**24. Marrja e masave për përmirësimin më tej të eficençës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë ne Eurjust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të brenda dhe jashtë vendit**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave për përmirësimin më tej të eficençës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional (normime procedurale-administrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); ***b) Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave për të identifikuar problematikat dhe zgjidhjen e tyre***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**25. Të marrë masa për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore(normime proceduriale admnistrative, caktimi i personave përgjegjës, monitorimi i tyre); ***b) Planifikimi i takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta ndërinstitucionale, për të evidentuar problematikat dhe për zgjidhjen e tyre***		

Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*

Vlerësimi i treguesit "Bashkëpunimi efektiv dhe në kohë me Këshillin, ILD, MD, KLSH ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi"

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	*Nr. i pikëve*	*Pikët e mbledhura*
Nën mesatare	*8-14*	
Mesatare	*15-22*	
Mbi mesatare	*23-30*	

Treguesi	**B.Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-20** **Pikët:**
Nëntreguesi	**1. Marrja e masave për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve për marrëdhëniet me publikun, të cilat kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-3** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave organizative, procedurale, administrative për funksionimin e shërbimet për marrëdhëniet me publikun; ***b) Respektimi i parashikimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin e shërbimeve;*** ***c) Caktimi i prokurorit dhe nëpunësit civil për marrëdhëniet me publikun duke u bazuar tek specializimet e tij;*** ***d) Mbarëvajtja e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin e shërbimeve;*** ***e) Marrja e masave organizative për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Evidentimin e rasteve të shkeljes së sekretit hetimor dhe marrja e masave te duhura ligjore.***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**2. Monitorimi i veprimtarisë së prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun për të**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2**

	garantuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit të marrëdhënieve me publikun	**Pikët:**
Elementët		
a) Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga prokurori për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; ***b) Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave dhe personave të tjerë të interesuar, që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale, ose lidhur me një proces që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie;*** ***c) Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës së prokurorisë;*** ***d) Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet, prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut;*** ***e) Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.***		
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**3. Marrja e masave administrative-procedurale për të garantuar që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2** **Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave për krijimin, mbajtjen dhe bërjen publike të një regjistri të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre; ***b) Përditësimi i tij çdo 3 muaj dhe publikimin në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe në mjediset e pritjes së publikut të prokurorisë;*** ***c) Marrja e masave për të garantuar se dhënia e informacionit kryhet duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë;*** ***d) Marrja e masave shtesë për të parandaluar zbulimin e paligjshëm, shkatërrimin dhe humbjen si në institucionin e prokurorisë, ashtu edhe gjatë transferimit të tyre, për të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale, të cilat përmbajnë të dhëna personale;*** ***e) Marrja e masave shtesë për të garantuar që në rastet e transferimit automatik të dhënave personale, rrugët e transmetimit, ose dokumentet që përmbajnë këto të dhëna duhen koduar, duke përdorur mënyra dhe fuqi koduese në përputhje me rezultatin e vlerësimit të rreziqeve të kryera paraprakisht).***		
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		

Nëntreguesi	**4. Monitorimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit me marrëdhëniet me publikun nga nëpunësi civil në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit".**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2 Pikët:**
Elementët		
a) Normimi i aspekteve procedurale për ushtrimin e detyrave nga nëpunësi civil për marrëdhëniet me publikun, në drejtim të detyrave të ngarkuara dhe përmbushjes së tyre; ***b) Monitorimi i kthimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve të mediave dhe personave të tjerë të interesuar, që ka filluar, është duke u zhvilluar, apo ka përfunduar pranë kësaj prokurorie;*** ***c) Monitorimi i reagimit kur në media, apo në publik është përhapur një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz, që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të prokurorisë, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, të punonjësve të administratës të prokurorisë.*** ***d) Mbikëqyrja e bashkëpunimit ndërmjet nëpunësit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe prokurorit të çështjes, i cili duhet të jetë i ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor, që t'i ofrojnë informacionin e kërkuar publikut.*** ***e) Planifikimi i takimeve periodike, evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.***		
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**5. Marrja e masave organizative-administrative, si dhe mbikëqyrja e procedurës së brendshme të pranimit dhe trajtimit të kërkesave dhe mbajtjes së kontakteve me median.**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2 Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave organizative dhe administrative për rregullimin e procedurës së brendshme për trajtimin e kërkesave; ***b) Marrja e masave organizative për mbajtjen e kontakteve me median.*** ***c) Mbikëqyrja e procedurës së brendshme në mënyrë periodike:*** ***d) Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre*** ***e) Cilësia e vendimmarrjeve për refuzimin e dhënies së informacionit***		
<u>Komenti i relatorit dhe pikëzimi:</u> *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**6. Hartimi dhe dërgimi për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave, raporteve dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1 Pikët:**
Elementët		
a) Qëndrimi aktiv në hartimin dhe dërgimin për media i komunikatave, sqarimeve, reagimeve, deklaratave raporteve dhe i publikimeve të shtypura dhe elektronike;		

b) Aftësia për të hartuar komunikatat, sqarimet, deklaratat dhe aktet e tjera të publikuara. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria. Përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës;
c) Aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë. Zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës.
d) Përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë);
e) Impakti publik i krijuar nga këto komunikime.

Komenti i relatorit dhe pikëzimi:

-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)
-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)
Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.

Nëntreguesi	**7. Organizimi i konferencave per media, debateve, apo prezantimeve audiovizive publike, si dhe menaxhimi i vazhdueshëm i adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave.**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-1 Pikët:**
Elementët		

a) Qëndrimi aktiv në organizimin e konferencave për media, debateve apo prezantimeve audiovizive publike:
b) Aftësia e prezantimit publik dhe niveli i argumentimit gjatë diskutimit, mënyra e moderimit të diskutimit.
c) Impakti publik i krijuar nga këto komunikime;
d) Marrja e masave për menaxhimin e vazhdueshëm të adresave elektronike zyrtare, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mediave;
e) Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, me marrjen e një ankese nga persona fizik ose juridik ose një informacion i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi i funksioneve në struktura të tjera, si dhe ndjekja proceduriale sipas detyrave funksionale të parashikuara

Komenti i relatorit dhe pikëzimi:

-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)
-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)
Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.

Nëntreguesi	**8. Hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit publik dhe monitorimi i mediave**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2 Pikët:**
Elementët		

a) Marrja e masave për hartimin e planit të komunikimit publik;
b) Marrja e masave për zbatimin e planit të komunikimit publik;
c) Marrja e masave organizative dhe proceduriale për monitorimin e mediave;
d) Problematikat e evidentuara gjate monitorimit dhe zgjidhja e tyre;
e) Marrja e masave për përmisimin dhe përditësimin e planit të komunikimit publik dhe monitorimit të mediave

Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**9. Marrja e masave administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve os etë shkresave për tu përgjigjur instuticioneve të ndryshme.**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-2 Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave konkrete për administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokuror, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve; ***b) Marrja e masave për ndjekjen dhe zgjidhjen e problematikave të evidentuara gjatë takimeve;*** ***c) Marrja e masave për strukturimin e monitorimit, kthimit të përgjigjes ndaj shkresave të instuticionev etë ndryshme;*** ***d) Marrja e masave organizative për realizimin e mbykqyerjes periodike të kthimit të përgjigjeve;*** ***e) Evidentimi i problematiokave dhe zgjidhja e tyre***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		
Nëntreguesi	**10. Hartimi i udhëzuesve, kodi etik për komunikimin publik**	**Shkalla e pikëzimit/pikë 0-3 Pikët:**
Elementët		
a) Marrja e masave për hartimin e udhëzuesve për komunikimin publik; ***b) Marrja e masave për hartimin e kodit etik për komunikimin publik;*** ***c) Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës;*** ***d) Monitorimi i zbatimit dhe përmirsimi i tyre;*** ***e) Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre***		
Komenti i relatorit dhe pikëzimi: *-Drejtuesi i Prokurorisë i ka plotësuar elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego vetëm nëse mbahet qendrim tjetër nga të dhënat e raportit analitik që tregojnë mosplotësim apo plotësim pjesërisht të elementëve të këtij nëntreguesi)* *-Drejtuesi i Prokurorisë nuk i ka plotësuar/ i ka plotësuar pjesërisht elementët e këtij nëntreguesi (Shpjego)* *Për sa më lart, drejtuesi i prokurorisë vlerësohet me _____ pikë.*		

Vlerësimi i treguesit "Komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme"

Shkalla e aftësisë së drejtuesit	*Nr. i pikëve*	*Pikët e mbledhura*
Nën mesatare	*5-9*	
Mesatare	*10-14*	
Mbi mesatare	*15-20*	

SHKALLA E AFTËSISË SË DREJTUESIT KRITERI II DHE PIKËT E MBLEDHURA

SHKALLA E AFTËSISË SË DREJTUESIT KRITERI II	NR. I PIKËVE	PIKËT E MBLEDHURA
NËN MESATARE	13-24	
MESATARE	25-37	
MBI MESATARE	38-50	

4. Propozim për nivelin e vlerësimit

Numri i pikëve të grumbulluara; shkalla e aftësisë/cilësisë për secilin kriter; niveli i vlerësimit	**KRITERI NR 1** **Pikëzimi:** **Shkalla e aftësisë:** **Niveli:**	**KRITERI NR 2** **Pikëzimi:** **Shkalla e aftësisë:** **Niveli:**
VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR QË PROPOZOHET	**NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**	

5. Propozime dhe rekomandime

PROPOZIME	*REKOMANDIME*

RELATORI

VENDIM
Nr. 131, datë 30.7.2026

"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 95, DATË 9.5.2022 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORËVE", I NDRYSHUAR", TË KËSHILLIT"

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 68 dhe vijues, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenet 159, 184, germa "dh", 189, pika 1, germa "c" dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në Relacionin nr. 2911, datë 30.7.2026, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, "Për miratimin e rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", i ndryshuar, të Këshillit, bëhen ndryshimet si vijon:

Neni 1

Në nenin 23, pika 2, në fjalinë e parë, pas fjalëve … *administrata e prokurorisë*, shtohen fjalët:

", në përputhje me manualin për zhvillimin e shortit elektronik, sipas Aneksit nr. 1/1 bashkëlidhur kësaj rregullore."

Neni 2

Në nenin 23, pika 3, ndryshon si më poshtë:

"Shorti zhvillohet në prokurorinë ku prokurori subjekt vlerësimi ka ushtruar më gjatë detyrën, gjatë periudhës së vlerësimit. Realizimi i shortit kryhet nga prokuroria përkatëse, sipas pikës së dytë të kësaj dispozite, ndërsa pjesëmarrja e subjekteve dhe e personave të tjerë në procedurë mund të sigurohet fizikisht në prokurorinë përkatëse ose online nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që garantojnë komunikim audio dhe video në kohë reale."

Neni 3

Në nenin 23, pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1 Nëse përzgjedhja me short e dosjeve përfshin më shumë se një prokurori, për shkak se prokurori subjekt vlerësimi ka ushtruar detyrën në dy ose më shumë prokurori gjatë periudhës së vlerësimit, prokuroria ku zhvillohet shorti koordinon paraprakisht dhe bashkëpunon me prokuroritë e tjera përkatëse për sigurimin dhe vënien në dispozicion të tabelave me të dhënat statistikore të nevojshme për zhvillimin e shortit.

Pavarësisht nëse shorti realizohet në mënyrë elektronike ose manuale, kur pjesëmarrja në procedurë sigurohet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, çdo prokurori ku prokurori subjekt vlerësimi ka ushtruar funksionin gjatë periudhës së vlerësimit siguron pjesëmarrjen online të personit ose personave përgjegjës për ndjekjen e procedurës së shortit."

Neni 4

1. Në nenin 4, pas fjalëve "në praninë e detyrueshme" shtohen fjalët:

"*sipas përcaktimeve të pikës 3 të kësaj dispozite*"

2. Në nenin 4, pas fjalëve "kanë të drejtë të marrin pjesë" shtohen fjalët:

"*sipas përcaktimeve të pikës 3 të kësaj dispozite*"

Neni 5

Në nenin 23, pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

"7/1 Në rastin e zhvillimit të shortit në formë elektronike, personat përgjegjës në prokurorinë ku realizohet shorti përgatisin dhe përshtatin tabelat statistikore që do të përdoren për shortin, në përputhje me përcaktimet e vendimit të relatorit për përzgjedhjen me short të dosjeve.".

Neni 6

1. Në nenin 31, pika 2, pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

"*Për pjesëmarrësit që marrin pjesë online përmes mjeteve të komunikimit elektronik përbri emrit dhe mbiemrit të tyre shënohet* (***konfirmohet online***)".

2. Në nenin 31, pas fjalisë së fundit shtohen fjalitë:

"*Në rastin e zhvillimit të shortit në formë elektronike dhe me pjesëmarrje online të pjesëmarrësve, administrata përgjegjëse për IT në Këshill, merr masat për lehtësimin,*

mbikëqyrjen dhe regjistrimin e procedurës së shortit me mjete e pajisje elektronike. Ky regjistrim i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur sipas kësaj pike dhe administrohet në dosjen e vlerësimit të prokurorit/es".

Neni 7

Pas aneksit nr. 1, shtohet një aneks me nr. 1/1, i titulluar "*Manual për zhvillimin e shortit elektronik",* bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 8

Aneksi nr. 4 "*Procesverbal për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit*", ndryshohet sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 9

Në nenin 41, pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Normat e ndryshuara të kësaj rregulloreje që mundësojnë zbatimin e përzgjedhjes me short në formë elektronike dhe pjesëmarrjen online të pjesëmarrësve në short, do të zbatohen për të gjitha procedurat e vlerësimit etik e profesional për të cilat nuk është kryer ende procesi i përzgjedhjes me short të çështjeve."

II. Ky vendim hyn në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 30.7.2026.

KRYETAR
Mirela Bogdani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE

ANEKSI nr. 4

PROCESVERBAL

PËR PASQYRIMIN E VEPRIMEVE QË KRYHEN GJATË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORIT _____ *(emri/mbiemri i prokurorit)*

Sot, më datë ___.___.____, ora ___.___, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar të gjitha veprimet që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit _____. Procedura e përzgjedhjes me short të çështjeve zhvillohet në formë *elektronike/manuale.*

Në procedurën e përzgjedhjes së çështjeve me short marrin pjesë:

Z/Znj._____ - Këshilltar përgjegjës për vlerësimin pranë Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë; *(Pjesëmarrje fizike/online)*

Z/Znj._____ - Kryesekretar/Kancelar i Prokurorisë; *(Pjesëmarrje fizike)*

Z/Znj._____ - Sekretare në Prokurori; *(Pjesëmarrje fizike)*

Z/Znj._____ - Punonjës përgjegjës për teknologjinë e informacionit në Prokurori; *(Pjesëmarrje fizike)*

Të pranishëm në procedurën e përzgjedhjes së çështjeve me short :

Z/Znj._____ - Anëtar/e i K.V.V.E. P; *(Pjesëmarrje fizike/online)*

Z/Znj._____ - Prokurori/ja subjekt vlerësimi; *(Pjesëmarrje fizike/online)*

Z/Znj._____ - Punonjës përgjegjës për teknologjinë e informacionit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë; *(Pjesëmarrje fizike/online)*

(Shtohet pjesëmarrës tjetër nga prokuroritë e tjera ku prokurori ka ushtruar detyrën)

Ky procesverbal mbahet nga sekretarja e Prokurorisë Z/Znj._____.

Bazuar në vendimin e relatorit z/znj _____, të datës___.____._____, fillon procedura e shortit për përzgjedhjen e çështjeve, sipas renditjes së mëposhtme:

Hapi 1: **Përzgjedhja me short e çështjeve të hetuara/verifikuara përtej afateve standarde (afat ligjor) nëse ka të tilla të përcaktuara në vendimin e relatorit.**

Sipas tabelës me të dhëna statistikore për çështjet për të cilat është vendosur përtej afateve standarde, zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjodhën ____ çështjet si më poshtë:

1. Çështja me nr. kallëzimi/procedimi ___, datë regjistrimi ___ , datë vendimi _____ ;
2. Çështja me nr. kallëzimi/procedimi ___, datë regjistrimi ___ , datë vendimi _____ ;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Hapi 2: **Përzgjedhja me short e çështjeve për vlerësim të përgjithshëm sipas numrit e kategorive të përcaktuara në vendimin e relatorit.**

Sipas tabelës me të dhëna për *materialet kallëzuese të mosfilluara*[7], zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjodhën____ çështje si më poshtë:

1. Kallëzimi me nr. regjistri___, datë regjistrimi ____, nr. vendimi ____, datë vendimi _____;
2. Kallëzimi me nr. regjistri ____, datë regjistrimi____, nr. vendimi_____, datë vendimi;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Sipas tabelës me të dhëna për *çështjet e përfunduar me Kërkesë për pushim,* zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjodhën____ çështje si më poshtë:

1. Çështja me nr. ___ procedimi, datë regjistrimi ____ , datë vendimi____;
2. Çështja me nr. ___ procedimi, datë regjistrimi ____ , datë vendimi____;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Në të njëjtën mënyrë, bazuar në vendimin e relatorit, pasqyrohen veprimet e tjera që kryhen gjatë përzgjedhjes me short të të gjitha çështjeve për vlerësim të përgjithshëm, për secilën kategori.

Pas zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së çështjeve me short, pjesëmarrësit parashtrojnë vërejtje për procedurën e zhvillimit të shortit, nëse ka të tilla.

Subjekti që parashtron vërejtjen:_____;

Përmbajtja e vërejtjes: _____;

Procedura e shortit përfundoi në orën ___.____;

Në përfundim procesverbali lexohet dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Për pjesëmarrësit që marrin pjesë online përmes mjeteve të komunikimit elektronik përbri emrit dhe mbiemrit të tyre shënohet (*konfirmohet online*).

Një kopje e procesverbalit i dorëzohet kryesekretarit/kancelarit të prokurorisë dhe një kopje prokurorit/es subjekt vlerësimi. Kopja origjinale administrohet në dosjen e vlerësimit të prokurorit/es.

Anëtari i K.V.V.E.P _____

Këshilltari përgjegjës për vlerësimi_____

Prokurori/ja subjekt vlerësimi _____

Kryesekretar/Kancelari i prokurorisë_____

Punonjësi përgjegjës për IT në KLP _____

Punonjësi përgjegjës për IT në Prokurori_____

Sekretare në Prokurori _____

[7] Kategoria e çështjes në këtë procesverbal është për efekt ilustrues.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT
SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT, DIGJITALIZIMIT DHE STATISTIKËS

ANEKSI nr. 1/1

MANUAL PËR ZHVILLIMIN E SHORTIT ELEKTRONIK
nëpërmjet Microsoft Excel dhe platformës Zoom
Udhëzues praktik për strukturat pjesëmarrëse

Statusi i dokumentit	Projekt për përdorim institucional
Versioni	1.2
Data	14.07.2026
Njësia hartuese	Sektori TIK, Digjitalizimit dhe Statistikës

Ky manual synon që procesi të kryhet njësoj nga çdo prokurori, në mënyrë të thjeshtë, të dukshme dhe të dokumentuar.

1. Qëllimi i manualit

Ky manual përshkruan hapat për zhvillimin në distancë të shortit elektronik për përzgjedhjen rastësore të një dosjeje të prokurorit që i nënshtrohet procesit të vlerësimit. Procesi realizohet, duke vënë në përdorim, si vijon:
- një tabelë Microsoft Excel, ku lista e dosjeve vendoset në kolonën A;
- një formulë që zgjedh rastësisht një numër nga lista;
- platformën Zoom për ndarjen e ekranit nga prokuroria;
- regjistrimin e takimit Zoom për dokumentimin e veprimeve dhe të rezultatit.

Parimi bazë
Prokuroria pjesëmarrëse e hap vetë tabelën në kompjuterin e saj, ndan ekranin në Zoom dhe, pasi palët konfirmojnë se lista është e saktë dhe regjistrimi ka filluar, shtyp një herë tastin F9. Numri i shfaqur është rezultati i shortit.

2. Rolet dhe përgjegjësitë

Pala	Detyra kryesore	Përgjegjësia
Prokuroria pjesëmarrëse	Hap tabelën, hyn në Zoom, ndan ekranin dhe shtyp F9.	Siguron që lista e dosjeve është e plotë, e saktë dhe përmban vetëm dosjet që plotësojnë kriteret e shortit. Zbaton procedurën e shortit dhe evidenton në kohë reale çdo dosje të përzgjedhur.
KLP / organizatori	Drejton seancën, verifikon pamjen e ekranit dhe regjistron takimin.	Dokumenton rezultatin përfundimtar të shortit dhe administron regjistrimin e plotë të procesit.
Pjesëmarrësit e tjerë	Vëzhgojnë procesin në kohë reale.	Konfirmojnë transparencën e procedurës dhe, kur kërkohet, rezultatin në procesverbal.

3. Përgatitja para takimit

Kontrolli	Çfarë duhet verifikuar
Tabela e Excel-it	Të jetë ruajtur me emrin e prokurorisë dhe datën e shortit. Kolona A duhet të përmbajë vetëm numrat që marrin pjesë në short.
Zona e formulës	Formula të referojë saktësisht intervalin ku ndodhen numrat. Për shembull: A11:A52.
Zoom	Të jetë i instaluar ose të jetë e mundur hyrja nga shfletuesi. Prokuroria duhet të ketë të drejtën për të ndarë ekranin.
Regjistrimi	Organizatori (KLP) të kontrollojë hapësirën e ruajtjes dhe të fillojë regjistrimin përpara shtypjes së F9.
Njoftimi	Pjesëmarrësit të informohen se takimi regjistrohet për dokumentimin e procedurës.

4. Linku i takimit Zoom

Për lidhjen me takimin e përcaktuar përdoret linku i mëposhtëm: Hap takimin Zoom për shortin elektronik

5. Procedura hap pas hapi

1	**Hapja e linkut Zoom** Klikoni linkun e dërguar me email. Kur shfaqet pyetja e shfletuesit, zgjidhni "Open Zoom Workplace". Nëse aplikacioni nuk është i instaluar, ndiqni opsionin për instalim ose për hyrje nga shfletuesi, kur ky opsion shfaqet.
2	**Hyrja në takim** Vendosni emrin dhe prokurorinë, p.sh. "Prokuroria Vlorë – Emër Mbiemër", dhe klikoni "Join". Prisni pranimin nga organizatori, nëse është aktivizuar Waiting Room.
3	**Hapja e tabelës Excel** Hapni skedarin Excel të dërguar me email. Mos ndryshoni formulën dhe mos shtypni ende F9. Kontrolloni që lista në kolonën A përputhet me listën e miratuar të dosjeve.
4	**Ndarja e ekranit në Zoom** Në shiritin e poshtëm të Zoom klikoni "Share". Zgjidhni "Screen" për të ndarë të gjithë ekranin ose dritaren e Excel-it dhe më pas klikoni përsëri "Share". Organizatori duhet të konfirmojë se tabela shihet qartë.



Figura 1 – Butoni "Share" në Zoom, i shënuar me rreth të kuq.

5	**Fillimi i regjistrimit** Organizatori (përfaqësuesi i KLP-së) fillon regjistrimin e takimit dhe e konfirmon me zë. Shorti nuk duhet të kryhet përpara këtij konfirmimi.

6	**Konfirmimi i listës** Në ekran duhet të duken: lista e numrave, numri i dosjes përkatëse dhe qeliza ku shfaqet rezultati. Palët konfirmojnë se lista është përfundimtare dhe nuk ka dosje të papranueshme, rreshta bosh ose dublikime të paarsyetuara.

7	**Kryerja e shortit** Shorti kryhet nën orientimin e magjistratit këshilltar përgjegjës, në KLP. Personi i autorizuar nga prokuroria shtyp vetëm një herë tastin F9, për të gjeneruar numrin rastësor të shortit. Tasti F9 nuk duhet të shtypet përsëri pasi rezultati do të ndryshojë.



Figura 2 – Formula e shortit në shiritin e formulës së Excel-it.

LA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE TË DËRGUARA NË GJYKIM, TË PROKURORIT ENKELEDA HOXHA TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KUKËS PËR VITIN 2024

Kallëzimi		Data e shortit elektronik	Numri dhe data e regjistrimit të proc. Penal		Vepra/t penale e regjistruar	Data e vendimit të zëvendësimit nëse çështja është marrë nga një prokuror tjetër	Natyra Çështjes / Data e Kërkesës				Datë e dorëzimit në sekretari të kërkesës	Kohëzgjatja në hetim DITË	Krahasuar me afatin ligjor	Numri i zgjatjeve	Me masë sigurimi, lloji i masës	Ankim i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës (nëse ka)	Transf. përkoh. ose i caktuar përkoh. në prok. tjetër
Nr.	Datë		Nr.	Datë			Marrëveshje	Urdhër penal	Gjykimi i drejtëpërdrejt	Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq							
490	02.08.23	03.08.23	348	3.8.2023	242,291					7.2.2024		188	B.Afati		234		
191	06.03.24	06.03.24	154	6.3.2024	291					4.4.2024	4.4.2024	29	B.Afati		234		
258	03.04.24	04.04.24	211	4.4.2024	291					30.5.2024	30.5.2024	56	B.Afati		234		
259	03.04.24	04.04.24	212	4.4.2024	291					28.6.2024	28.6.2024	85	B.Afati		234		
459	04.06.24	05.06.24	358	5.6.2024	291					11.7.2024	11.7.2024	36	B.Afati		234		
546	08.07.24	08.07.24	407	8.7.2024	291					9.8.2024	9.8.2024	32	B.Afati		234		
613	5.8.24	5.8.24	457	5.8.2024	291					23.9.2024	23.9.2024	49	B.Afati		234		
699	05.09.24	05.09.24	482	5.9.2024	291					25.9.2024	25.9.2024	20	B.Afati		234		
													Krahasuar me kohën mesatare të hetimit të seksionit/				
												9	164				
	52																

Figura 3 – Shembull i tabelës dhe qelizës së verdhë ku shfaqet numri i përzgjedhur.

8	**Leximi dhe shpallja e rezultatit** Numri që shfaqet në qelizën e rezultatit është numri i përzgjedhur. Identifikoni rreshtin përkatës dhe lexoni numrin e dosjes së prokurorit. Rezultati përsëritet me zë dhe konfirmohet nga pjesëmarrësit.
9	**Ruajtja e provës së rezultatit** Mos shtypni përsëri F9. Bëni menjëherë një screenshot, shënoni rezultatin në procesverbal dhe ruani skedarin me emër të ri.
10	**Përfundimi** Pasi rezultati është dokumentuar, ndaloni ndarjen e ekranit, konfirmoni përfundimin e procedurës dhe mbyllni takimin. Regjistrimi, tabela e rezultatit, screenshot-i dhe procesverbali ruhen në dosjen administrative përkatëse.

6. Shpjegimi i formulës së Excel-it

Formula e përdorur
=INDEX (A11:A52, RANDBETWEEN(1, COUNTA(A11:A52)))

Formula përbëhet nga tre funksione:

Funksioni	Roli në formulë
COUNTA (A11:A52)	Numëron sa qeliza të plotësuara (jo bosh) ka në intervalin A11:A52.
RANDBETWEEN (1, …)	Gjeneron një numër të plotë rastësor nga 1 deri te numri i qelizave të plotësuara.
INDEX (A11:A52, …)	Kthen vlerën që ndodhet në pozicionin e përzgjedhur brenda intervalit A11:A52.

Çfarë bën F9? Tasti F9 urdhëron Excel-in të rillogarisë formulat. Meqenëse RANDBETWEEN është funksion dinamik, çdo rillogaritje mund të prodhojë një numër tjetër.

Kushti që formula të funksionojë drejt
Vlerat në kolonën A duhet të jenë të vendosura në rreshta të njëpasnjëshëm, pa boshllëqe në mes. Nëse ka rreshta bosh brenda intervalit, formula mund të kthejë një qelizë bosh ose të mos përfshijë drejt vlerat që ndodhen pas boshllëkut.

Shënim i rëndësishëm:
Në tabelat Excel që përmbajnë disa kritere përzgjedhjeje, si p.sh. Tabela nr. 10, personi përgjegjës i prokurorisë, nën orientimin e magjistratit këshilltar përgjegjës në KLP-së, duhet të përshtasë paraprakisht tabelën vetëm sipas kriterit që do t'i nënshtrohet shortit. Lista përfundimtare duhet të përmbajë vetëm dosjet që plotësojnë kriterin përkatës, pa rreshta bosh dhe pa të dhëna që u përkasin kritereve të tjera, me qëllim garantimin e saktësisë dhe integritetit të procesit të përzgjedhjes.

7. Emërtimi dhe ruajtja e dokumenteve
- Regjistrimi Zoom: Shorti_[Prokuroria]_..../…/2026.mp4
- Tabela e rezultatit: Shorti_[Prokuroria]_ ..../…/2026_REZULTAT.xlsx
- Screenshot: Shorti_[Prokuroria]_ ..../…/2026 Pamja.png
- Procesverbali: Procesverbal_Shorti_[Prokuroria]_ ..../…/2026.pdf

8. Përfundimisht, ky udhëzues i shpejtë dhe praktik konsiston në vetëm 8 hapa:

1. Klikoni linkun e Zoom dhe hyni me emrin e prokurorisë.
2. Hapni skedarin Excel të dërguar me email.
3. Në Zoom klikoni Share dhe zgjidhni ekranin ose Excel-in.
4. Prisni konfirmimin që ekrani shihet dhe regjistrimi ka filluar.
5. Kontrolloni listën dhe mos ndryshoni formulën.
6. Shtypni F9 vetëm një herë (ose Fn + F9).
7. Lexoni numrin e shfaqur dhe dosjen përkatëse; mos shtypni më F9.
8. Ruani screenshot-in, tabelën me rezultat dhe procesverbalin.

Fjalia standarde që mund/duhet të lexohet gjatë shortit:
"Lista u verifikua dhe regjistrimi ka filluar. Ju lutem shtypni tastin F9 vetëm një herë. Numri i shfaqur në qelizën e verdhë do të konsiderohet rezultati përfundimtar i shortit. Faleminderit"

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 640 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 178|Datë: 11.08.2026 15:31:09 +02:00|aefc324c-7d81-4ee5-852e-c3b73d581653

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)